


---

**UNIVERSITETI I EJL  
ЈНЕ УНИВЕРЗИТЕТ  
SEE UNIVERSITY**



**FAKULTETI I DREJTËSISË**

**ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ**

**FACULTY OF LAW**

## **STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

**TEZA:**

**KRIMINALITETI I TË MITURVE ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË RRETHIN E  
GJYKATËS THEMELORE TË GOSTIVARIT NË  
PERIUDHËN 2009-2014**

**MENTORI:**  
**Prof. Dr. JETON SHASIVARI**

**KANDIDATJA:**  
**VALDETA DALIPI**

**Tetovë, Maj 2018**

---

---

## PËRMBAJTJA

### KAPITULLI I PARË

#### DELIKUENCA E TË MITURVE SI FORMË E KRIMINALITETIT ..... 4

|                                                                                                        |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Kuptimi dhe rëndësia e delikuencës së të miturve .....                                              | 6  |
| 2. Nocioni i delikuencës së të miturve .....                                                           | 9  |
| 3. Kriminaliteti i të miturve .....                                                                    | 12 |
| 3.1. Bandat e të miturve .....                                                                         | 14 |
| 4. Kategoritë e të miturve dhe sanksionet ndaj tyre .....                                              | 14 |
| 4.1. Kategoritë e të miturve .....                                                                     | 14 |
| 4.2. Sanksionet ndaj të miturve dhe qëllimet e tyre .....                                              | 17 |
| 5. Ligji për të drejtat e të miturve .....                                                             | 18 |
| 5.1. Zhvillimi i reforma për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në<br>Republikën e Maqedonisë ..... | 26 |
| 6. Trajtimi i të miturve në bazë të legjislacionit të RM-së .....                                      | 29 |
| 7. Konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e të miturve .....                                           | 34 |

### KAPITULLI I DYTË

#### FAKTORËT E KRIMINALITETIT TË TË MITURVE ..... 38

|                                                                                |    |
|--------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Faktorët biologjik dhe psikologjik të kriminalitetit të të miturve .....    | 39 |
| 2. Faktorët social të kriminalitetit të të miturve .....                       | 41 |
| 3. Familja si faktorë i kriminalitetit të të miturve .....                     | 42 |
| 3.1. Arsimi në familje .....                                                   | 43 |
| 4. Shkolla si faktor institucional i kriminalitetit të të miturve .....        | 44 |
| 5. Faktorët ekonomik (gjendja ekonomike) të kriminalitetit të të miturve ..... | 45 |
| 5.1. Varfëria .....                                                            | 46 |
| 6. Migrimi dhe urbanizmi si faktorë i kriminalitetit të të miturve .....       | 47 |
| 7. Koha e lirë e të miturve si faktorë i kriminalitetit të të miturve .....    | 48 |
| 8. Roli i Mas mediave si faktorë i kriminalitetit të të miturve .....          | 49 |

---

## KAPITULLI I TRETË

### **KRIMINALITETI I TË MITURVE DHE MASAT PËR PARANDALIMIN E TIJ ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË RRETHIN E GJYKATËS THEMELORE NË GOSTIVAR NË PERIUDHËN 2009 – 2014 ..... 53**

|                                                                                                                                 |         |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|
| 1. Situata e kriminalitetit të të miturve në rrethin e Gostivarit .....                                                         | 53      |
| 1.1. Karakteristikat socio-demografike të të miturve në rrethin e Gostivarit .....                                              | 55      |
| 2. Dinamika dhe struktura e kriminaliteti në rrethin e Gostivarit .....                                                         | 60      |
| 3. Politika penale ndaj të miturve në Gostivar dhe trendet e zhvillimit të saj .....                                            | 66      |
| 4. Analiza e gjendjes së kriminalitetit të të miturve në rrethin e gjykatës themelore në Gostivarë në periudhën 2009-2014 ..... | 74      |
| 5. Strategjia Kombëtare për parandalimin e kriminalitetit të të miturve në Republikën e Maqedonisë .....                        | 85      |
| 6. Masat e përgjithshme dhe të veçanta .....                                                                                    | 89      |
| 7. Praktikrat më të mira të ndërhyrjes për parandalimin e kriminalitetit të të miturve .....                                    | 94      |
| 8. Bashkëpunimi ndër-institucional në Republikën e Maqedonisë në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit të të miturv .....  | 96      |
| 8.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) .....                                                                              | 96      |
| 8.2. Ministria për punë të brendëshme (MPB-ja) .....                                                                            | 98      |
| 8.3. Ministria për punë dhe politikë sociale .....                                                                              | 100     |
| 8.4. Avokati i Popullit .....                                                                                                   | 102     |
| 8.5. Bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare (OJQ-të) .....                                                                   | 103     |
| 8.6. Këshillat Komunal .....                                                                                                    | 104     |
| <br>PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME .....                                                                                            | <br>105 |
| LITERATURA E SHFRYTËZUAR .....                                                                                                  | 111     |

---

## **KAPITULLI I PARË**

### **DELIKUENCA E TË MITURVE SI FORMË E KRIMINALITETIT**

Ndikimet dhe influencat globale të ditëve të sotme, lidhur me krizat ekonomiko shoqorore, të cilat sot godasin edhe vendet tona gjithashtu edhe Republikën e Maqedonisë, sjellin vështirësi mjaft të mëdha për familje të tëra në mbarë botën, duke shfaqur fenomenin e “luftës për egzistencë”. Kjo problematikë paraqet një virus apo epidemi botërore që godet njerëzimin në të gjitha sferat e jetës si, ekonomike, politike, sociale e kështu me rradhe, e cila si rezultat i sajë sjell në një rritje kuantitative të kriminalitetit e veçanërisht në atë të kryerjes së vprave penale nga të miturit.

Delikuenca e të miturve, si një fenomen i veçantë negativ shoqëror paraqet një problem serioz shoqëror që sot po përballen të gjitha vendet në mbarë botën, venet e ballkanit e posaçërisht edhe Republika e Maqedonisë dhe rajoni i Gostivarit.

Studimi mbi kriminalitetin tek të miturit në Republikën e Maqedonisë është një temë shumë pak e trajtuar dhe studjuar dhe kjo temë është një ndër përpjekjet e para, e cila synon të realizojë një analizë të situatës aktuale lidhur me këtë fenomen në veçanërisht në rrethin e gjykatës themelore në Gostivarë e cila është edhe temë studimi. Vitet e fundit, përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete kriminale është kthyer në një shqetësim për Republikën e Maqedonisë dhe në veçanti për rajonin e Gostivarit e posaçërisht gjatë viteve të fundit, ku të rinjtë gjithnjë e më tepër janë të përfshirë në akte kriminale. Studimi i statistikave nga institucionet dhe organizmat qëndrore dhe lokale të specializuara dhe përgjegjëse në këtë fushë, tregojnë se në shumë raste shqetësimi i publikut në lidhje me këtë fenomen është i drejtë.

Me qëllim të realizimit të këtij qëllimi, ky studim bën një prezantim të përgjithshëm të situatës aktuale mbështetur në shifra dhe fakte, qartëson konceptet bazë për kriminalitetin tek të miturit, paraqet dhe analizon të dhëna të viteve të fundit për përfshirjen e të miturve në aktivitete dhe sjellje kriminale, identifikon dhe analizon faktorët nxitës të kriminalitetit tek të miturit, jep një pasqyre dhe profilizon të miturin në konflikt me ligjin mbështetur në të dhëna të

---

grumbulluara në terren në lidhje me të miturit që vuajnë dënimet për sjellje kriminale, sugjeron masa parandaluese për të përmirësuar situatën dhe së fundmi, arrin në disa konkluzione dhe sugjerime për të gjithë të interesuarit në këtë fushë.

Republika e Maqedonisë si synim kryesorë e ka anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Nisur nga kjo, një aspirim i tillë mund të përshpejtohet, në qoftë se i plotëson kushtet e nevojshme, ku pikërisht bënë pjesë mbrojtja e të drejtave të njeriut, të drejtat e të miturve dhe të rinjve si dhe të drejtat themelore.

Republika e Maqedonisë deri më tani ka bërë ndërhyrje kushtetuese dhe ligjore për sa i përket të drejtave themelore të njeriut dhe të drejtave të sigurisë njerëzore, mirëpo praktika dhe implementimi juridik i tyre akoma ka ngecje të theksuar. Në këtë drejtim, arsyeja kryesore për shpresën nuk duhet të lidhet me natyrën e këtyre sfidave, por me shpejtësinë dhe dinamikën e përgjigjes praktike dhe atë të legjislacionit kushtetues dhe ligjor, që duhet të respektohen këto të drejta realisht, për t'i ndjerë dhe gëzuar qytetarët e sajë këto të drejta. Ky pra është moment kyç që në Republikën e Maqedonisë të trajtohen raportet mes legjislacionit dhe realizimit të këtyre të drejtave themelore të njeriut dhe të rinjve në përgjithësi.

Si i tillë, studimi që po ju paraqesim është një përpjekje jo vetëm për të analizuar shifra dhe fakte mbi kriminalitetin e të miturve por përbën një dokument që ju vjen në ndihmë specialistëve të fushës për të kuptuar shkaqet dhe mundësitë e parandalimit të fenomenit, prindërve për të kuptuar dhe ardhur në ndihmë fëmijëve të tyre me probleme të sjelljes, mësuesve për t'u njohur dhe ndërgjegjësuar për shqetësimet e fëmijëve të moshave të ndryshme, vetë fëmijëve për të kuptuar shkaqet dhe pasojat e sjelljeve të tyre si dhe të gjithë aktorëve të interesuar për të kontribuar në përmirësimin e situatës së fëmijëve në Republikën e Maqedonisë dhe në veçanti në regjionin e Gostivarit.

---

## 1. Kuptimi dhe rëndësia e delikuencës së të miturve

Delikuenca është një dukuri shoqërore komplekse, njohja e plotë e së cilës kërkon një studim shkencor multidisiplinar. Shikuar historikisht delikuenca e të miturve është e vjetër sa edhe vetë njeriu dhe shoqëria. Ajo gjithmonë ka ekzistuar dhe është shfaqur ku më pak e ku më shumë, varësisht nga ndryshimet në shoqëri dhe në mjedisin ku kanë jetuar të rinjtë.

Termi delikuencë (devijim) vjen nga fjala latine "deliquare" që ka një kuptim shumë të gjerë. Ka pasur mjaft tentime që të përcaktohet dhe të shpjegohet saktësisht domethënia e kësaj fjale, mirëpo është parë se një përcaktim i tillë nuk është pranuar, ngase kuptimi dhe brendia e termit varej shumë nga sistemet dhe ligjet e shtetit, si dhe nga këndvështrimi shkencor (psikologjik, pedagogjik, mjekësor, juridik etj.) i këtij problemi. Ndërkaq sot me këtë term kuptojmë përgjithësisht shprehjet, sjelljet dhe veprimet e përsëritura të të miturve që bien ndesh me moralin, zakonet dhe ligjet e mjedisit ku jetojnë. Delikuent quhet ai që ka sjellje të përsëritura devijuese, që bën vepra kriminale, duke shkelur kështu normat ligjore në fuqi.<sup>1</sup>

Delikuenca e të rinjve nuk paraqitet befas dhe papritur, por ka një fazë para-përgatitore që fillon me sjellje asociale nga mosha e pubertetit 11-14 vjeç. Sjelljet asociale të fëmijëve në këtë moshë janë të shumta dhe të ndryshme. Ato shfaqen në një gamë të gjerë si kryeneçësi, fyerje dhe sharje, rrahje, mosbindje dhe mosdurim, vjedhje, ikje nga shtëpia e nga shkolla, etj. Në qoftë se në këtë moshë nuk merren masa të duhura për menjanimin e tyre, ato dalëngadalë rriten e përseriten dhe bëhen potencial optimal për delikuencë të vërtetë. Pra, rrënjët e delikuencës së të miturve në këtë moshë zënë fill herët në familje me sjellje asociale, të cilat më vonë kalojnë në sjellje delikvente.

Delikuenca e të miturve përfshin moshën nga 12 deri 18 vjeç. Për sjellje dhe veprime delikvente të të miturve deri në moshën 18-vjeçare përgjegjësia u bie prindërve, kurse pas kësaj moshe delikuentët edhe me ligj trajtohen persona madhorë dhe vetë përgjigjen për sjelljet dhe veprimet e tyre. Sipas moshës delikuentët ndahen në dy grupe: delikuentë të rinj prej 14 deri 15 vjeç dhe delikuentë të rritur 16-18 vjeç. Ndaj këtyre delikuentëve zakonisht merren tri masa riedukuese: kujdesi i shtuar shtëpiak për veprime më të lehta, masa e izolimit, përkatësisht vendosja në institucion ri-edukues nën mbikëqyrjen e përhershme të edukatorit për vepra më të rënda, si dhe mbyllja në burgje të posaçme për vepra të rënda penale.

---

<sup>1</sup> Dr. Dragan Kisić, Psihološkirenik, Savremena administracija, Beograd, 1991

---

Delikuenca përfshinë shumë elemente të jetës psikike, fiziologjike dhe relacionin shumë të ngushtë midis sociales dhe rregullimit normativ të saj. Ajo nuk është diçka e re. I ri mund të jetë trajtimi i kësaj dukurie, që përcaktohet nga niveli zhvillimor socio-ekonomik, juridiko-politik dhe nga natyra e legjislacionit të një shoqërie të caktuar. Autori M. Milutinoviçi ka konstatuar me të drejtë se termi "delikuencë" është mjaft i përshtatshëm për ta shprehur atë përmbajtje kuptimore që përfshin sjelljet e rinisë me të cilat cenohen dispozitat ligjore si dhe ato sjellje devijante (ikja nga shkolla, sjelljet vandale), të cilat nuk paraqiten te personat e rritur, por edhe shumë sjellje karakteristike të të rinjve, që nuk shkelin asnjë dispozitë ligjore, si p.sh. padëgjueshmëria, pirja e duhanit pa leje, bredhja etj.<sup>2</sup> Sipas këtij autori delikuenca është e përkufizuar në kuptimin e gjerë, kurse në kuptimin e ngushtë është "çdo sjellje e të miturit (atyre nën 14 vjeç dhe atyre deri më 18 vjeç), e cila sulmon vlera shëndetësore, fizike, materiale, pronësore dhe dinjitetin e njeriut tjetër si dhe vlerat morale dhe ligjore të një shoqërie të caktuar."<sup>3</sup>

Strukturën e moshës së të rinjve të mitur si kryerës të veprave penale do ta parashtrojmë sipas literaturës së kësaj fushe: "Personat e moshës 14-16 vjeç paraqiten si kryerës të veprave penale me përqindje gati të njëjtë si të miturit e moshës 16-18vjeç, por nuk është i vogël as numri i delikuentëve më të rinj se 14 vjeç."<sup>4</sup>

Delikuenca është e lidhur ngushtë me vetë jetën, me zhvillimin ekonomik të një shoqërie, me gjendjen dhe pozitën e familjes, me begatinë socio-kulturore që ofron shoqëria për të rinjtë, sidomos në fazat delikate të zhvillimit të tyre fizik e mendor. Këtu duhet veçuar fazën e pubertetit që është shumë delikate dhe e bujshme në jetën e të rinjve dhe relacionin e tyre me shoqërinë. Fillimi i pubertetit 13-15 vjeç te meshkujt, kurse te vajzat pak më herët karakterizohet me ndryshime të mëdha fiziologjike, morfologjike dhe psikike. Në këtë moshë i mituri dëshiron që sa më parë të bëhet i pavarur dhe këtë tendencë e shpreh me sjellje dhe veprime ekscentrike. Duke mos arritur t'i vërë nën kontroll këto sjellje, ai shumë herë bëhet i rrezikshëm për veten dhe rrethin ku jeton e vepron, kështu që aktiviteti i tij është i orientuar gati kundër të gjithëve. Kjo fazë në shkencë quhet faza e revoltës, e cila manifestohet kryesisht kundër autoritetit të familjes, shkollës dhe shoqërisë në përgjithësi. Kulmi i revoltës arrihet kur

---

<sup>2</sup> Dr. M. Milutinoviçi, Kriminologjia, ETMMK, Prishtinë, 1982,

<sup>3</sup> Po aty...

<sup>4</sup> N. Srzentic, dr. A. Stajic, dr. L. Lazarevic, Krivichno prave Jugosllavije, 1998

---

sjellja e të miturit merr përmasa të pakontrolluara, duke sulmuar edhe vlerat shoqërore të cilat janë të mbrojtura me ligj. Aktiviteti delikuent i të rinjve të mitur pasqyrohet kryesisht në tri nivele:

- a) sociopatologjik
- b) kundërvajtës
- c) kriminal

Kriter bazë i përcaktimit të këtyre niveleve është mosha, kufijtë e së cilës përcaktohen me dispozita juridike në çdo shoqëri të organizuar si shtet.

**Aktivitete socio-patologjike** janë të gjitha ato veprime dhe sjellje të të miturve që nuk kanë të bëjnë me shkeljen e dispozitave ligjore, por me cenimin e dokeve, të zakoneve dhe etikës individuale e shoqërore të cilësuar shoqërisht të dëmshme. Kur këto veprime zgjasin shumë, krijojnë mundësinë apo bazën që më vonë të shndërrohen në veprime kriminale. Sa më herët që të bëhet identifikimi i të rinjve me sjellje të tilla atipike në vazhdimësi, aq më mirë e më shumë mund t'u ndihmohet, sidomos delikuentëve në moshë më të re se ajo 9-12-vjeçare. Për këtë situatë të vlefshme dhe të efektshme janë sidomos masat edukuese jointsti-tucionale, si p.sh. mbikëqyrja e shtuar nga ana e prindërve, këshillimet në grupe sipas moshave të udhëhequra nga profesionistë, dhënia e dhuratave joshëse për fëmijë si kundërvlerë për të hequrit dorë nga veprimet e mëparshme etj. Me shprehjen "sjellje atipike" kuptojmë vjedhjet e lehta që përsëriten, rrahjet me moshatarë, ngacmimet naive seksuale të moshatarëve, ngacmimet e ndryshme ndaj të moshuarve të përcjella me sjellje vandale etj.

Disa autorë individët me sjellje sociopatologjike i cilësojnë si paradelikuentë, kurse delikuentë i quajnë ata, veprimet e të cilëve bien ndesh me ligjin.<sup>5</sup>

Është detyrë e shoqërisë në përgjithësi dhe e institucioneve përkatëse në veçanti që delikuentët e mitur të ndihmohen për t'u shmangur nga rruga e keqe me anë të masave riedukuese, të cilat duhet të merren ndaj tyre që në zanafillë të sjelljeve patologjike-sociale, në mënyrë që ata të risocializohen dhe të futen në rrjedhat normale të jetës, e jo të lihen në mëshirë të "stihisë spontane rekrutuese"<sup>6</sup> në kriminelë të ardhshëm. Risocializimi i tyre nënkupton trajtimin adekuat në relacion me veprimin e kryer, që do të thotë të merren masa edukuese, përmirësuese e jo dënime siç veprojnë shpesh në praktikë ata që nuk e njohin

---

<sup>5</sup> Dr. M. Milutinović, Kriminologjia, ETMMK, Prishtinë, 1982,

<sup>6</sup> Dr. R. Halili, Penologjia, Prishtinë, 2000



---

mirë natyrën e fëmijës. Masa të tilla disiplinore janë "ato masa edukuese që zbatohen për personat e mitur, të cilët kanë kryer sjellje të lehta delikvente".<sup>7</sup> Kjo tezë ilustron pikëpamjen mjaft të përhapur në qarqet kriminalistiko-kriminologjike, sipas së cilës të miturit delikuentë janë më shumë viktima sesa kriminelë pikërisht nga shkakut se institucionet përkatëse shoqërore dhe shtetërore nuk e kanë kryer mirë punën e vet.

**Aktivitetet kundërvajtëse** të të miturve janë të gjitha ato veprime, të cilat me dispozita juridike janë përcaktuar si të tilla, por që faktikisht nuk paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore. Sipas prof. I. Salihut, veprimet kundërvajtëse janë "cenime të rendit publik dhe si të tilla paraqesin cenime të disiplinës shoqërore"<sup>8</sup>

**Aktivitetet kriminale** janë të gjitha ato veprime që kryejnë të rinjtë mbi moshën 14 vjeç dhe që janë të cilësuar si vepra penale me kodin penal. Kjo praktikisht do të thotë se ato janë veprime të kundërligjshme dhe paraqesin rrezikshmëri të lartë shoqërore, prandaj sanksionohen penalisht. Në Republikën e Maqedonisë, janë shënuar një numër i madh i veprave të ndryshme penale si strujnia (vjedhje e gjerave më të vogla), mashtrimet, grabitjet, plaçkitjet e armatosura, torturat, rrahjet, keqtrajtimet familjare, dëmtimet pasurore, djegiet e shtëpive, ngasja e automjetit pa leje dhe rrezikimi i sigurisë së trafikut, prishja e rendit dhe e qetësisë publike, kalimi ilegal i kufirit, rrëmbimet, sulmet që kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe përdorimi i mjeteve shpërthyes me pasoja - lëndime dhe humbje gjymtyrësh, konsumimi dhe shitja e drogës, dhunimet dhe sulmet seksuale, vrasjet etj., të cilat i kanë kryer të rinjtë delikuentë.

## 2. Nocioni i delekuencës së të miturve

Delikuenca e të miturve paraqet fenomen negativ shoqëror karakteristike për të gjitha shoqëritë prej shoqërive më të vjetra deri te shoqëritë e sotme moderne. Me delikuencë të të miturve nënkup- tojmë sjellje të njerëzve të rinj të cilët shoqëria i caktuar përcaktuar si të palejuara ose të ndaluara, duke filluar prej një sjellje jo të hijshme, të turpshme dhe të papërshtatshme deri te sjelljet të cilat paraqesin kundërvajtje, cënim ose vepër penale si vepra të rënda me të cilat shkelen të mira dhe vlera të rëndësishme shoqërore.

---

<sup>7</sup> Dr. R. Halili, Penologjia, Prishtinë, 2000

<sup>8</sup> I. Salihu, E drejta Penale, Prishtinë, 2003

---

Një kohë të gjatë në fillim, dënohej çdo sjellje e njerëzve me të cilën sulmoheshin të mirat dhe vlerat e mbrojtura, p.sh., vjedhje, lëndime trupore, vrasje dhe të tjera, pa marrë parasysh nëse ato, ishin kryer prej personave të rritur ose të mitur dhe për të cilat të miturve u shqiptoheshin dënime të njëjta si edhe për të rriturit.

Në atë periudhë delikuenca e të miturve, nuk shihej si diçka që duhet të shqyrtohet në një mënyrë tjetër prej krimit të të rriturve. Ishte lëshuar prej qasjes se mituria është periudhë e jetës në të cilën personaliteti formohet dhe piqet dhe se jo gjithmonë ai personalitet është në gjendje në mënyrë reale dhe të rregullt të kuptojë çfarë ndodh rreth tij (të dallojë të mirën prej të keqes, të dijë çfarë është e lejuar dhe çfarë është e dënueshme), për të harmonizuar sjelljen e tij me rregullat e shoqërisë.

Shumë më vonë, me të miturit të cilin ishin kryerës të veprave të dënueshme, filluan të veprojnë në një mënyrë më ndryshe prej veprave të këtilla të kryera prej personave të rritur. Kjo posaçërisht, nëse për atë kishte shkaqe të arsyeshme të cilat mund të ndikojnë me ato të veprohet më ndryshe. Sot, në të gjitha vendet moderne dhe demokratike edhe në vendin tonë, delikuencës së të miturve dhe drejtësisë për të mitur i kushtohet vëmendje e posaçme në legjislacionet ndëshkimore. Në vendin tonë, veprimi me fëmijët në rrezik dhe me kryerësit e mitur të veprimeve të cilat me ligj janë përcaktuar si vepra penale dhe kundërvajtje është rregulluar me Ligjin për drejtësi për të miturit në vitin 2007<sup>9</sup>. Para kësaj, kjo materie ishte rregulluar me Kodin penal të vitit 1996.<sup>10</sup>

Me nocionin kryes i veprës penale nënkuptojmë kryesit e mitur të veprave penale qofshin ata si kryes, bashkë kryes, nxitës apo ndihmës. Kryes i moshës së mitur është personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale i ka pasur 14 vite të plota por nuk i ka mbushur 18 vite.

Sipas Kodit të Drejtësisë për të mitur të Republikës së Maqedonisë, në ligjin për të drejtat e të miturve nuk është dhënë definim konkret për definicionin për fëmijën. Në vend që ligjvënësi të parashikojë ashtu sikurse është e parashikuar në ligjin për mbrojtjen e fëmijëve, se fëmijë konsiderohet secili person deri në mbushjen e moshës 18 vjeçare, e më pas të bëjë gradacion të termeve varësisht nga mosha e fëmijëve, ai praktikon një qasje të komplikuar me përdorimin e disa termeve. Edhe në këtë ligj, por edhe në ligjet tjera të cilat i rregullojnë të

---

<sup>9</sup> (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.87/07).

<sup>10</sup> (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 37/96).

---

drejtat e fëmijëve nuk egziston pajtueshmëri të terminologjisë dhe shpesh hasen termet: fëmijë, i mitur, person i mitur, individ i cili nuk është i moshës madhore.

Disa terme dhe shprehje të përdorura në këtë ligjin për të drejtat e të miturve, në nenin 12, kemi këtë përkufizim sipas grupë moshës dhe kanë domethënien si vijon<sup>11</sup>:

- **I mitur** është secili person në moshë deri 18 vjet i cili sipas Konventës për të drejtat e fëmiut, llogaitet si fëmi.

- **Fëmi në rrezik** është fëmiu i cili në kohën kryerjes së aktivitetit që me ligj është e përcaktuar si vepër penale ose thyerje të ligjit, ka mbushur shtatë, a nuk ka mbushur katërmëdhjetë vite. Fëmijë në rrezik konsiderohet secili individ deri ne mbushjen e moshës 14 vjeçare, i varur nga keqpërdorimi i drogave, substancave psihotrope ose alkoolit, fëmijë me pengesa në zhvillim, fëmijë-viktimë e dhunës familjare dhe fëmiuje të lënë pas dore e i cili gjendet në një situatë të tillë në të cilën është e ngarkuar ose e pamundësuar realizimi i kyçjes në sistemin për edukim ose është dhënë pas lypjes, bredhjes ose prostitucionit, e më së tepërmi për shkak të rolit edukues në familje, e me çka mund të arrihet deri në kundërshtim me ligjin.

- **I mituri më i ri** është i mituri i cili në kohën e kryerjes së veprës penale që me ligj parashihet si vepër penale ose thyerje të ligjit ka pas të mbushur 14 vjet, por nuk ka pas të mbushura 16 vjet.

- **I mituri më i ri** është person i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është i paraparë si vepër penale për të cilën është i paraparë dënimi në të holla ose dënim me burg deri më tre vite, ka mbushur 14 a nuk ka mbushur 16 vjet ose i mituri i cili është i varur nga drogat, supstancat psihotrope ose alkoholi, fëmijë me pengesa në zhvillim dhe fëmijë i lënë pas dore i cili gjindet në aso shtate në të cilën është e vështirë ose e pamundur realizimi i funksionit edukues të familjes, e cila përshkak të këtyre gjendjeve është ose mundet që të vijë në konflikt me ligjin.

- **I mituri i rritur** është i mituri i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është i përcaktuar si vepër penale ose thyerje e tij, ka mbushur 16 vjet por jo edhe 18.

- **I mituri i rritur në rrezik** i cili gjatë kohës së kryerjes së veprës penale që me ligj është e përcaktuar si vepër penale , për të cilën parashihet dënim në të hollë ose burg deri në tre vite, i ka të mbushura 16 vite, ndërsa nuk ka mbushur 18 vite ose i cili është i varur nga përdorimi i drogave, substancave psihotrope ose alkoolit, fëmijë me pengesa në zhvillim dhe fëmijë i lënë pas dore nga kujdesi socialo-edukativ i cili gjindet në asi lloj shtate ku është e vështirë ose e

---

<sup>11</sup> Raport alternativ i organizatave joqeveritare ndaj raporteve shtetërore për gjendjen e të drejtave të fëmiut në Republikën e Maqedonisë

---

pamundshme realizimi i funksionit edukues të familjes, e cila përshkak gjendjeve të këtilla është ose mund të jetë në ndeshje me ligjin.

- **I rritur i ri** është personi i cili në kohën e dhënies së aktgjykimit ka mbushur 18 vite, ndërsa nuk ka mbushur 21 vjet.

Nocioni i veprës penale - Vepra penale është vepër e kundërligjshme e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale, tiparet e së cilës janë të përcaktuara me ligj dhe për të cilën me ligj është paraparë sanksioni penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm. Kodi për të drejtat e të miturve rregullon procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave dhe dënimeve ndaj të miturve, procedurën gjyqësore si dhe procedurën e ndërmjetësimit për të mitur.

### **3. Kriminaliteti i të miturve**

Duke u bazuar në literatura të ndryshme dhe autorë të ndryshëm, në një këndvështrim të përgjithshëm, kriminaliteti i të miturve nënkupton gjëra të ndryshme për njerëz të profesioneve të ndryshme. Nga kjo psh: për punonjësit e policisë të miturit dhe të rinjtë me prirje kriminale mund të jenë thjesht kriminelë nën moshë, për autoritetet shkollore ka vështrim të ndryshëm, ata janë nxënësit që largohen nga mësimi, ata që janë dembelë dhe shpesh gjenden në tualetet e shkollës duke pirë duhan apo duke marrë edhe drogë. Nga ana tjetër, për disa prindër delikuentët janë fëmijët e pakontrollueshëm nga prindërit e tyre. Për pronarët e dyqaneve, delikuentë janë të rinjtë që rrijnë gjithë ditën e natën tek qoshja e pallatit.

Nga kjo që u tha më lartë, ekspertët që studjojnë këtë fenomen dhe që punojnë me fëmijët problematikë nuk arrijnë të gjejnë konsensus dhe një pajtueshmëri përse i përket përkufizimit të sjelljes penale tek të miturit. Disa autoritete e përkufizojnë delikuencën si “sjellje emocionalisht e çrregulluar”, të tjerë e shikojnë delikuencën si “sjellje antisociale e vazhdueshme e qëndrueshme”, specialistë të tjerë e përkufizojnë delikuencën si “sjellje e adoleshentëve në një situatë zhgënjimi përtej çdo lloj kufiri”, disa të tjerë më pragmatistë e përkufizojnë atë si “një sjellje që policia do ta konsideronte deviante në çdo lloj rrethane”.

Në një kuptim të ngushtë ligjor të miturit dhe të rinjtë e përfshirë në sjellje kriminale janë analogët e kriminelëve të rritur.<sup>12</sup> Kjo do të thotë se delikuenca e të miturve dhe të rinjve është një status që përcaktohet nga gjykata mbi bazë të legjislacionit vendas, mbështetur në provat dhe të dhënat e grumbulluara<sup>13</sup>. Për më tepër, edhe gjuha e përdorur nga specialistët e

---

<sup>12</sup> Donald J. Newman, Patrick R. Anderson, Introduction to Criminal Justice, New York, 1990

<sup>13</sup> Po aty...

---

fushës, dallon kur ju referohen të miturve. Kështu, një gjykatës për të rritur, në fund të procesit shprehet “mbi bazë provash dhe faktesh gjykata ju shpall fajtor dhe ju dënon...” Në një gjykatë për të mitur, gjykatësi në fund të procesit shprehet “mbi bazë të provave dhe fakteve unë vlerësoj se jeni djalë apo vajzë delikuent”<sup>14</sup>.

Konfuzioni që ekziston lidhur me përkufizimin e kriminalitetit tek të miturit nuk ka të bëjë me atë se cili përkufizim është më i saktë por, është më tepër një problem që ka të bëjë me përpjekjet për të bërë një përkufizim të pranueshëm dhe me pak fjalë për një formë problemi social që nuk është thjesht çështje sjelljeje.

Në fakt, çdo lloj përkufizimi i kriminalitetit që i shkon përshtat agjensisë, familjes, shkollës, ose komunitetit, është po aq i saktë për kontekstin ku përdoret sa edhe çdo lloj përkufizimi tjetër. Megjithatë, megjithëse një të mitur që fqinjët nuk e duan mund të konsiderohet si një delikuent në atë komunitet, kuptimi i kriminalitetit tek të miturit dhe të rinjtë dhe sjelljet përkatëse gjejnë mbështetje në ligj.

Duhet theksuar se ligji nuk mund të përfshijë dhe të bashkojë të gjitha dallimet dhe përkufizimet që ekzistojnë mbi këtë lloj sjelljeje. Ekzistojnë variacione përsa i përket sjelljeve të konsideruara si delikente, paqartësi përsa i përket sjelljeve të ndaluara, mosmarrëveshje përsa i përket moshës maksimale dhe minimale të përfshirë në këto sjellje dhe dallime në qëndrimet e gjykatave lidhur me këtë fenomen<sup>15</sup>.

Kriminaliteti tek të miturit dhe të rinjtë ka dy komponentë të lidhur ngushtë me njëri tjetrin: të miturit dhe të rinjtë si autorë të veprës penale dhe të miturit dhe të rinjtë si viktima apo të dëmtuar prej veprës penale.

Fatkeqësisht, në disa raste të miturit dhe të rinjtë kryejnë vepra penale të ngjashme me aktet kriminale të të rriturve siç mund të jenë vrasjet, vjedhjet, plagosjet, grabitje, përdhunimet etj. Është po ashtu fakt se numri i veprave penale që kryhet nga të miturit dhe të rinjtë është shumë herë më i lartë se ai që mund të mendojnë bashkëmoshatarët e tyre. Nga studimi i të dhënave për kriminalitetin femënor dhe rinor rezulton se krahas individëve të mitur dhe të rinj që kryejnë vepra penale, një numër të konsiderueshëm në këtë moshë përbëjnë edhe viktimat. Të dhënat tregojnë se veçanërisht adoleshentët janë shpesh, në një masë të konsiderueshme, viktima të veprave penale të kryera nga bashkëmoshatarët e tyre.

---

<sup>14</sup> Introduction to Criminal Justice, Donald J. Newman, Patrick R. Anderson, New York, 1990

<sup>15</sup> Po aty...

---

### **3.1. Bandat e të miturve**

Bandat e të miturve përfaqësojnë një lloj të veçantë të sjelljeve devijuese dhe kriminale, e cila karakterizohet nga vlera të veçanta të sistemit dhe kulturave të ndryshme (organizimi i jetesës, sjellja) që i ndajë mes tyre, të cilat i sjellin në konflikt me vlerat dhe normat shoqërore.

Bandat e të miturve janë karakterizuar nga zbatimi i qëllimeve individuale të sjelljeve në grup. Në grup (banda), tërhiqen personalitete të ndryshme që kanë reputacion dhe vlera të ndryshme me qëllim të plotësimit të formave dhe qëllimeve të tyre të përbashkëta (miqësore, shpirtit të ekipit dhe bindjeve reciproke).

Anëtarët zgjidhen dhe pranojnë anëtarë të rinjë në grup vetëm nëse ata jenë të gatshëm për të pranuar rregullat e veçanta të sjelljeve dhe vlerave të sistemit të këtyre grupeve delikuede, në rastin konkret të bandës së të miturve. Grupet e të miturve, në mënyrë të veçantë janë karakteristike e mjedisve urbane, stileve dhe kulturave të ndryshme.

Ata kanë një formë të veçantë të organizimit, në të cilat në krye të udhëheqjes gjendet "lideri" që është udhëzues joformal i grupit i cili siguron unitetin e grupit, i cili ndikon në formimin e qëndrimeve dhe rregullave të disiplinës brenda në grup.

Karakteristikat tradicionale të bandave të të miturve janë si vijon:

- Anëtarët e grupit kryesisht kanë origjinë të njëjtë etnik dhe racore, që vijnë nga familje jo të oganizuara nga lagje dhe zonat të ndryshme urbane,
- Respektojnë normat dhe zakonet e përbashkëta të bandës,
- Egziston kohezioni në mes të anëtarëve,
- Solidariteti dhe miqësia mes tyre tregohet në veprime të dhunshme dhe kriminale,
- Objektivat, rolet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të bandës janë të përcaktuara qartë tek rregullat e bandës,
- Ka një hierarki të përcaktuar dhe llogaridhënie të përcaktuar,
- Zona e veprimit dhe operimit është nën kontrollin e bandës së të miturve.

## **4. Kategoritë e të miturve dhe sanksionet ndaj tyre**

### **4.1. Kategoritë e të miturve**

Për personat e mitur me sjellje delikuede rëndësi të veçantë ka mosha, e cila paraqet element thelbësor të veprave penale, respektivisht kundërvajtjeve të kryera prej personave të mitur.

---

Mosha përcaktohet me përcaktimin e kufirit të miturisë. Për atë me ligj është caktuar kufiri i poshtëm dhe i epërm i miturisë dhe në atë korniza ose kufi kryhet ndarja e të miturve në më të rinj dhe më të vjetër për të cilët është paraparë trajtim i ndryshëm penalo-juridik, respektivisht trajtim kundërvajtës. Me përcaktimin e kufijve, respektivisht kornizave të miturisë dëshirohet gjatë përcaktimit të përgjegjësisë për veprën e kryer të sigurohet dhe zbatohet sistem më i butë i dënimeve prej atij ndaj të rriturve.

Të gjithë personat të cilët janë nën kufirin e poshtëm të moshës llogariten si fëmijë dhe ata nuk i nënshtrohen përgjegjësisë penale dhe të kundërvajtjes.

Kufiri i poshtëm i përgjegjësisë në legjislacionin e disa vendeve është caktuar në mënyrë të ndryshme. Ai në disa vende lëviz prej shtatë deri 14, respektivisht 16 vjet. P.sh., në SHBA kufiri i poshtëm është caktuar në 9 vjet, Angli 10 vjet, Turqi 11 vjet, Francë, 13, Suedi 15, etj.

Në Republikën e Maqedonisë në lidhje me përkufizimin e kufirit të poshtëm të termit fëmijë, duhet të përmendet se sipas kodit penal për të drejtat e të miturve të Republikës së Maqedonisë, nuk ka asnjë përkufizim konkret për moshën e fëmijës viktimë e një krimi dhe nga një analogji e gabuar përdoret apo referohet paragrafi që u përkiste fëmijëve autorë të kryerjes së krimeve apo neni.71, sipas të cilit ndaj miturit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka mbushur 14 vjet (fëmijë) nuk mund të iniciohen sanksioneve penale. Personat të përfshirë në këto kufi të moshës llogariten si delikuent të mitur, kryerës të delikteve ose kundërvajtjeve, varësisht si emërohen.

Sipas kodit penal të Republikës së Maqedonisë për të drejtat e të miturve, në nenin 12, kemi këtë përkufizim sipas grupë moshës<sup>16</sup>:

- ❖ ***i mitur*** është çdo person në moshë deri në 18 vjet, i cili sipas Konventës për të drejtat e fëmijës, konsiderohet si fëmijë,
- ❖ ***fëmijë në rrezik*** është i mituri i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje, ka mbushur shtatë vjet, e nuk i ka mbushur katërmëdhjetë vjet; fëmijë në rrezik konsiderohet edhe i mituri me moshë deri në 14 vjet-i varur nga përdorimi i drogave, substancave psikotropike ose alkooli, fëmijë me pengesa në zhvillim, fëmija-viktimë e dhunës dhe fëmija i braktisur në aspektin e edukimit

---

<sup>16</sup> Ligji për të drejtat e të miturve i Republikës së Maqedonisë, neni 12

---

dhe atë social që gjendet në situatë të tillë në të cilën është vështirësuar ose pamundësuar realizimi i funksionit edukativ i familjes, ose fëmija nuk është përfshirë në sistemin e arsimit dhe edukimit ose është dhënë pas lypësisë, bredhjes ose prostitucionit, i cili për shkak të gjendjeve të tilla është ose mund të bie ndesh me ligjin,

- ❖ ***i mitur i vogël*** është i mituri i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale ose kundërvajtje, i ka mbushur katërmëdhjetë vjet, ndërsa nuk i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet,
- ❖ ***i mitur i vogël në rrezik*** është personi i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale, për të cilin është paraparë dënim me para ose me burg deri në tri vjet ose kundërvajtje, ka mbushur katërmëdhjetë vjet, kurse nuk i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet; ose që është i varur nga përdorimi i drogave, substancave psikotrope ose alkooli, fëmijë me pengesa në zhvillim, fëmijë i braktisur në aspektin e edukimit dhe atë social që gjendet në situatë të tillë në të cilën është vështirësuar ose pamundësuar realizimi i funksionit edukativ i familjes i cili për shkak të gjendjeve të tilla është ose mund të bie ndesh me ligjin,
- ❖ ***i mitur i madh*** është i mituri i cili gjatë kohës së kryerjes së veprimit që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje, ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet, ndërsa nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet,
- ❖ ***i mitur i madhi në rrezik*** është i mituri i cili në kohën e kryerjes së veprimit që me ligj është cilësuar si vepër penale, për të cilën është paraparë dënim me para ose me burg deri në tri vjet ose kundërvajtje, i ka mbushur gjashtëmbëdhjetë vjet, kurse nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë vjet ose që është i varur nga përdorimi i drogave, substancave psikotrope ose alkooli, fëmijë me pengesa në zhvillim dhe fëmijë i braktisur në aspektin e edukimit dhe atë social që gjendet në situatë të tillë në të cilën është vështirësuar ose pamundësuar realizimi i funksionit edukativ i familjes i cili për shkak të gjendjeve të tilla është ose mund të bie ndesh me ligjin,
- ❖ ***person madhor i ri*** është personi i cili në kohën e gjykimit për vepër penale i ka mbushur tetëmbëdhjetë, ndërsa nuk i ka mbushur njëzetë e një vjet.

Në kuadër të këtyre kufijve formohen dy nëngrupe të të miturve më të rinj dhe më të vjetër. Kategorizimi i të miturve bëhet në bazë të njohurive shkencore të cilat janë të lidhura



---

me zhvillimin biofizik, psikologjik, intelektual dhe zhvillimin social të personit dhe të cilat shprehen në mënyrë të ndryshme tek njerëzit dhe varen prej shumë faktorëve. Prandaj është caktuar edhe një fazë kalimtare e kalimit prej miturisë në të rritur (prej moshës 18 deri 21 vjet) që u jep mundësi këtyre personave gjatë vlerësimit të përgjegjësisë së tyre t'i jepet trajtim përafërsisht si i personave të mitur.

#### **4.2. Sanksionet ndaj të miturve dhe qëllimet e tyre**

Sanksion, është pasojë juridike e veprës penale dhe kundërvajtjes që ka të bëjë me heqjen ose kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara të të miturit për shkak veprës së kryer penale ose kundërvajtjes që e shqipton gjyqi në procedurë të përcaktuar më këtë ligj.

Për veprim që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje të kryera nga të miturit, në formë të njejtë zbatohen dispozitat e kodit penal, si dhe dispozitat e ligjit për kundërvajtje dhe ligjet tjera në të cilat janë përcaktuar kundërvajtjet.

Dispozitat e veçanta që vlejnë për kryerësit e mitur të veprave penale zbatohen nën kushte të përcaktuara në dispozitat e këtij kapitulli dhe ndaj personave të moshës madhore kur u gjykohet për vepra penale që i kanë kryer si të mitur, e me përjashtim edhe ndaj personave që kanë kryer vepër penale si të moshës madhore të vogël.

Të miturit të ri për kundërvajtje mund t'i shqiptohen këto sanksione: masë disiplinore vërejtje ose masë mbikëqyrje e përforcuar nga ana e prindërve ose kujdestarit ose masat e mbikëqyrjes së përforcuar nga ana e qendrës për punë sociale. Masa mbikëqyrje e përforcuar nuk mund të shqiptohet në kohëzgjatje më të shkurt se 30 ditë, as më të gjatë se një vit. Me përjashtim, të miturit të rritur për kundërvajtje mund t'i shqiptohet edhe gjobë. Të miturve për kundërvajtje, mund t'u shqiptojë edhe masën shërim të detyrueshëm të alkoolistëve dhe të narkomanëve.

Sipas Nenit 28 te kodit penal për të drejtat e të miturve në republikën e Maqedonisë parashihen këto sanksione ndaj të miturve<sup>17</sup>:

- Ndaj të miturit të vogël për veprim që me ligj është përcaktuar si vepër penale mund të shqiptohen vetëm masa edukuese,
- Ndaj të miturit të madh për veprim që me ligj është përcaktuar si vepër penale mund të shqiptohen masa edukuese, e me përjashtim mund t'i shqiptohet dënim ose masë alternative,

---

<sup>17</sup> Ligji për të drejtat e të miturve i Republikës së Maqedonisë, neni 28

- 
- I mituri i madh mund të lirohet nga dënimi nën kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Kodin penal,
  - Ndaj të miturit për veprim që me ligj është përcaktuar si kundërvajtje mund të shqiptohen sanksione për kundërvajtje të përcaktuara me këtë ligj,
  - Të miturit i shqiptohen masat e sigurisë sipas kushteve të përcaktuara me Kodin penal dhe me këtë ligj,
  - Konfiskimi i pronës dhe i dobisë pronësore dhe sendeve të përfituara me vepra penale dhe kundërvajtje të të miturve, bëhet në pajtim me kushtet e përgjithshme të përcaktuara me Kodin penal.

Sanksioni që i shqiptohet të miturit duhet t'i përgjigjet personalitetit të tij, peshës së veprimit që me ligj është përcaktuar si vepër penale ose kundërvajtje dhe pasojave të tij, nevojave të edukimit të tij, riedukimit, arsimimit dhe zhvillimit, për shkak të sigurimit dhe mbrojtjes së interesit më të mirë të të miturit. Kur janë plotësuar kushtet ligjore, gjykata kompetente shqipton dënim vetëm nëse është i arsyeshëm shqiptimi i masës së edukimit ose masës alternative.

Dënimi që ka të bëjë me privimin nga liria, gjykata kompetente mund ta shqiptojë kur qëllimi i masave edukuese, dënimi ose masat alternative nuk mund të arrihen me masat e ndihmës dhe mbrojtjes. Nëse është shqiptuar sanksion më i rëndë ose sanksion që ka të bëjë në privimin nga liria, gjykata kompetente në mënyrë të veçantë i arsyeton shkaqet e shqiptimit të tij.

Qëllimi i masave edukative, i dënimit, masave alternative dhe sanksioneve për kundërvajtje përbëhet në sigurimin e mbrojtjes dhe ndihmës së të miturve, që të sigurohet edukimi i tyre dhe riedukimi.

Qëllimi i dënimit përbëhet në ushtrimin e ndikimit të përforcuar ndaj të miturve që në të ardhmen të mos bëjnë vepra penale, si dhe ndaj të miturve të tjerë që të mos kryejnë vepra penale.

## **5. Ligji për të drejtat e të miturve**

Ligji për të drejta e të miturve është sjellur dhe miratuar nga parlamenti i Republikës së Maqedonisë më 4 korrik 2007, një reformë e ligjit për të mitur në legjislacionin e Republikës së maqedonisë, për shkak se ajo zbaton standardet ndërkombëtare të drejtësisë për të mitur që

---

kanë të bëjnë me: parimin e mbrojtjes së të miturve dhe të të drejtave të tyre, socializimin dhe ndihmën në trajtimin me të miturit, sanksionet që duhet aplikur me qëllim përmirësimin veprimeve të tyre dhe parandalimin e delikuencës së të miturve.

Qëllimi i miratimit të këtij ligji, është perceptuar në vendimet e mëparshme, në të cilën dispozita për të miturit të jenë në pjesët e përbashkëta të Kodit Penal (KP) dhe Kodit të Procedurës Penale (KPP), që në thelb si qëllim kishin uljen e kriminalitet të të miturve, si rrjedhojë, ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë negativ në pozitën e përgjithshëm dhe pozitën penale juridike të të miturve. Kjo është arsyeja, që ky ligj bëri thirrje që pjesa e të miturve, duhet të nxirren nga pjesa e përgjithshme e të drejtës penale, në këtë mënyrë kur ato paraqiten në një pozitë si kryerës të veprave penale, ato të zgjidhet në mënyrë të veçantë.

Parimet bazë të ligjit për të drejtat e të miturve në Republikën e Maqedonisë janë:

- Parimi i realizimit të interesave më të mira të të miturve,
- Socializimi dhe dhenia e ndihmes për trajtimin e të miturve dhe
- Parandalimi i delikuencës së të miturve<sup>18</sup>.

Objektivat themelore të reformës të përfshira në ligjin për mbrojtjen e të drejtave të të miturve janë parandalimi dhe masat mbrojtëse të fëmijëve nga viktimizimi dhe kriminalizimi i tyre. Për shkak të nevojës për një ligj të ri të veçantë për të rregulluar dhe për të përcaktuar masat e duhura dhe kushtet nën të cilat duhet të trajtohet delikuenca e të miturve, dispozitat thelbësore të kodit penal e rregullojnë tani më si pjesë e ligjit për të drejtat e të miturve.

Ky ligj rregullon trajtimin e fëmijëve në rrezik dhe kryerësve të mitur të veprave që me ligj janë të përcaktuara si krime dhe shkelje, përcaktimin e kushteve për zbatimin dhe aplikimin e masave ndihmëse, kujdesit dhe mbrojtjes, masat edukative dhe masave alternative si dhe dënimin e të miturve, pozitën, rolin dhe kompetencat e organeve që marrin me trajtimin e këtijë problemi<sup>19</sup>. Konkretisht, këto dispozita zbatohen për të miturit të cilër në kohën e kryerjes së krimit janë të miturit, dhe nuk zbatohet për personat nën moshën 14 vjeçe.

Në kapitullin e parë të ligjit për mbrojtjen e të drejtave të të miturve, rregullohet përmbajtja dhe objektivat e ligjit. Sipas dispozitave të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, neni 3-11 i propozim ligjit për të mitur, përfshin parimet e mëposhtme bazë:

---

<sup>18</sup> Projektligji për ndryshim dhe plotësim i ligjit për të drejtat e të miturve, Shkup, Shtator 2010.

<sup>19</sup> Ministria e Drejtësisë, projektligjit për të drejtat e fëmijëve, 2012.

- 
- ⇒ parimi i ligjshmërisë, e drejta për të respektuar të gjitha të drejtat e të miturit të njohura nga Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës dhe dokumenteve të tjera ndërkombëtare, në të gjitha fazat e procedurës dhe vendosjen dhe ekzekutimin e ndonjë sanksioni ose mase të përcaktuar me këtë ligj,
  - ⇒ zbatimin e masave dhe sanksioneve të përcaktuara me këtë ligj dhe trajtimin e të miturve të varur në interes të mbrojtjes, arsimit, rehabilitimin dhe zhvillimin adekuat,
  - ⇒ në zbatimin e masave dhe sanksioneve mund të hiqet ose kufizohen disa të drejta vetëm në atë masë që përgjigjet për nevojën për heqjen e kushteve që ndikojnë në kryerjen e krimeve ose shkeljeve nga të miturit,
  - ⇒ prioritet i masave parandaluese, mbrojtëse dhe arsimore dhe aplikimin e sanksioneve konsistojnë në paraburgimin e të miturve në raste të jashtëzakonshme, ndryshe nuk mund të arrijnë qëllimin,
  - ⇒ iniciimi i procedurave nga autoritetet kompetente për të shmangur efektet e dëmshme mbi të miturit, përveç nëse karakteristikat personale të të miturit dhe rrethanat e kryerjes së veprës, nuk tregojnë nevojën për kryerjen e procedurave gjyqësore,
  - ⇒ e drejta për procedurat gjyqësore dhe e drejta për një gjyq të paanshëm dhe të pavarur.

Neni 12 rregullon kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve të caktuara. Risi është përcaktimi i termit "fëmijë në rrezik", që nënkupton një të mitur në kohën e kryerjes së veprës penale që me ligj është përcaktuar si krim ose shkelje, e ka mbushur moshën 7 vjet dhe nuk i ka mbushur 14 vjet. Fëmija në rrezik konsiderohet i mitur në 14 vjet – të miturit të varur nga droga, substancave psikotrope apo alkooli, një fëmijë me aftësi të kufizuara, fëmijët viktimë të dhunës, fëmijë të lënë pas dore si në aspektin arsimor por edhe social, i cili gjendet në aso situatë në të cilën është e vështirë ose e pamundur realizimi i funksionit edukues të familjes, i orientuar drejtë lypësis dhe prostitucionit e cila përshkak të këtyre gjendjeve është ose mundet që të vijë në konflikt me ligjin.

Në kapitullin e dytë, një risi e rëndësishme janë inkorporuar dy standardet kryesore të parashikuara në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe Dispozitat e Riadit dhe dispozitat e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e delikuentëve: anashkalimin e procedurave gjyqësore, duke përdorur dhe zbatuar masat e ndihmës dhe mbrojtjes për një fëmijë në rrezik dhe

---

rregullimin e procedurës së ndërmjetësimit në mes të qendrës për punë sociale dhe qendrës për të mitur, për kthimin ose kompensimin e të ardhurave, për dëmin e shkaktuar nga i mituri.

Kështu që, dispozita e nenit për fëmijët në rrezik parashikon zbatimin e masave ndihmëse dhe masave mbrojtëse. Masat ndihmëse dhe mbrojtëse, janë masa të përcaktuara me ligj në fushën e arsimit, shëndetësisë, fushën sociale, familjen dhe forma të tjera të mbrojtjes dhe mund të aplikohet për të miturit më të ri dhe më të vjetër në rrezik.

Për një fëmijë në rrezik zbatohen masat ndihmëse dhe mbrojtje vetëm atëherë kur qendra për punë sociale konstaton se gjendja e rrezikut që ndikojnë në zhvillimin e personalitetit të fëmijës dhe rritjen e tij të duhur, mund të ndikojnë që në të ardhmen të kryerj vepra kriminale ose shkelje. Masat e ndihmës dhe mbrojtjes mund të aplikohet dhe për anëtarët e familjes, në qoftë se e lënë pas dore ose abuzojnë me ushtrimin e të drejtave ose detyrimeve në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe interesave si dhe personalitetit të fëmijës.

Ligji rregullon rregullat e përgjithshme mbi sanksionet e shqiptuara për të mitur. Sanksionet që mund të shqiptohen ndaj të miturit janë:

1. Masa edukative
2. Masat disiplinore: vërejtje apo dërgim në qendër disiplinore,
3. Masat e mbikëqyrjes së përforcuar: nga prindërit, prindërit adoptues ose kujdestarit ose mbikëqyrje nga një organ shoqëror,
4. Masa institucionale: dërgimit në një institucion edukativ dhe arsimor, dërgimi në institucion korrigjues.

Para se të zgjedhjen masat edukative, gjykata do të marrë parasysh moshën e të miturit, shkallën e zhvillimit të tij mendore, tipare psikologjike të tij, dispozitat, motivet për kryerjen e krimit, edukimin paraprak, mjedisin dhe rrethanat në të cilën ai jeton, pesha e rastit apo veprës penale, në qoftë se ai deri më tani ka qenë i dënuar me masë edukative ose të burgimit për të mitur si dhe rrethana të tjera që ndikojnë në përcaktimin e llojit të masës për të arritur objektivin e saj të vendosur me ligj<sup>20</sup>. Në rastet kur i mituri është në një shkallë të lartë të përgjegjësisë penale, dhe kjo e pamundëson vendosjen e masës edukative për të mitur, atëherë tek të miturit do të zbatohen dispozitat e kapitullit pesë, të cilat mundësojnë dënimin e duhur e të miturve edhe ate:

---

<sup>20</sup> Neni 32 i ligjit për të drejtat e të miturve, Gazeta Zyrtare Nr 87/2007.

- 
- *Burgu për të mitur,*
  - *Gjobë ne të holla,*
  - *Një ndalim i drejtimit të automjetit të një lloji të caktuar ose kategori e caktuar, dhe*
  - *Dëbimi nga vendi.*

Penalisht, të miturit të cilët përgjegjen dhe janë më të vjetër, mund t'i shqiptohen masa alternative të mëposhtme:

- *Gjykim sprovues me mbikëqyrje mbrojtëse;*
- *Ndërprerja e kushtëzuar e procedurës ndaj të miturit, dhe*
- *Shërbimi në komunitet.*

Tek të mitur, si masë edukative ose dënimit mund të shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucionin shëndetësor ose mjekim të detyrueshëm psikiatrik apo trajtim të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve. Tek një pjesë e vogël e të miturve, sipas kushteve të parashikuara në kodin penal mund t'i shqiptohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në një institucion mjekësor dhe trajtimit të detyrueshëm psikiatrik<sup>21</sup>.

Një risi në kapitullin e gjashtë është futja e një mase të re alternative të dënimit me kusht me mbikëqyrje mbrojtëse, që mund të vendoset në të mitur (më të vjetër) që penalisht janë përgjegjës. Gjithashtu në nenet 55-57 janë të rregullura kushtet e veçanta për caktimin e masave alternative: gjykim sprovues me mbikëqyrje mbrojtëse dhe ndërprerja me kusht e procedurës ndaj të miturit dhe shërbimit të komunitetit.

Në kapitullin e dhjetë, rregullohen të dhënat e sanksioneve të vendosura për veprë penale dhe sanksionet për kundërvajtje. Gjithashtu, edhe të dhënat e sanksioneve të vendosura për vepra penale dhe sanksionet për kundërvajtje ndaj të miturit dhe të rriturit e rinj nga gjykata kompetente sipas vendit të lindjes. Risia është se të dhënat e sanksioneve të vendosura për vepra penale dhe sanksione për kundërvajtje për person të mitur dhe të rritur të rinjë të lindur jashtë vendit ose në ndonjë vend të panjohur të lindjes, i cili qëndron në regjistrin e vetëm në Republikën e Maqedonisë, që e posedon Gjykatës Themelore Shkup I në Shkup.

Të dhënat mbi vendosjen e sanksioneve mund të jepen vetëm nga gjykata, prokurori publik dhe nga institucionet që merren me mbrojtjen e të miturve në lidhje me një procedurë të re që është ngritur ndaj të miturit apo të rritur të ri për një veprë penale ose kundërvajtje.

---

<sup>21</sup> Neni 58 dhe 59 i ligjit për të drejtat e të miturve, Gazeta Zyrtare Nr 87/2007.

---

Të dhënat për masat e shqiptuara disiplinore, masat e mbikëqyrjes së përforcuar dhe sanksione kundërvajtëse, u fshihen nga evidenca kur atyre ju kalojnë një vit i kryerjes së dënimit, nëse i mituri ose i rritur i ri gjatë asaj periudhe nuk kryen vepër tjetër penale ose kundërvajtje.

Të dhënat për gjykim sprovues me mbikëqyrje mbrojtëse, do të fshihen nga evidenca pas një viti nga përfundimi i shqyrtimit, nëse i mituri ose i rritur i ri gjatë asaj periudhe nuk kryen një tjetër vepër penale.

Të dhënat mbi masat institucionale të imponuara, gjobave dhe masave alternative do të fshihen nga evidenca atëherë kur i mituri i ka kryer dy vite të dënimit, nëse i mituri ose i rritur i ri gjatë asaj periudhe nuk kryen tjetër vepër penale ose kundërvajtje.

Të dhënat mbi dënim me burg për të mitur, fshihen nga evidenca pas pesë vitësh nga dita e kryerjes, bëhet e vjetëruar ose shlyehet, në qoftë se në atë kohë i mituri ose i rritur i ri nuk do të kryejë një tjetër vepër penale ose kundërvajtje. Në raste të plotësimit të kushteve të specifikuara në paragrafët e mësipërm, të dhënat mbi sanksionet e aplikuara do të fshihen nga evidenca dhe të gjitha dokumentet do të anulohen nga fuqia e ligjit.

Në kapitullin e dymbëdhjetë rregullohet procedura e ndërmjetësimit: kushtet për ndërmjetësim, përcaktimi i ndërmjetësuesit, kohëzgjatjen e procedurës së ndërmjetësimit si dhe kryerjen e procedurës së ndërmjetësimit dhe përfundimin e procedurës së ndërmjetësimit.

Ligji për të drejtat e të mitur, vënë theksin në parandalimin e delikuencës së të miturve që është perceptuar në një pjesë të veçantë, pjesa e gjashtë, në një kapitull të veçantë rregullohet parandalimi i delikuencës së të miturve, me anë të së cilës rregullohet formimi i Këshillit Kombëtar për Parandalimin e delikuencës dhe Këshilli i Komunës me të njëjtin objektiv.

Këshilli i Shtetit i përbërë nga 15 anëtarë, është organ i pavarur që merret me kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ligji për të drejtat e të miturve, i cili ka përgjegjësitë e mëposhtme:

- ✦ Të miratohet një strategji kombëtare për parandalimin e delikuencës së të miturve,
- ✦ Miratimi i programeve dhe planeve për realizimin e programit vjetor;
- ✦ Të miratojë Rregulloren e punës,

- 
- ⇒ Propozon fonde në llogaritjen draft buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë të nevojshme për punën e tij,
  - ⇒ Nisin iniciativa për të përmirësuar vendimet ligjore dhe jep mendime dhe rekomandime për projektligje të rëndësishme për mbrojtjen e të miturve dhe parandalimin e delikuencës së të miturve,
  - ⇒ Ngrenë iniciativa me qëllim të informiti të qytetarve me të drejtat e të miturve dhe diskutime mbi familjen e shëndoshë, për të mbrojtur të miturit nga varësia nga droga, alkoolizmi dhe veseve të tjera, problemet e arsimit dhe edukimit, marrëdhëniet e medias dhe faktorëve të tjerë që ndikojnë në parandalimin e delikuencës së të miturve,
  - ⇒ Inicon kërkime dhe studime mbi problemet e delikuencës së të miturve,
  - ⇒ Bashkëpunon me organizatat ndërkombëtare dhe organe të tjera që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe parandalimin e delikuencës së të miturve,
  - ⇒ Bënë përgatitjen e raporteve vjetore për punën e tij dhe për gjendjen në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuencës së të miturve që i dorëzon në Kuvend dhe Qeveri, Këshillin Gjyqësor dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë, të cilët janë të detyruar të marrin në konsideratë dhe të marrin masat e duhura dhe aktivitetet, në përputhje me përgjegjësitë e tyre,
  - ⇒ Menaxhon me asetet dhe fondet e kompenzimit.<sup>22</sup>

Këshillat komunale miratojnë programet vjetore për punën e tyre, që e miraton këshilli komunal dhe këshilli i qytetit të Shkupit, rregullin e punës së tyre, në komunë dhe në qytetin e Shkupit, që kryejnë veprimtari për të monitoruar situatën, duke filluar nga iniciativat për përmirësimin e tyre dhe zhvillimin e programeve me qëllim të përfshirjes së komunitetin lokal në parandalimin e delikuencës së të miturve dhe trajtimin e shkelësve (të miturve) në vepra penale dhe kundërvajtje<sup>23</sup>.

Raporti i këshillit shtetëror për parandalim i vitit 2011, ndër të tjera thekson rekomandimet e mëposhtme, të cilët janë të një rëndësie të veçantë për temën tonë si më poshtë:

---

<sup>22</sup> Shihë ligjin mbi të drejtat e të miturve, kapitulli i shtatëmbdhjetë, neni 144.

<sup>23</sup> Shihë ligjin mbi të drejtat e të miturve, kapitulli i shtatëmbdhjetë, neni 148.



- 
- ⇒ Autoritetet kompetente të Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me këshillin shtetëror për parandalimin e delikuencës së të miturve, t'i forcojnë programet e parandalimit në shkolla, kështu bëhet e mundur zbulimi i hershëm dhe parandalimi i ngjarjeve të tilla,
  - ⇒ Të forcohen veprimet parandaluese të ekipeve profesionale në shkolla (pedagogët dhe psikologët), dhe këshillat e prindërve të nxënësve,
  - ⇒ Të intensifikojë komunikimin midis kujdestarëve të klasave, drejtorëve dhe prindërve,
  - ⇒ Duke marrë parasysh se çështjet e caktuara në media nxisin dhunën, i rekomandojnë këshillit të radiodifuzionit për të ndaluar transmetimin e programeve të tilla, të cilat kontribuojnë për të rritur rrezikun duke manifestuar këtë dhunë në mes të të miturve,
  - ⇒ Autoritetet kompetente duhet t'i raportojnë rregullisht këshillit në të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit për të drejtat e të miturve dhe të drejtat e fëmijëve,
  - ⇒ Autoritetet kompetente me kërkesë të këshillit, të mundësojë dhe të sigurojë qasje në të dhënat që kanë të bëjnë me delikuencën e të miturve<sup>24</sup>.

Këto rekomandime do të ketë një ndikim të madh në gjendjen e delikuencës së të miturve dhe në një pjesë të delikuencës së të miturve dhe të kriminalitet në përgjithsi, në qoftë se të gjitha organet kompetente që merren me këtë problematikë, do të bëjë një përpjekje për të zbatuar plotësisht ato dhe do të mundësojnë një reagim të duhur dhe efektiv.

Konkretisht, këto rekomandime janë një tjetër tregues që shoqëria duhet t'i trajtojë masat parandaluese dhe të përmirësojë funksionimin e shkollave, rrjetin e komunikimit të shkollave, të mundësojë një bashkëpunim më të madh në mes autoriteteve me fëmijët që shfaqin sjellje të devijuara, përzgjedhja e kujdesëshme e transmetimeve nëpërmjet medimeve për shkak të rritjes së rrezikut për të shkaktuar dhunën në mesin e të miturve dhe masave të tjera, të cilat në qoftë se ato do të ishin të realizuara ndonjëherë, nuk do të ishte përmendur në raportin e këshillit të shtetit për parandalimin e delikuencës së të miturve.

---

<sup>24</sup> Raporti Vjetor i Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës së të miturve dhe gjendja në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuencës së të miturve në vitin 2011.

---

### **5.1. Zhvillimi i reforma për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në Republikën e Maqedonisë**

Zhvillimi i reformave për mbrojtjen e të drejtave të të miturve në Republikën e Maqedonisë ka pësuar ndryshime të konsiderueshme nga koha në kohë. Për të kuptuar më lehtë procesin e zhvillimit të sistemit të drejtësisë për të mitur në vend, ne së pari do të japim një pasqyrë të shkurtër të gjendjes dhe situatës së të drejtave të të miturve në sistemin penal në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX.

Deri në krijimin e Mbretërisë së Jugosllavisë, në zonën e sapokrijuar të Mbretërisë në të cilën përfshiheshte edhe zona e Republikës së Maqedonisë, është përdorur legjislacioni ligjor për statusin penal juridik të të miturve, i cili ka patur një ndikim të fuqimishëm në lëvizjet reformuese në trajtimin e të miturve<sup>25</sup>. Kodi Penal i Principatës së Serbisë i vitit 1860 dhe ligjit për procedurat gjyqësore në çështjet penale i vitit 1865, shënon fillimin e zhvillimit të legjislacionit modern penal në këtë fushë. Ligji parashikon për përgjegjësinë penale të personave mbi 12 vjet, në këtë pjesë ka pësuar ndryshime, në të cilën kufiri i moshës madhore të të rritur u zhvendos në 16 vjet. Tek te miturit në vend dënimit me vdekje, u është shqiptuar dënimit me burgim deri në 10 vjet, ndërsa, personat deri në 21 vjet u janë nënshtruar shqiptimit të një dënimi maksimal deri në dy të tretat e atyre të planifikuara për të rriturit. Për fëmijët që penalisht janë të papërgjegjshëm nën moshën 12 vjet, kujdesi për "dënim" për veprën e kryer, u është lënë prindërve, mësuesit dhe edukatorëve të tyre<sup>26</sup>.

Miratimi i Ligjit për arsim të detyruar të të miturve në vitin 1902 në Kroaci, krijon një klimë për trajtim jo vetëm tek kryesit e mitur të veprave penale, por edhe të miturit "që janë të dobët, dhe që duhet të mbrohen nga shkatërrimi moral"<sup>27</sup>. Edukimi dhe arsimimi i detyruar është kryer në familje ose në një institucion shtetëror, deri në moshën 18 vjeçare, gjykata ka kryer riedukim të këtyre të miturve që kanë kryer vepra penale, ndërsa për edukimin dhe arsimimin e të miturve të braktisur, organi kompetent, për riedukimin dhe arsimimin e detyrueshëm, u është caktuar gjykatës kujdestar.

---

<sup>25</sup> Velikova, T. "Fenomelogija za maloletnicki kriminalitet vo Republika Makedonija vo period od 1981-2000", Shtip: 2006

<sup>26</sup> Knezevic, S. " Maloletnicko krivico pravo-materialno, procesno i izvrsheno", Nish, 2010

<sup>27</sup> Velikova, T. "Fenomelogija za maloletnicki kriminalitet vo Republika Makedonija vo period od 1981-2000", Shtip, 2006

---

Një hap i rëndësishëm në zhvillimin e së drejtës penale për të mitur, është Kodi Penal i Mbretërisë së Jugosllavisë i vitit 1929. Në vitin e njejtë është sjellur dhe miratuar edhe ligji për procedurë gjyqësore penale, që iu referohet procedurave kundër të miturve më të rinjë (nga mosha 14 vjeçare e deri në moshën 17 vjeçare), të merren para një gjygi për të miturit më të rinj, si gjykatë me juridiksion të veçantë brenda kornizave të gjykatës së rregullt". Në kodin penal, janë parashikuar masat edukative të qortimit, lëshimi i të miturve në "dënim shtëpiak ose në edukim shkollor", masë edukative "edukim brenda familjes" dhe masat institucionale<sup>28</sup>.

Pas Luftës së Dytë Botërore, u solli kodi i parë i përgjithshëm penal, në të cilin, në pjesën e përgjithëshme të kodit penal të vitit 1947, të miturit nga mosha 14 vjeçare e deri në moshën 18 vjeçare, i klasifikonte në dy grupe: në të mitur penalisht përgjegjës dhe të mitur penalisht të papërgjegjshëm, klasifikimi është bërë në bazë të kriterit të arsyeshmërisë. Për grupin e parë ishin paraparë gjopa në të holla (me përjashtim të të dënuarve me vdekje), ndërsa për grupin e dytë u caktuan masa edukative.

Kodi penal i vitit 1959, ka pasur përparim të rëndësishëm në ndërtimin e statusit të të miturve në sistemin e së drejtës penale. Me këtë ligj, përfundimish u braktis parimi i arsyeshmërisë, ai prezanton konceptin e mbrojtjes dhe ndihmës për të miturit, nëpërmjet të edukimit të tij, rehabilitimit dhe mbikqyrjes. Kryerja e një veprë penale, është vetëm një pikënisje për planifikimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave të duhura, duke u përqendruar në personalitetin e të miturit dhe në interes të tij më të mirë. Në këtë ligj, dispozitat që kanë të bëjnë me të miturit, janë të sistemuar në një kapitull të veçantë dhe kanë dispozita të veçanta dhe dalluese në krahasim me dispozitat e përgjithshme të Kodit Penal. Masat edukative janë sanksione themelore edhe për dy kategoritë e të miturve (nën moshën 14 vjeçare, e deri në moshën 16 vjeçare, si dhe mbi moshën 16 vjeçare e deri moshën 18 vjeçare), ndërsa dënimi me burgim për të mitur u është shqiptuar vetëm në raste të jashtëzakonshme. Në shqiptimin e masës edukative, kryesisht, gjykata në radhë të parë mbështetet dhe fillon nga personaliteti i të miturve dhe nga nevoja për mbrojtjen dhe edukimin e tyre. Ky ligj, si një risi në vehte ngërthen edhe kategorinë e të rriturve të rinjë, i cili përfshinë personat që gjatë gjykimit nuk janë më të vjetër se 21 vjet dhe se në kushte të caktuara mund të vendosen edhe masat edukative të përcaktuara për të mitur.

---

<sup>28</sup> Knezevic, S. " Maloletnicko krivicno pravo-materialno, procesno i izvrseno", Nish, 2010

---

Kodi Penal i vitit 1959, është baza e sistemit modern penal për të mitur, vendimet e të cilit janë pranuar gjerësisht në kodin penal të ish Federatës Socialiste të Republikës së Jugosllavisë në vitin 1977, dhe më pas në kodin penal të Republikës së Maqedonisë që nga viti 1996.

Ligji Penal i Republikës së pavarur të Maqedonisë, që nga viti 1996, i ka ruajtur përfitimet moderne shkencore, si në aspektin teorike të mbrojtjes, asistencës dhe kujdesin për të miturit, ashtu edhe të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me të miturit që janë të sistemuar në kapitullin e VI-të të veçantë të këtij ligji. Në përputhje me dispozitat dhe ligjin për kryerësit e mitur të veprave penale, mund të iu shqiptohet dënime me masa edukative: disiplinore (vërejtje dhe qëndrim në qendrën për korrigjim), masat e mbikëqyrjes së përforcuar (nga ana e prindërve, nga familjet adaptuese ose nga një institucion shoqëror) dhe masat institucionale (dërguar në një institucion edukativ dhe arsimor dhe vendosjen në një qendër korrigjuese (përmisuese) dhe edukative). Një i mitur i cili në kohën e kryerjes së veprës penale, e ka mbushur moshën 16 vjeçare dhe nuk e ka mbushur moshën 18 vjeçare (të mitur më të vjetër), në raste të jashtëzakonshme mund të shqiptohet masa edukative me burgim për të mitur. Të miturve, nuk mund të shqiptohet qortimin apo vërejtje gjyqësor ose dënimin me kusht, por nën kushtet e parashikuara nga Kodi Penal i vitit 1996, të miturve mund të vendosen dhe të shqiptohen masat e sigurisë.

Përveç sistematizimit të dispozitave, ky ligj ende nuk ka sjellë ndonjë risi të veçantë për sa i përket zgjidhjes së statusit të drejtësisë penale të të miturve. Disa ndryshime në aspektin e sistemit të sanksioneve për të miturit, u sollën në e Kodit Penal të vitit 2004, në të cilën, repertori i gjobave është zgjeruar me dëbimin nga vendi dhe ndalim të drejtimit të automjetit. Si sanksione të reja, janë parashikuar edhe masa alternative: ndërprerjen e procedurës penale dhe të shërbimit të komunitetit. Me këto ndryshime, me të cilat e drejta penale për të mitur, bashkohet me trendet bashkëkohore të trajtimit të kryesve të miturit të veprave penale, e cila ishte një hyrje për një reformë të plotë e cila përfundoi me miratimin e ligjit për të mitur në korrik të vitit 2007.

Ligji për të drejtat e të miturve është vendosur sipas parimeve që rregullojnë pozitat e të miturve në sistemin e së drejtës penale, konceptin e katër D-ve: diversion, de-judicialisation, de-institutionalisation, due process<sup>29</sup>. Në faktë, këto parime bashkojnë rekomandimet e përcaktuara në Konventën për të drejtat e fëmijëve, në veçanti ajo thekson parimin e interesit

---

<sup>29</sup> Najčevska, M. "Najdobriot interes na deteto vo sistemot na maloletnicka prava", Akademia e Policisë, Shkup 2008

---

më të mirë të fëmijës, e cila në mënyrë specifike promovon administrimin e të drejtave për të miturit, veçanërisht kur potencohet se të miturit duhet të trajtohen në një mënyrë që siguron promovimin e dinjitetit të tyre, vlerën e tyre individuale dhe kujdesin për të drejtat njerëzore të fëmijëve, duke marrë parasysh moshën e fëmijës dhe nevojat e tyre të veçanta<sup>30</sup>. Në këtë kontekst, ligji i të drejtave për të mitur, parasheh "zbatimi e masave dhe sanksioneve të përcaktuara me këtë ligj dhe veprimi me trajtimin e të miturve të zgjidhet në interesin e tij për mbrojtje, edukimin, rehabilitimin dhe zhvillimin e duhur".<sup>31</sup>

Ligji për të drejtat e të miturve, vazhdimisht u përgjigjet kërkesave për përmirësimin e gjendjes së të miturve në sistemin e së drejtës penale dhe në përputhje me dispozitat dhe rekomandimet, normat dhe standardet ndërkombëtare, statusin e tyre si dhe të drejtat e të miturve. Megjithatë, zbatimi i vërtetë i ligjit në praktikë, presupozon ndryshime në disa institucione profesionale dhe profileve profesionale, kryesisht qendrat për punë sociale, në të cilat bëhet promovimi i shpejtë i kushteve fizike dhe teknike, si dhe trajnimi dhe numri i stafit profesional që punojnë në këtë fushë.

## **6. Trajtimi i të miturve në bazë të legjislacionit të RM-së**

Praktika gjyqësore në Republikën e Maqedonisë për sa u përket të miturve dëshmon për një sanksionim shumë të ashpër dhe për sa i përket mënyrës së sanksionimit, egzistojnë edhe raste që të miturit në Republikën e Maqedonisë vuajnë bashkërisht shqiptimin e dënimit. Kjo nënkupton që drejtësia për të mitur nuk është dhe aq e vëmendshme për sa i përket faktorëve preventiv që të ndikojnë pozitivisht, edhe atëherë kur një vepër penale nga një i mitur mund të ketë ardhur si pasojë e një dëmi të caktuar pasuror apo jo-pasuror rastesisht nga ana e një të mituri.

Në vazhdim do të bëjmë një përshkrim të legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë në anën formale ligjore dhe paralelisht dhe zbatimin e tijë në praktikën e përditshme të dhënies të së drejtës për të miturit në këto hapësira. E drejta penale për të mitur është pjesë e sistemit të përgjithshëm penalo-juridik. Sipas legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë (neni.70), për kryesit e miturit të veprave penale vlejnë dispozitat e tij (të përfshira në kapitullin

---

<sup>30</sup> Najčevska, M. "Najdobriot interes na deteto vo sistemot na maloletnicka prava", Akademia e Policisë, Shkup, 2008,

<sup>31</sup> Ligji për të drejtat e të miturve (Gazeta Zyrtare no.87/2007, 103/2007, 161/2007 dhe 145/2010)

---

e gjashtë) për masë edukuese për të miturit dhe dispozita tjera të ligjit të cilët nuk janë në kundërshtim me këto dispozita.

Dispozitat e posaçme për kryes të mitur zbatohen në kushte të caktuara ligjore dhe mbi personat e rritur kur dënohen për vepra penale që i kanë kryer si të mitur dhe me përjashtim edhe mbi persona që kanë kryer vepra si të rritur më të rinj. *De lege lata* d.m.th. e drejtë penale për të mitur edhe më formale, por edhe në kuptimin themelor e integruar në të drejtë e përgjithshme penale. Si delikuent të mitur llogariten vetëm të miturit që kanë kryer vepër e cila me ligj është e paraparë si vepër penale. Me këtë, ligjvënësi ynë, tani për tani, është përcaktuar në raport të pyetjes shumë të ndjeshme rreth qasjes segmentare kah kërkimi i zgjidhjes sa më të mirë për problemin e delikuencës së të miturve, ngjashëm edhe me krimin e organizuar, krimi i dhunshëm etj.

Padyshim është se qasja e tillë e fsheh rrezikun që e drejta penale të imtësohet (ndahet) në disa degë të cilat gjithnjë e më shumë do të largoheshin njëra prej tjetrës dhe do të formoheshin mbi parimet e ndryshme dhe instituteve të ndryshme: e drejtë penale autonome për të mitur, e drejtë penale ekologjike, e drejtë penale ekonomike, e drejtë penale kompjuterike etj. Përcaktim themelor i kodit penal të Republikës së Maqedonisë në raport me përmbajtjen, funksionet dhe qëllimet e së drejtës penale për të mitur është i determinuar me këtë qasje: sistemi i tij kategorial mbështet mbi veprën penale, por në raport me përgjegjësinë penale dhe sistemin e sanksioneve ajo ka pozicion me autonomi të plotë.

Duhet theksuar se e veçanta e trajtimit penalo-juridik të kryesve të mitur reflektohet në mënyrë të kthyeshe edhe mbi kuptimin për nocionin e veprës penale. Definicioni i tij në kuptimin objektiv-subjektiv (si veprim i paraparë në ligj, antiligjor, fajtor dhe i dënueshëm) qartazi se nuk mund t'u përgjigjet nevojave specifike të trajtimit të të miturve. Jo rastësisht, në këtë kuptim legjislacionit penal i Republikës së Maqedonisë aspak nuk e largon nocionin e përgjegjësisë penale për të miturit, duke i shfrytëzuar vetëm të miturit më të vjetër kur bëhet fjalë për vepër më të rëndë (sipas nenit 86, mund të dënohet vetëm i mitur më i vjetër i cili është penalisht përgjegjës). Përkundër aftësisë së supozuar për fajin e të rriturve, supozim për papërgjegjësinë e të miturve është konsekuencë e statusit të tyre të përgjithshëm juridik, kapaciteti i plotë i të cilit (aftësi e pjesëshme, aftësi për bashkësho-rtësi etj) arrihet me rritje e tij duke mbushur moshën 18 vjet.

---

Nga ana tjetër, pranimi i nocionit objektiv të veprës penale (vepër antiligjore, pa ekzistimin e fajit) ndeshet me disa pengesa plotësuese: p.sh. kur ekzistimi i veprës paraqet element subjektiv (qëllim, paramendim special etj) ose në rastet në të cilat ligji i dënon vetëm kryerjen me paramendim të veprës, siç mund të jetë rasti nëse ndonjë i mitur i shkakton tjetrit lëndime trupore, sipas nenit 130 të legjislacionit penal të Republikës së Maqedonisë, për të cilën dënohet vetëm nëse është shkaktuar veprimi me paramendim, a mundet veprimi i tillë të trajtohet si vepër penale nëse pyetja për paramendimin, ose pakujdesinë, gjegjësisht faji i të miturit është deplasuar që më parë. Megjithatë kushtëzimi i trajtimit penalo-juridik të të miturit me sjelljen që i plotëson shënimet objektive të veprës penale është në pajtueshmëri siç është rasti me parimin e ligjshmërisë dhe sigurimin e garancioneve juridike për të drejtat e tij.

Nga ana tjetër, nuk duhet të harrohet se e drejta penale e të miturve edhe në rastin e legjislacionit tonë dhe zhvillimin e saj është krijuar nëpërmjet emancipimit gradual prej të drejtës penale të të rriturve dhe se tendenca e tillë ka pavarësi jo vetëm që nuk është ndërprerë, por në dekadat e fundit është forcuar edhe më shumë. Koegzistenca e saj e qetë me të drejtën penale të përgjithshme (sistem në sistem) mbahet dhe mund të mbahet edhe më tej nëse në ndërkohë hulumtimet kriminologjike si dhe drejtimit e saja kriminalo-politike (para së gjithash lëvizja e mbrojtjes së përgjithshme) nuk e kanë hapur çështjen për faktorët kriminogjen dhe për pjesëmarrjen e vet shoqërisë në krimin individual, për kriminelin jo si njeri i prishur moralisht dhe njeri i keq, por si viktimë e gjendjes shoqërore.

Posaçërisht teza e fundit u bë pothuajse preokupim qendror i politikës kriminale dhe kriminologjisë së delikuencës së të miturve. Shkelësit e mitur për herë të parë janë viktimë e shoqërisë moderne, të faktorëve të fortë kriminogjen që i toleron si dhe mosorganizimin e saj dhe mosrezistimin kah ndalimi i ndikimeve të dëmshme mbi të rinjtë.

Sa ka shoqëria të drejtë të mbrohet prej krimit të të rinjve po aq edhe të rinjtë kanë të drejtë të mbrohen prej ndikimeve negative të shoqërisë në zhvillimin e tyre. Është e padyshimtë se nëpërmjet trajtimit të kësaj kategorie të kryesve, zbardhet segmenti më i ndijshëm i të drejtës penale bashkëkohore dhe kriza e saj. Parashtrohet pyetja se, si trajtimi i tyre penalo-juridik mund të ndihmoj për t'u kaluar kriza e tillë, nëse vet e drejta penale nuk është asgjë tjetër pos *ultima ratio*, mjet i fundit për shkatërrimin e kriminalitetit, ose nëse pranohet pamundësia e saj, a ka ardhur te pika kur duhet të shpallet bankrotim i përgjegjësisë penalo-juridike të problemeve të të rinjve dhe i njëjti të zëvendësohet me qasje të re i ndryshueshëm prej atij tradicional.

---

Specifikat e të drejtës penale për të mitur janë kryesisht të koncentruara në sistemin e sanksioneve të tyre. Ideja udhëheqëse në të drejtën penale për të miturit është ideja e edukimit, përmirësimit dhe ndihma e të miturit. Parimi i preventivës individuale dhe risocializimit si parim themelor i të drejtës penale, në të cilën jepet një bazë më konkrete për sqarim: i mituri nuk duhet të risocializohet, por të socializohet, nuk duhet të riedukohet por shumë shpesh edhe të edukohet. Edukimit si funksion themelor i të drejtës penale për të mitur e ka organikisht të huaj idenë e kufizimit të dhunshëm të disa të drejtave si reaksion i veprës penale. Si korreksion i mekanizmave tjera shoqërore të socializimit (familja, shkolla, mesi më i ngushtë) duhet që sa të jetë e mundur t'u ngjajnë atyre dhe të jetë i drejtuar kah veprimi indirekt me riaktivizimin e tyre, si masat edukuese në familje.

Efektet e presupozuara edukuese të së drejtës penale për të mitur janë që më parë të kufizuar, sepse janë të drejtuar kah personaliteti i të miturit, familjes së tij dhe institucioneve edukative për ndihmë dhe kujdes të delikuentëve të mitur. Ata për fat të keq nuk kanë qasje dhe nuk mund t'i çrrënjosin faktorët shoqëror të delikuencës së të miturve, duke e kufizuar në radhë të parë bllokimin e veprimeve negative të tyre që ndikojnë në zhvillimin e të miturit. Orientimi (ri)edukues speciało-preventiv i të drejtës penale për të mitur i determinon edhe natyrën, funksionet dhe qëllimet e sistemit të tij të sanksioneve. Sanksione themelore janë masat edukuese, ndërsa dënimet dhe masat alternative kanë rolin sekondar, rezervë. Masat edukuese janë mjete të preventivës dhe socializimit me të cilat është institucionalizuar juridikisht angazhimi i bashkësisë në ndihmën dhe kujdesin e të miturit dhe nxitjen e sjelljeve pozitive në personalitetin e tij. Dënimi si sanksion sekondar zbatohet vetëm te veprat e rënda gjatë ekzistimit të përgjegjësisë penale të të miturit nëse nuk është i arsyetuar shqiptimi i masave të sigurisë.

Në këtë kuptim kodi penal i Republikës së Maqedonisë e përcakton edhe qëllimin e masës edukuese, dënimin dhe masën alternative (neni.73): qëllimi i këtyre sanksioneve është që me dhënien e ndihmës dhe mbrojtjes së kryesve të mitur të veprave penale me mbikëqyrjen e tyre, me aftësimin profesional të tyre dhe me zhvillimin e përgjegjësisë penale personale, të sigurohet edukimi i tyre, riedukimi dhe zhvillim i drejtë. Si qëllim i posaçëm i burgut për të mitur është përcaktuar realizimi i ndikimit të përforcuar mbi kryesit e mitur që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale, si dhe mbi të mitur tjerë të mos kryejnë vepra të tilla. Prej funksionit dhe



---

qëllimit të përcaktuar kështu del se sistemi i sanksioneve është ngritur lartë mbi idenë retributive. Edhe në raport me dënimin nuk është i theksuar parimi i drejtshmërisë, gjegjësisht kërkesa për pjesëtueshmëri të dënimit me rëndësinë e veprës penale dhe nga ana tjetër, si qëllim i tyre kryesor paraqitet përsëri edukimi, riedukimi dhe aftësimi profesional i të miturit (neni.88).<sup>32</sup>

Lloji i sanksionit nuk varet nga natyra e veprës ose prej ekzistimit dhe shkallës së përgjegjësisë penale, por prej nevojave të personit për edukim, ndihmë dhe kujdes. Sistemi i sanksioneve nuk e përjashton edhe dënimin d.m.th. vetëm vërtetim i theksimit të personalitetit të delikuentit të mitur si bazë për sanksion në hijen në të cilën mbetet vepra e kryer penale si shkak për shqiptimin e saj. Ka raste në të cilët të miturve më të vjetër duhet t'u shqiptohet dënim si sanksion i domosdoshëm dhe i dobishëm me të cilin do të ndikohet në zhvillimin e përgjegjësisë penale personale të tyre, me qëllim që në të ardhmen të mos kryejnë vepra penale dhe me të të paralajmërohen edhe të tjerët që të përmbahen nga kryerja e veprave të tilla.

Sanksionet për të miturit e kanë për rezultat personalitetin e të miturit dhe nevojën për edukimin e tij, ndihmën dhe mbikëqyrjen që si parim themelor të së drejtës penale për të mitur e apostrofon parimin e individualitetit. Këtu ajo ka rëndësi më të madhe në krahasim me matjen gjyqësore të dënimit për kryerës të rritur, ku largësia e tij është e kufizuar në pëlqimin dhe në rrethanat personale të kryesit, por së bashku me të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Gjatë zgjedhjes së masave edukuese rrethanat tjera janë lënë në plan të dytë, kurse rëndësi qenësore ka diagnostifikimi i nevojave të personit dhe problemet në zhvillimin e tij si dhe kuptohet prognozën për veprimin e sanksioneve në drejtim të edukimit dhe zhvillimit të drejtë të të miturit.

Sipas kësaj, njohja e personalitetit të të miturit është supozim i domosdoshëm për shqiptim të masës përkatëse, sepse pa të e njëjta mbetet pa përmbajtje konkrete. Procesi i ndërlikuar i zgjedhjes dhe pastaj edhe i ndjekjes së zbatimit të masës e imponon nevojën që procedurën penale kundër të miturit ta udhëheq gjyqtar i specializuar për të mitur.

Vendimet e veta ai i mbështet në mendimin e ekspertëve të ekipit të tij (pedagog, psikolog, psikiatër, punëtor social), gjegjësisht shërbimet e specializuara për edukimin, kujdesin

---

<sup>32</sup> Vlado Kambovski „Organiziran kriminalitet“, Shtip, Gusht 2005

---

dhe ndihmën e të miturve, si qendrat për punë sociale. Kërkesa për specializim ka të bëjë edhe me organet tjera që janë pjesëmarrës në procedurë (prokurori publik dhe policia). Sistemi monist i sanksioneve i cili përfshin masa edukuese, masa alternative dhe dënime nënkupton autorizime të gjërave gjyqësore jo vetëm në zgjedhjen e sanksioneve që më së shumti i përgjigjen personalitetit të të miturit dhe nevojës së edukimit të tij, kujdesit dhe ndihmës, por edhe ndjekjes së realizimit të saj dhe sjelljen e vendimeve plotësuese për ndryshim të trajtimit. Kështu gjyqi pas sjelljes së vendimit me të cilin është shqiptuar masa e mbikëqyrjes së intensifikuar ose masë e entit për ndërprerje të kryerjes ose zëvendësim me masë tjetër (neni.84). Poashtu gjyqi ka autorizime për vendosje të përsëritur për nevojën e ekzekutimit të masës edukuese, nëse pas një viti pas hyrjes në fuqi të vendimit me të cilin është shqiptuar nuk ka filluar realizimi i saj (neni.85).

## **7. Konventat ndërkombëtare mbi të drejtat e të miturve**

Ligji për të drejtat e të miturve, të cilën Republika e Maqedoninë e solli në vitin 2007 dhe hyri në fuqi në vitin 2009, është në pajtim dhe përputhëshmeri me standardet e përcaktuara dhe të ratifikuara në konventat ndërkombëtare dhe dokumentet për të drejtat e fëmijëve, si:

- ⇒ Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të drejtat e fëmijës me protokollin për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura dhe protokollit për trafikimin e fëmijëve, pornografinë e fëmijëve dhe prostitucionit të fëmijëve,
- ⇒ Rregullat (direktivat) e Rijaadit të Kombeve të Bashkuara për parandalimin e delikuençës së të miturve në vitin 1990, si dhe
- ⇒ Rekomandimi i Këshillit të Evropës nr.P (87) 20 mbi reagimet sociale ndaj delikuençës së të miturve.

E drejta për të mitur është një term që rrjedh nga drejtësia, për të drejtat e të miturve si një ndër kushtet nga të drejtat themelore të fëmijës në Konventën për të drejtat e fëmijëve<sup>33</sup>, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 20 nëntor 1989, e cila hyri në fuqi më 2 shtator të vitit 1990. Në këtë konventë, janë të parashtruara parimet më të përgjithshme për realizimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve për mosdiskriminimin e fëmijëve, respektin për interesin më të mirë të fëmijës dhe pjesëmarrjen e fëmijëve në të gjitha vendimet që ka të bëjë me të. Këto parime udhëzuese quhen trekëndësh të të drejtave të fëmijëve, prej të cilave

---

<sup>33</sup> Titulli origjinal: Konventa mbi të drejtat e fëmijës.

---

rrjedh edhe lista e të drejtave të individit që nga ana tjetër mund të grupohen në pesë grupe si më poshtë:

- a) të drejtat ekonomike, që do të thotë një standard të përshtatshëm të jetesës, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore,
- b) të drejtat sociale dhe kulturore, të cilat përfshijnë kujdesin dhe edukimin e duhur,
- c) të drejtat politike dhe civile janë marrë parasysh dhe të drejtat për lirinë e shprehjes dhe mosdiskriminimit,
- d) E drejta e drejtësisë për të miturit - Drejtësia për të mitur apo të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin dhe atëherë kur kundër tyre zhvillohet një procedurë penale, si dhe ndalimin e llojeve të caktuara të vendosjes së sanksioneve ndaj tyre, si dhe
- e) Të drejtat e humanitare që përmbajnë të drejtat e fëmijëve në rajonet e përfshira nga konfliktet ushtarake.

Kjo konventë, është e miratuar nga shumica e vendeve të botës, më shumë se çdo konvente ndërkombëtare. Krahas kësajë, në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e të drejtave për të mitur, u sollën më shumë rregulla ndërkombëtare si dhe rregulloret në lidhje me të drejtat e të miturve, të tilla si rregullat e Havanës<sup>34</sup>, Rregullat e Pekinit<sup>35</sup>, Rregullat (direktivat, udhëzimet) e Rijadit<sup>36</sup>, si dhe rregullore të tjerët, që sjellin (sigurojnë) një standard minimal ndërkombëtare për mbrojtjen e të miturve të privuar nga liria (rregullat e Havanës), për administrimin e të drejtave të të miturve (rregullat e Pekinit), si dhe parandalimin e delikuencës së të miturve (rregullat apo udhëzimet e Rijadit).

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut e viti 1950, gjithashtu rregullon çështjet e privimit të paligjshëm të lirisë së të miturve (neni 5, paragrafi 1, pika 10), si dhe çështjet e dënimit të të miturve (neni 6, paragrafi 1). Ndër të tjera, kjo konventë parashikon se:

- ☆ Çdo person ka të drejtën e lirisë dhe sigurisë së personit,
- ☆ Askush nuk mund të privohet nga liria, përveç në rastet dhe në procedurën sipas ligjit,

---

<sup>34</sup> United Nation Rules for the Protection of Juveniles Deprived of their Liberty (Havana Rules)

<sup>35</sup> United Nation Standard Minimum Rules for the juvenile justice (The Bering Rules)

<sup>36</sup> UN Guidelines for the Prevention of Juvenile Delinquency (Riyadh Guidelines)

---

☆ Ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm para një gjykate të pavarur dhe e paanshme, e cila është themeluar në pajtim me ligjin,

☆ Çdo njeri ka të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare të të miturit.

Instrumente të tjera ndërkombëtare që rregullojnë delikuencën e të miturve janë:

- Konventa Evropiane për të drejtat e fëmijëve e vitit 1996,
- Rekomandimet e Këshillit të Evropës, përkatësisht:
  - a. Rekomandimi i Këshillit të Evropës mbi reagimet sociale për delikuencën e të miturve, 1987,
  - b. Rregullat evropiane për sanksionet dhe masat sociale, 1992,
  - c. Rekomandimi i Këshillit të Evropës mbi reagimet sociale që kanë këtë të drejtë e të rinjve në raport me ata persona që vijnë nga një familje emigrantësh, 1988;
  - d. Rekomandimi i Këshillit të Evropës mbi reagimet shoqërore që kanë të bëjnë me të drejtat e të miturve në drejtim të atyre që vijnë nga një familje emigrantësh, 1988,
  - e. Rekomandimi i Këshillit të Evropian, për zgjidhje në procedurë penale, 1999.
- Në Raportin e nëntë të përgjithshëm të Komitetit Evropian për parandalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor ose trajtimit degradues, 1999, i cili gjithashtu përmban standardet dhe mjetet për trajtimin human të të miturve të privuar nga liria, në të cilën, ndër të tjera thuhet si në vijim: dhoma të veçanta për të mitur, standardet minimale për ambientet në të cilat burgosen të miturit, regjimi i aktiviteteve në burg, kontakteve me botën e jashtme, masat disiplinore, trajtim mjekësor, procesin e ankesave dhe inspektimi, etj

I një rëndësi të veçantë për parandalimin e delikuencës së të miturve, është dhe rekomandimi i miratuar nga Këshilli i Evropës në vitin 2000, për rolin e ndërhyrjes së hershme psikosociale në parandalimin e krimit të të miturve. Në rekomandim, ndërhyrja e hershme psikosociale përkufizohet si "Çdo veprim ose aktivitet që synon ndarjen e fëmijëve në rrezik, si dhe zvogëlimin e mundësisë për të vepruar në sjelljen kriminale të përhershme të ardhmen ..."

Programet e ndërhyrjes së hershme psikosociale duhet të përfshijnë masa për të përcaktuar faktorët e rrezikut dhe masat që promovojnë faktorët mbrojtës. Masat në të cilat janë të përcaktuar faktorët e rrezikut, duhet të i kushtoj vëmendje si më poshtë:

- Vështirësi në mësim,
- Keqëtrajtimi, neglizhenca nga ana e prindërve, duke i vendosur fëmijët në institucione sociale,

- 
- ✧ Mungesa në shkollë, përjashtimit, sjellje të dobët,
  - ✧ Diskriminimi racial, papunësia e prindërve, varfëria,
  - ✧ Bashkimi me grupe të ngjashme të devijuara.

Masat që duhet të promovojnë faktorët mbrojtës, duhet që t'i kushtohet vëmendje të veçantë, si më poshtë:

- ✧ Përvetësimi i aftësive sociale dhe aftësitë për zgjidhjen e problemeve,
- ✧ Kohezioni familjar, duke krijuar rregulla joautoritative të arsimit dhe dënimit,
- ✧ Krijimi i një mjedisi të sigurt,
- ✧ Pjesëmarrja në jetën shoqërore në komunitet.

Dokumentet ndërkombëtare që merren me përcaktimin e rekomandimeve për mbrojtjen e fëmijëve dhe të miturve, tregojnë se për të rinjtë e mitur, veçanërisht është e rëndësishme që veprimet të zhvillohet në mjediset natyrore të të miturve, ku ata ndihet të sigurt dhe të mbrojtur.

Prandaj, sipas këtyre dokumenteve ndërkombëtare, rekomandohet mbi metodat e trajtimit jashtë-institucionale, metodat interaktive dhe të pjesëmarrjes. Kjo është e nevojshme, për shkak se reagimet dhe veprimet, duhet të ndjekin pjekurinë e të miturit, të cilat jo gjithmonë përkojnë me moshën e tyre dhe aftësinë për të kuptuar se çfarë është bërë dhe ate se çfarë duhet të merret si përgjigje me ose pa ndërhyrje të veçantë.

---

## **KAPITULLI I DYTË**

### **FAKTORËT E KRIMINALITETIT TË TË MITURVE**

Në lidhje me faktorët për delikuencën e të miturve egzistojnë teori të ndryshme dhe paragjykime të ndryshme, madje edhe në mesin e profesionistëve të cilët janë të përfshirë drejtëpërdrejtë dhe merren me hulumtime në lidhje me këtë problem. Baza etiologjike dhe faktorët shtytës të krimit në përgjithësi, në terma më të përgjithshme, zbatohen për delikuencën e të miturve. Megjithatë, parashihet dhe mendohet që tek sjelljet devijante të të miturve, egzistojnë disa specifika të faktorëve, kushteve dhe shkaqet që shkaktojnë ato.

Strukturat bio-psikologjike dhe tiparet sociale të të miturve ndryshojnë shumë nga të rriturit. Kriminologu i njohur M. L. Rey thotë se në mesin e punonjësve socialë egziston mendimi më i përhapur se tek shkelësit e mitur bëhet fjalë për mospërshtatshmërinë (mosrregullim) mes tyre, si ata me të meta fizike, të meta mendore poshtë normales, të prapambeturve dhe të lënë pas dore, të mosrregulluarit, njerëzit e paekuilibruar dhe personave të çoroditur, personat që janë në prag të mbijetesës, jetimët, të miturit të cilët nuk mund të kontrollohen etj.

Ai e kritikon teorinë që flet se të miturit janë konsideruar "për paaftësin e tyre për të dalluar të mirën nga e keqja, për shkak të mungesës së pjekurisë". Përveç kësaj, ai në mënyrë të veçantë shqyrton teorinë e mospërshtatshmërinë (njeri që nuk përshtatet) se delikuentëve të mitur. Sipas mendimit të tij, këto rezultate shpjegojnë kriminalitetin e delikuentëve të miturve, përmes nevojave të tyre të paplotësuar, apo përmes disa faktorë të brendshëm, dhe kështu lënë pas dore vullnetin dhe ndërgjegjësimin e të miturve dhe zëvendësimin me gjendjen e tyre emocionale.

Ai gjithashtu beson se fëmijët e adaptuar por edhe ato jo të adaptuar, duhet të jetë nën mbrojtjen sociale, pasi adaptimi mund të thotë kufizimi i lirisë së të miturit dhe është i bazuar në konformizimin dhe totalitarizmin. Faktorët për delikuencën e të miturve janë të shumta. Ata janë të ndikuar kryesisht nga zhvillimi i karakterit psikologjik të personalitetit të të rinjve dhe të faktorëve social - mungesa e shkollimit, apo neglizhimi arsimor.

Delikuentët e rinjë ndryshojnë nga ato të rriturit dhe për nga shkalla e zhvillimit biologjik dhe pjekurisë emocionale. Veprimtaria e tyre kriminale nuk është si në rastin e të rriturve, pasojë e vullnetit të fortë dhe arsye për të menduar dhe për të reflektuar, por faji dhe arsyeja janë të njohura në një formë të veçantë.

---

## 1. Faktorët biologjik dhe psikologjik të kriminalitetit të të miturve

Faktori kryesor i hetimit të problemeve etiologjike dhe fenomenologjike të kriminalitetit dhe devijimit është mjedisi social, marrëdhëniet detyrimore (delikti) dhe personaliteti. Duke vëzhguar nga aspekti i dy faktorëve të parë, delikuencën e të miturve nuk ka specifika të veçanta, për të cilat është e nevojshme një studim në mënyrë specifike. Megjithatë, faktori i personalitetit sipas shumë elementeve konsiderohet si trajtim karakteristik dhe i veçantë. Ky faktor shpjegohet sipas specifikave të ndryshimeve fizike dhe psikologjike të cilat janë karakteristike e adoleshencës, përkatësisht periudhës në mes fëmijërisë dhe moshës madhore. Personaliteti përcaktohet me elemente të përgjithshme të psihostrukturës jo adekuate që është duke u zhvilluar. Paqëndrueshmëria psikike, para shumë problemeve dhe vështirësive në përshtatjen e kushteve të caktuara të jetesës, gjenë zgjidhje në sjelljen që duket si një mënyrë më e lehtë për të arritur qëllimet e tyre, e cila ka tendencë për sjellje agresive (të trazuara), si njëra nga format e devijimit.

Gjatë periudhës së ashtuquajtur krizë adoleshente, personi është në kërkim të identitetit të vet. Adoleshentët kur janë në një fazë të veçantë të zhvillimit, kanë nevojë për: autoritet, besueshmëri, mbështetje dhe ndihmë, të cilat për shkak të kushteve specifike shpesh mungojnë, kështu që fëmijët u kthehen rrugëve në vend të prindërve të tyre.

Plogështia dhe apatia<sup>37</sup> (indiferenca) janë paraqitje të cilët më shpesh janë të shprehura dhe të theksuara tek gjeneratat e reja. Pritjet e të tjerëve nga ata janë shumë të mëdha dhe pikërisht për këtë ato gjenden përballë ndryshimeve shoqërore, por nga ana tjetër, vendimet për jetën e tyre sillen diku tjetër, përtej aftësisë për të ndikuar te ato. Prandaj, sjellja devijante dhe delikuede tek shumica, në fillim lind si një formë proteste kundër modeleve shoqërore të imponuara, pastaj në fazat e vona ato kalojnë në shprehi.

Në literaturën psikologjike janë dhënë mendime se adoleshenca paraqet një periudhë rinore e cila fillon nga mosha 12-13 vjeç, dhe përfundon me pjekuri, rreth moshës 24-25 vjet. Në atë periudhë personi vazhdimisht është në ndryshim konstant dhe nën ndikimin e faktorëve të mjedisit, të cilin të riun e bëjnë më ndryshe nga të rriturit, së bashku me dukuritë të cilët për personin e rritur mund të konsiderohen si patologjike, ndërsa tek shumica në këtë moshë ato janë konsideruar normale. Në fazën e pubertetit, deri në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare, tek

---

<sup>37</sup> Apati (:απάθει - απαθεια) - indiferenca, gjendja mendore e karakterizuar nga indiferenca.

---

personi paraqiten fenomene të rëndësishme organike dhe morfologjike që forcon ndërtimin fizik dhe gradualisht lihen zakonet dhe karakteri fëmijëror dhe karakteri gradualisht stabilizohet. Në kuptimin psikologjik, konsiderohet se personi maturohet rreth moshës 18 vjeçare, ndërsa në varësi të faktorëve bio-psikologjike dhe sociale, procesi i maturimit në mënyrë individuale mund të ndodhë shumë më herët, por edhe shumë më vonë.

Kufijtë mes rinisë normale dhe të devijuar është shumë e vështirë që të përcaktohen, për shkak se këto cilësi zhvillohen në cikle të ndryshme, kështu që të gjitha mundësitë e parashtruara të kësaj gjendje janë gjithmonë relative. Në fazën rinore personi socializohet në procese dinamike si dhe në faza të ndryshme biologjike të zhvillimit, të cilat lënë një mbresë të thellë në sjelljen e tij shoqërore. Gjatë kësaj periudhe shfaqen ndryshime fizike dhe seksuale të cilët tek të rinjtë mund të paraqiten me fenomene të tilla siç janë komplekset por edhe ndryshimet emocionale të cilat janë kusht për maturimin e mëtejshëm. Këto ndryshime manifestohen përmes formave të ndryshme të disponimit, personi piqet intelektualisht, miraton disa nga parimet e tij të sjelljes dhe vlerave të cilët nuk duhen që patjetër të përshtaten në kornizat e zakonshme të sjelljes.

Ndryshimet në sjellje pasqyrohen në keqkuptimet apo dallime në familje dhe në mjedisin social në të cilin i riu gjen arsye të një lloji sjellje anti-shoqërore, por të cilat mund të jenë një model për qëndrueshmëri identifikimi negativ. Së bashku me këtë, paraqiten edhe disa karakteristika të brendshme psikologjike të cilat janë më ndryshe se zakonisht: pengimi, agresiviteti, apo ekstremitete të tjera, si: tërheqja, depresioni dhe izolimi. Në botën sociale, të gjitha këto manifestime shkrihen në formën e konfliktit midis brezave, gjegjësisht me një përplasje të vlerave.

Në hulumtime të ndryshme, psikiatrët janë marrë me çështjet e shqetësimit dhe ndikimin e sjelljes delikuate si dhe formimin e një tipologjie për të miturit. Disa prej tyre (D.Gibons 1963 dhe K.R.H Vardrop 1957) pohojnë se 35% e numrit të përgjithshëm të delikuate të gjinisë mashkullore kanë çrregullime mendore, ndërsa në rastin tjetër (Epps 1951, dhe Vardrop 1957) kanë vërtetuar se çrregullimet mendore në mesin e femrave janë shumë më të zakonshme se sa te djemtë. K.R.H Vardrop, drejtor i klinikës për psikiatri ligjore në Glasgov, duke përmbledhur përvijat e tyre dhe bazën teorike të hulumtimeve të mëparshme, i ka



---

klasifikuar faktorët etiologjik më karakteristike klinike në delikuencën e të miturve. Në klasifikimin e tijë Vardrop i numëron: çrregullime me vonesë organike, delikuentë të diprimuar, delikuentë emocionalisht të paqëndrueshme, delikuentë me probleme në familje dhe delikentë të situatave.

## **2. Faktorët social të kriminalitetit të të miturve**

Përveç faktorëve të tjerë që kanë ndikim në delikuencën e të miturve, një ndër faktorët kyç që ka ndikim dhe që përbënë një komponentë të rëndësishëm në etiologjinë e delikuencës së të miturve është edhe faktorët social. Nga kjo pikë, interesante është harta sociale e delikuentëve të mitur. Studime të ndryshme tregojnë që, të rinjtë që kanë probleme me sjelljet devijante dhe që janë në konflikt me ligjin, kryesisht janë të gjinisë mashkullore, përkundër asajë të gjinisë femrore që dominojnë në rapor 90%–10%. Ato kryesisht rrjedhin nga familje jo funksionale dhe me probleme, ato kanë shumë pak kontakt me babanë e tyre, kanë probleme me të mësuarit dhe sjelljen në shkollë, duke marrë drogë dhe këto janë të prirur për sjellje agresive.

Në shoqërinë tonë, në rrethanat e tanishme të rinjtë ende nuk janë në gjendje që ti plotësojnë dhe ti përmbushin nevojat egzistenciale të tyre për jetesë, nuk mund të gjejnë identitetin dhe orientimin e tyre me vlerë dhe për këtë arsye ato bëhen të tjetërsuar, pasiv dhe të paaftë për një ndryshim revolucionar në marrëdhëniet e tyre aktuale shoqërore. Shoqëria që ëhstë e organizuar keq, nuk ka mundësinë që të rinjëve tua ofrojë dhe t'u mundësojë atyre realizimin e qëllimeve të tyre me anë të mjeteve juridike për shkak të pozitës së tyre marginale në shoqëri.<sup>38</sup>

Në analizën profesionale strukturore, statistikat tregojnë se numri më i lartë i delikuentëve të mitur, kryesisht vijnë nga radhët e nxënësve të shkollave të mesme dhe fillore. Sipas këtyre statistikave, rreth 25% e të miturve, gjatë kryerjes së krimeve nuk ishin të punësuar dhe nuk ishin ndjekës të shkollës. Një ndër tiparët e rëndësishëm të delikuencës së të miturve është bashkëpunimi, që nënkupton se të miturit në më shumë se 20% të rasteve gjatë kohës së kryerjes së krimit, nuk kanë vepruar të vetëm por atë e kanë kryer edhe me pjesëmarrjen e të tjerëve në bashkëpunim.

---

<sup>38</sup> Stevan Aleksoski, Kriminologjia, Shtip, 2009

---

Në literaturën kriminale, në mes të faktorëve individualë duke përfshirë edhe faktorë të veçantë të cilët kanë ndikim në delikuencën e të miturve, në mesin e tyre mund të numrohen edhe ndikimi i familjes, ndikimi i shkollës, koha e lirë, mjetet e komunikimit masiv dhe personaliteti i të miturve<sup>39</sup>.

Sigurisht, këta faktorë nuk veprojnë më vete, por të ndërlidhura dhe në një marrëdhënie mes tyre të kushtëzuar nga një faktor i personalitetit.

### **3. Familja si faktorë i kriminalitetit të të miturve**

Mjedisi familjar është një ndër faktorët e drejtëpërdrejtë në elementet e lidhjes strukturore të zhvillimit të delikuencës së të miturve. Mjedisi familjar është një element kryesor i socializimit të të miturve, në të cilin atmosfera emocionale në mënyrë të drejtëpërdrejtë ndikon në zhvillimin intelektual dhe psikologjik të fëmijës. Problemet e ndryshme dhe krizat e formave të ndryshme në marrëdhëniet familjare dhe mosmarrveshjeve martesore në mes prindërve mund të ndikojnë në zhvillimin emocional të fëmijëve në lloje të ndryshme të çrregullimeve të tyre. Një përqindje e lartë e paraqitjes së delikuencës së të miturve në mesin e fëmijëve që rriten në shtëpi për jetimët, kryesisht i referohet mungesës së edukimit prindëror apo familjar.

Procesi arsimor në zhvillimin e të rinjve në mënyrë të drejtëpërdrejtë reflektonë në prishjen strukturore të familjes, të tilla si divorci i prindërve, humbja apo braktisja e njërit apo të dy prindërve, neglizhim, moskujdesi apo sjellje sociale-patologjike në mesin e disa nga anëtarët e familjes së ngushtë. Në këtë kuptim prishja e marrëdhënieve familjare apo funksionet e familjes, kanë ndikim negativ në zhvillimin dhe edukimin e të miturve.

Hulumtimet në vendin tonë tregojnë se delikuentca e të miturve në masën rreth 30% të rasteve, origjinën e tyre e kanë nga familje me prindër të divorcuar. Tek familja si faktor i kriminalitetit të të miturve, një ndikim shumë të rëndësishëm në këtë drejtim përfshijnë dhe gjendja materiale në familje, punësimi i anëtarëve të familjes, sjelljet apo marrëdhëniet dhe kujdes prindëror, strehimit si dhe kushtet e banimit dhe të ngjajëshme.

Përveç kësaj, studimet dhe hulumtime të ndryshme kanë treguar se delikuenca e të mitur në masë të konsiderueshme kanë origjinë dhe vijnë nga familje të varfra dhe përdorues të alkoolit. Sipas disa të dhënave, tek delikuentët e mitur të gjinisë mashkullore ky faktor është i pranishëm në gati gjysmën e rasteve, gjithashtu edhe tek delikuentët e gjinisë femrore kjo prani

---

<sup>39</sup> Zh.Jashovikj, "Kriminologjia e delikuencës së të miturve", Beograd, 1991

---

është bukur e madhe edhe ate në një të tretën e rasteve – persona nga të cilat njëri nga prindërit është një përdorues i rregullt i alkoolit<sup>40</sup>.

Familja si faktor është e ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë nga industrializimi dhe urbanizimi. Në fakt, nga hulumtime të ndryshme është konsideruar se stabiliteti në familje dhe marrëdhëniet familjare në kuptimë të plotë, në mënyrë të konsiderueshme ato janë më të forta apo të qëndrueshme në zonat rurale në krahasim me zonat urbane, ku familja është disi e tjetërsuar dhe e pavarur si kategori sociale.

Mosadaptimi i marrëdhëniet familjare me kushtet e reja, reflektohet në sjelljen e fëmijëve dhe shfaqjen e delikuencës tek të mitur. Nga kjo pakujdesi, në vend të prindërve, edukatorëve të fëmijëve, të miturit marrin shembuj nga jashtë në mesin e shokëve të tyre në rrugë.

Migrimi nga zonat rurale në ato urbane shkakton stres dhe konfliktit tek të miturit, një përplasje të formës tradicionale me atë të rene, vështirësitë e banimit dhe problemet të ngjajshme, shpesh çojnë në lloje të caktuara të sjelljes devijante apo delikuede.

Nga ana tjetër, kur prindërit janë të suksesshëm, ato përcjellin idetë e tyre për të mirë ose për të keq, nga të cilat fëmijët i konceptojnë këto vlera dhe i ndjejnë si të tijë. Kushtet e nevojshme për imponim dhe ndikim të tillë të vlerave është ekspozimi ndaj një grup të veçantë të vlerave, në kontekstin e një marrëdhënie të dashur marrëdhënia prind-fëmijë. Nëse mbajtja e dashurisë prindërore është diçka shumë e rëndësishme për fëmijën, ajo do të bëjë çdo gjë dhe beson në çdo gjë të shmangur refuzimin nga prindërit<sup>41</sup>.

### **3.1. Arsimi në familje**

Një shembull shumë i rëndësishëm i delikuencës së të miturve përfaqësojnë procese joadekuate të socializimit të tyre, veçanërisht në procesin e edukimit apo neglizhencës arsimore.

Arsimi është një shkak shumë i rëndësishëm i orientimit në sjelljen e njeriut veçanërisht tek të miturit dhe është një ndër shkaqet e mundshme të delikuencës së të miturve. Kjo, në kuptimin pozitiv, nënkupton zhvillimin e duhur social dhe intelektual të fëmijëve dhe edukimin e të rinjve.

---

<sup>40</sup> M. M Glatt "Alkoolizmi, krimi dhe delikueda e të miturve", Zagreb, nr 4/1961

<sup>41</sup> Jakov Lazarovski "Altuzmi dhe sjellja agresive, Skopje, Melbourne, 1997

---

Arsimimi është një proces i transferimit të modeleve kulturore të individëve dhe grupeve, në zhvillimin dhe në procesin e socializimit të personalitetit. Edukimi zbatohet dhe kryhet në kushte të ndryshme të mjedisit shoqëror, kryesisht në familje, shkollë dhe në mesin e moshatareve të tyre. Gjatë procesit të edukimit, personaliteti i tejkalon prirjet dhe sjelljet egoiste, egocentrike, dhe tencencat devijuese.

Sjellja devijante e të miturve mund të jetë si rezultat i keqë edukimit. Edukimi i rreptë dhe dënimet ndaj të miturve sjellin deri te paaftësi dhe çrregullime të rënda, në një personalitet të pasigurt dhe në depresion, ndërsa te të miturit, në mungesë të arsimit, i bënë ato me sjellje agresive, dhe të zhveshur nga të kuptuarit e asaj se çka është e lejuar dhe çfarë nuk është. Marrëdhëniet familjare dhe edukimi jo i duhur, ndikojnë drejtpërdrejt në sjellje delikuede të të miturve.

Çdo formë e krizës dhe problemeve në marrëdhëniet familjare pasqyron zhvillimin emocional të fëmijëve në llojet e ndryshme të çrregullimeve dhe sjelljeve të kokëfortësisë. Përqindja e lartë e delikuentëve të mitur, të rritur në shtëpi, është rezultat i mungesës së edukimit të mirëfillt. Zhvillimi i duhur i personalitetit të një të mituri, është si rezultat i mungesës së arsimimit të mirëfillt, mungesës së programeve adekuate shkollore, si dhe ndikimi i mjedisit në të cilin të miturit gjenden dhe kryesisht lëvizin ato.

Hulumtimi kriminologjike sugjeron se anashkalimi i arsimit është një nga faktorët më të rëndësishëm për delikuencën e të miturve.

Ky faktor, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndodh si rezultat nga veprimi i shkaqeve familjare, shkollave dhe mjedi në të cilë jetojnë. Gjendja e lënies pas dore dhe neglizhencës arsimore në mesin e të miturve delikuent, trajtohen dhe zgjidhen me programe të risistemimit, risocializimit dhe rehabilitimit të tyre, ndërmarrjen e masave korrigjuese përmes proceseve penologjike, zbatimin e masave edukuese të vendosura në procedurën penale dhe të ngjajshme.

#### **4. Shkolla si faktor institucional i kriminalitetit të të miturve**

Përveç familjes, shkolla është një institucion në të cilin kryhen proceset më të rëndësishme arsimore dhe edukative, zhvillimin e personalitetit të të rinjve adoleshent si dhe trajtimi dhe përgatitja për punën e ardhëshme dhe funksioneve sociale. Nga organizimi dhe përmbajtja e programit edukativo-arsimor, në masë të madhe ka ndikim shumë të rëndë-

---

sishëm në zhvillimin e të rinjve dhe sjelljen e tyre sociale. Varësisht se sa përpiqet dhe investon komunitetit në këtë proces, ai është i natyrshëm, për shkak të vështirësive të mëdha të ngarkuar me dobësi të caktuara që reflektojnë negativisht në personalitetin e të miturve.(Kostova M, 2005).

Programet shkollore dhe funksioni i shkollave në kushte të përkohëshme, më shumë janë të orientuara në arsim, se sa në aspektet arsimoreve të të miturve. Në një sistem të tillë mungon ndërtimi i normave morale, qëndrimet pozitive dhe karakteri i personit, për shkak se programet e tyre nuk janë përshtatura për aftësitë fizike dhe psikologjike dhe nevojat e të rinjve, interesin e tyre dhe përmbushjen e dëshirave të tyre.

Përveç sajë, në sistemin arsimor, ka mungesë apo nuk kanë pajisjet e nevojshme, laboratorë dhe kabinet, oborre të shkollave dhe objekte të tjera për edukimin fizik që do të zënë vëmendjen dhe interesin e nxënësve, me qëllim të plotësimit të kohës së lirë me aktivitete krijuese dhe punëve krijuese të të rinjve. Rëndësi dhe kuptim të veçantë kanë edhe marrëdhëniet ndërpersonale që ndikojnë tek nxënësit të dobët që janë si pasojë e fenomeneve socio-patologjike, ndërprerjes së shkollimit, ndryshimi i shpeshtë i mjedisit shkollor, ikja nga shkolla, dhe lloje të tjera të mungesave të arsyeshme dhe të paarsyeshme nga klasa si dhe performanca e dobët e tyre.

Si pasojë e gjithë kësaj është se rreth 60% -70% e të miturve delikuent bëhen kriminelë gjatë periudhës së shkollimit të tyre.

## **5. Faktorët ekonomik (gjendja ekonomike) të kriminalitetit të të miturve**

Kriza afatgjate sociale dhe ekonomike në vend, kontribuon në varfërimin e shoqërisë, e cila reflekton dhe pasqyrohet në papunësi të madhe të qytetarëve duke mos u lejuar atyre që ata të përmbushin nevojat e tyre themelore.

Kushtet ekonomike të zhvillimit të shoqërisë, krizat e ndryshme ekonomike dhe probleme të tjera të ndëlidhura mes vete, gjendja materiale dhe ndryshimet në gjendjen ekonomike të kategorive të veçanta të popullsisë janë të një rëndësie të veçantë për studimin e shkaqeve të delikuencës së të miturve. Studime të shumta tregojnë se në kohën e krizës ekonomike dhe pasigurisë sociale mes qytetarëve, kriminaliteti është në rritje, a veçanërisht rrit disa nga format e tijë.

---

Kriza e ndryshme ekonomike karakterizohen nga probleme të theksuara dhe largime nga puna, zvoglime dhe shkurtime të punësimit, ulje të aftësisë paguese për çështje të ndryshme si dhe zvogëlim i standardit të qytetarëve në përgjithësi. Situatat e ndryshme ekonomike sidomos kur ajo gjendje është si pasojë e një gjendjeje lufte, ka një ndikim të theksuar edhe tek shtresat e ndryshme të qytetarëve, ku nga njëra anë grupet e ndryshme kriminale pasurohen në mënyrë enorme dhe nga ana tjetër egziston një varfërim dhe gjedje të rënduar ekonomike tek shumica dërmuese e qytetarëve. Gjithashtu, situatat jostabile brenda vendit por edhe rreth tijë, flukset e refugjatëve, migrimi, vështirësit në funksionimin e shtetit ligjor dhe të ngjajshme, paraqesin arsytet që çojnë në rritjen dhe paraqitjen e sjelljeve psikologjike, sjellja anti-shoqërore dhe rritje të kriminalitetit tek të rinjtë.

Gjendja e rënduar dhe krizat e ndryshme ekonomike shkakton dhe shpie në prishjen e harmonisë familjare dhe si pasojë në krizë familjare e në disa raste edhe deri tek shkatërrimi i familjes apo divorci, ajo shkakton depresion të theksuar tek antarët e familjes dhe si pasojë edhe tek alkoolizmi i tyre, tek të miturit gjendja ekonomike i shpie edhe në vjedhje të ndryshme dhe kështu me radhë. Në këtë raste në mënyrë të konsiderueshme egziston një rritje e theksuar e veprave penale dhe delikuencës së të miturve në përgjithësi. Kriminologu i njohur holandez William Bonger, konsideron se kushtet ekonomike, pasiguria dhe gjendja e rënduar ekonomike, janë kontribuesit dhe ndër shkaqet kryesore të kriminalitetit në përgjithësi dhe të miturit në veçanëti.

### **5.1. Varfëria**

Varfëria është një nga gjeneratorët kryesorë për sjellje delikuede tek të miturit, por në përgjithësi në familje, e sidomos kur bëhet fjalë për kryerjen e veprave penale ku si shkaktarë është pikërisht mungesa e pronës dhe kushteve të banimit. Kriminaliteti i cili në përgjithësi shkakton mjerim dhe varfëri, në literaturën kriminale ajo është e percaktuar si disavantazhë penal.

Varfëria si një ndër shkaqet që në mënyrë direkte apo indirekte shkakton delikuencë tek të miturit, është dhe vjenë si pasojë e mos arsimimit dhe mos edukimit të popullsisë, mos kualifikimit adekuat të tyre, papunësia dhe mungesa e të ardhurave, e cila ndikon negativisht në statusin e familjes, jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe atë shoqërorë dhe kulturore. Sipas disa autorëve, varfëria konsiderohet si një ndër faktorët më të rëndësishëm në paraqitjen e sjelljeve delikuede dhe kriminale tek të miturit.

---

Deri kohët e fundit termi "varfëria" i është referuar dhe është aplikuar për ato familje që me të ardhurat e tyre, nuk kanë mundur që të sigurojnë dhe të blejnë shportën minimale të mallrave dhe shërbimeve. Ndërsa sot, me termin varfëri i referohemi të gjithë atyre familjeve që me të ardhurat e tyre nuk janë në gjendje dhe që nuk kanë mundësitë themelore për një jetesë të mirë.

Është e njohur se varfëria manifestohet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë mungesën e të ardhurave dhe aseteve të mjaftueshme për të siguruar dhe për të ruajtur egzistencën e tyre, ndër to:

- ◆ Uria dhe kequshqyerja, shëndeti i dobët;
- ◆ Qasja e kufizuar apo e pamjaftueshme për arsim dhe shërbime të tjera;
- ◆ Rritja e vdekshmërisë, duke përfshirë vdekshmërinë nga sëmundja;
- ◆ Të pastrehët dhe kushtet joadekuate dhe të papërshtatëshme të strehimit dhe banimit;
- ◆ Mjedisi i pasigurt, diskriminim shoqërorë dhe izolimi.

Mos participimi në vendimë marrje dhe në shoqërinë civile, në jetën shoqërore dhe aktivitetet kulturore në mjedisin ku ato jetojnë, janë karakteristika shumë të rëndësishme në cënimin dhe mohimin e të drejtave të tyre.

Varfëria si një fenomen multi-dimensional, jep mundësinë dhe lejon për të menduar, që në një gjendje të karakterizuar, të mundësohet përshtatja e përhershme ose afatëgjate e burimeve, aftësive, mundësive për zgjedhje, sigurisë dhe energjive, të cilët janë të nevojshme për arritjen e një standardi adekuat të jetesës dhe arritjen e standardeve të tjerëve si atyre shoqërore, ekonomike, politike, kulturore dhe sociale.

## **6. Migrimi dhe urbanizmi si faktorë i kriminalitetit të të miturve**

Faktorët e urbanizimit dhe migrimit nga zonat rurale në ato urbane, si shkakëtarë të kriminalitetit të delikuentëve të të miturve, paraqesin dhe tregojnë një konflikt të drejtëpërdrejt të vlerave. Ky konflikt kthehet në shumë dimensione, si një konflikt midis: modernes dhe tradicionales, rurales (fshat) dhe urbanës (qytet), konflikt mes brezave dhe gjeneratave, marrëdhënieve formale dhe jo formale, konflikt të vlerave, që rrjedhin nga edukimi familjar dhe vlerave që u janë ofruar nga mjedisin i ri shoqëror, dhe të ngjajëshme.

---

Disa autorë që studiojnë këtë faktor, konsiderojnë se kriminaliteti i të miturve është kryesisht një fenomen urban, për të provuar këtë tezë ato kanë bërë krahasime të hulumtimeve të ndryshme në zonat urbane dhe në mjedise të tjera në shoqëri.<sup>42</sup>

Sa i përket karakteristikave regjionale të kriminelitetit shumë studiues janë të mendimit se disa forma të kriminalitetit më shumë janë të shprehur në disa regjione. Krimet e prostitucionit, krimet e dhunës, të narkomanisë, janë më të paraqitura në regjione urbane, regjione industriale, në metropole, në qendra të mëdha ku është e koncentruar më shumë shoqëria, ndërsa krimet kundër jetës dhe trupit në disa regjione tjera, në regjionet rurale, regjione kufitare sidomos pranë porteve detare, vijave kufitare, janë të pranishme dukurit e tregtisë dhe kontrabandës me artikuj të ndaluar, ose tregtia me valutë të huaj.

Krimet e dhunës sipas kërkimeve kriminologjike të bëra në disa vende, janë regjistruar më tepër në qytete dhe qendra të mëdha urbane dhe industriale. Në këtë drejtim, shpeshherë në literaturën kriminologjike përdoret termi “Zona kriminale” përmes të cilit dëshirohet të theksohen disa regjione ku kriminaliteti është më tepër i pranishëm së sa në regjione të tjera.

## **7. Koha e lirë e të miturve si faktorë i kriminalitetit të të miturve**

Një faktor i rëndësishëm që reflekton në zhvillimin, formimin edhe pjekurinë tek të rinjtë, është e ashtuquajtura koha e lirë. Përveç familjes dhe shkollës, pjesa tjetër e kohës është e lirë, e cila ka një ndikim të rëndësishëm në përcaktimin e qëndrimeve dhe sjelljeve, në forma të ndryshme të sjelljeve devijante dhe sjellje delikvente. Kur e gjithë kjo do të ndërlidhet me atë që të rinjtë kanë relativisht një pavarësi dhe sjellje personale, një burim të të ardhurave dhe mjeteve materiale, me të cilat ata organizojnë dhe zhvillojnë një jetë të shfrenuar ku alkooli dhe droga në mënyrë praktike është një punë normale, atëherë koha e lirë si faktor i delikuencisë dhe kriminaliteti të të miturve bëhet edhe më e qartë. Atje ku procesi i socializimit nuk ka arritur dhe nuk e ka pasur efektin dhe funksionin e sajë, ku procesi i socializimit nuk përputhet me rolin dhe funksionin e tij, koha e lirë mund të jetë një kohë boshe, një kohë ku të rinjtë kaplohen nga mërzia, në të cilën krijohet një moment dhe hapësirë e përshtatshme e pranimi dhe shfaqjes së efekteve të ndryshme negative dhe pranimi e sjelljeve antisociale.

Koha e lirë është një sfidë e vështirë për ta kaluar përmes argetimeve të ndryshme, dhe të pakuptimta, ajo gradualisht transformohet në forma më të rënda të kriminalitetit.

---

<sup>42</sup> A.Todoroviq "Madhësia e hapësirave urban dhe kriminaliteti i miturve", Nr 3/1975



---

Rrënimi i stistemit të vlerave, në disa pjesë është reflektuar në sjelljen e të rinjve në kohën e tyre të lirë, për këtë arsye, në jetën e përditshme për shumicën e të rinjve mungon përmbajtja e nevojshme kulturore. Të gjitha studimet dhe hulumtimet tregojnë se tek te rinjtë ka gjithnjë e më pak interes që të vizitojnë institucionet kulturore, në krahasim me prirjet për tu argëtuar me kolegët në klube të ndryshme dhe nëpër diskoteka. Ky qëndrim rrjedh nga fakti se standardi shoqëror i të rinjve si pjesë e standardit të përgjithshëm shoqëror, është shumë i ulët, për shkak sepse ndarja nga nevojat e tija kulturore është shumë e kufizuar ose thuhet se fare nuk egziston.

Në një situatë të rrethanave të pafavorshme, me qëllim parandalimin e monotonisë dhe mërzisë që shfaqet tek të rinjtë, arrinë deri tek themelimi dhe formimi i grupeve të përbashkëta kolektive me sjellje tejet devijante, të dëmshme dhe shkatërruese për to. Disa autorë mendojnë se delikuenca e të miturve gatise në 99% e rasteve ndodh dhe zhvillohet gjatë kohës së tyre të lirë, si rezultat dhe pasojë e faktorit të monotonisë dhe mërzisë. Përfundimet e tilla ndoshta janë ekzagjeruar, por fakti është se koha e lirë është një faktor i rëndësishëm që ndikon dhe reflekton në delikuencën e të miturve. Në lidhje me këtë egzistojnë argumente të shumta. Mbi të gjitha, delikuenca e të rinjve është një formë e lojës dhe argëtimit, ajo i shtynë të rinjtë në aventura në aspektin e pasivitetit fizikë dhe shpirtërore të sjellura dhe shkaktuara si rezultat i kohës së lirë. Ajo reflekton një kuptimin të një jetës së hedonistike<sup>43</sup>, të mbushur me elemente të veçanta të argëtimit, të tilla si bare dhe kafiteri, diskoteka, lojërave të fatit dhe të ngjajshme.

## **8. Roli i Mas mediave si faktorë i kriminalitetit të të miturve**

Mas-mediumet paraqesin një ndër shkaktarët që nxisin paraqitjen e delikuencës së të miturve. Ndikimi i mediave është dukshëm më i pranishëm në delikuencën e të miturve, për dallim nga delikuenca e të rriturve. Kjo është e kuptueshme, parasegjithash nga shkaku i strukturës psiko-fizike të të rinjve, të cilët në fazën e zhvillimit të tyre, ato fitojnë shprehje që në fëmijëri, nga ku mund të bëhet identifikimi i hershëm i sjelljeve të tyre pozitive dhe negative. Mediat (filmat, televizioni, interneti dhe kështu me radhë), u ofroni adoleshentëve një model të jetës kolektive dhe sjelljeve kolektive.

---

<sup>43</sup> Hedonizmi (Greqisht: Hedon) është një doktrinë etike e cila konsiderohet si vullnet suprem dhe qëllimin e veprimtarisë njerëzore.

---

Një faktor tjetër i rëndësishëm është sjellja dhe identifikimi, sidomos i ndikimit të tyre në lidhje me sjelljen e tyre duke marre si model atë çka shfaq media. Edukatori amerikan, neurologu E.Barnet pretendon se dhuna e shfaqur në televizion në një sasi të madhe, me kalimin e kohës, rrit prapë prapë dhunën tek fëmijët. Fëmijët në çdo moment mësojnë nga përvoja. Përvojat më mbresëlënëse të shfaqura nga mediat, ata i përfaqësojnë dhe interpretojnë nëpërmjet sjelljeve të tyre si një model në jetën reale. Shumë vrasje që janë bërë, janë një fakt shqetësues, sepse ato janë kryer nga fëmijët nën moshën 14 vjeçare.

Sipas disa kriminologëve, pavarësisht nga të gjitha këto argumente të marra në konsideratë, ndikimi i filmave në sjelljen delikuede të të miturve, nuk është ndonjë faktor i rëndësishëm nga ajo që shfaqet për publikun dhe në një pjesë të literaturës kriminale. Përkundrazi, ata thonë se filmi është një mjet me të cilin të miturit zbrazin ngjnjat e tyre emocionale dhe ngarkesat e thella psikologjike. Për më tepër, filmi ka një efekt shumë të dëmshme, atëherë kur mungojnë vlerat artistike, aty ku ka mesazhe dëshpërime dhe pavlefshmëri, jetë të pakuptimtë, absurditete të rendit dhe ligjshmërisë. Kështu i riu e sheh filmin më si një realitet dhe jo si një shfaqje të një përvoje, ato bëhen pjesë të jetës së tyre të përditshme me të cilat ata formojnë një sistem të marrëdhënieve kulturore të botës që i rrethon<sup>44</sup>.

Televizioni nuk është selektiv për atë se çka mësojnë të rinjtë. Përkundër aspekteve pozitive, ato mund të përcjellin edhe mesazhe të pabaza, të gabuara dhe negative, siç paraqiten më poshtë:

- Përmes televizionit, shpesh promovohen vlera të rrejshme dhe modele të gabuara që të rinjtë, sidomos adoleshentët dhe të miturit, i pranojnë në mënyrë jokritike ashtu siç ato paraqiten.
- Programet televizive shpesh transmetojnë edhe dhunë dhe armë. Të rinjtë, sidomos djemtë të cilët janë të ekspozuar ndaj këtyre programeve, mundohen dhe përpiqen të imitojnë veprimet agresive, ato bëhen më pak të ndjeshëm ndaj vuajtjeve të të tjerëve, dhe tek disa ndodh edhe "tensioni" (ankthi).

---

<sup>44</sup> J.Chazal, „ La cinema et la delinquance juvenile, Revue de science criminale et de droit penal Compare”, Paris,1949

- 
- ✎ Në programet televizive pothuajse çdo ditë shfaqen skena seksualiteti, në të cilët në një njëfare mënyre nuk ka gjithmonë përputhje me moshën e adoleshentëve dhe të miturve. Shpesh promovohen vlera morale të cilat janë të ndryshme nga bindjet tona personale. Seksualiteti përdoret si një mjet që ndihmon në shitjen e produkteve të ndryshme, për reklama të ndryshme.
  - ✎ Në mënyrë jokritike promovohet modeli i "shijimi i të mirave materiale", pa përmendur rrezikun e një sjellje të tillë. Për shkak të shikueshmërisë së gjerë, telenovelat dhe videot muzikore janë identifikuar si oferta më e keqe dhe e zakonshme për brezat e rinj.
  - ✎ Brezi i ri shpesh bëhet viktimë e stereotipeve të rreme: disa role në programet televizive paraqesin stereotipet në bazë të racës, gjinisë, moshës ose bukurisë fizike. Rinia dhe tërheqja fizike shpesh janë vënë në një pedestal, të cilët çojë në krijimin e paragjyimeve në mesin e adoleshentëve të cilët më pas formojnë vlerat e tyre.
  - ✎ Shikimi i Televizionit promovon një mënyrë jetese të sëmurë dhe jo të shëndetëshme, ajo çon në pasivitet dhe rritje të rrezikut të obezitetit.
  - ✎ Dhuna në televizion, rrit ndikimin agresiv tek të rinjtë dhe shikimi në mënyrë të rregullt të dhunës, ndikon që edhe vetë të bëhen të dhunshëm dhe ajo dhunë të jetë më e pranishme<sup>45</sup>.

Kur është fjala për mediumet, kryesisht paraqiten tre mesazhe dominuese rreth delikuencës së të miturve:

1. Delikuenca e të miturve është duke u rritur në mënyrë të qëndrueshme dhe nuk mund të kontrollohet,
2. Të miturit në konflikt me ligjin janë shumë të ngurtë dhe të keq për nga natyra,
3. Të miturit përfaqësojnë një kërcënim të madh dhe të vazhdueshëm për shoqërinë tonë.

Janë miratuar një numër i konsiderueshëm i dokumenteve dhe programeve televizive radiofonike, të cilat ndër të tjera rregullojnë parimet e mbrojtjes së fëmijëve nga raportimet e mediumeve, por mediumet tona shpesh i shkelin këto parime. Aspektet negative të mas-mediumeve në fenomenin e delikuencës së të miturve janë paraqitur në Tabelën 1.

---

<sup>45</sup> [www.povrzuvanje.blogspot](http://www.povrzuvanje.blogspot), hulumtime nga interneti mbi dhunën në shkolla

| <b>Tabela. 1: -<br/>Disavantazhet e mas-medias në fenomenin e delikuencës së të miturve</b>                                                                               |                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| ➡ Mediumet në raportimin e tyre për të miturve në konflikt me ligjin, kryesisht fokusohen mbi vetë incidentin.                                                            | ➡ Në shumicën e rasteve mediumet nuk veprojnë në interesin më të mirë të të miturit.                                                                                                                                                                                          |
| ➡ Në një pjesë të shquar të teksteve, mediumet në të a.q. raportim të tyre, të cilat pa nevojë dramatizojnë elemente të caktuara që inkurajojnë dhe nxisin panikun moral. | ➡ Mediumet janë të prirur për lajme të thjeshta she senzacionale. Sidomos në titujt e teksteve theksohen anën negative, informacioni nxirret nga konteksti në mënyrë të përgjithme. Të gjitha problemet e delikuencës së të miturve nuk është e nevojshme që të dramatizohen. |
| ➡ Mediumet pothuajse kurrë nuk merren me çështje që lidhen me politikat publike dhe ligjet përkatëse.                                                                     | ➡ Mediumet nuk përshruajn realitetin ashtu siç ka ndodhur me të miturve në konflikt me ligjin, paraqiten tejet negativ dhe jashtë kontekstit.                                                                                                                                 |
| ➡ Mediumet nuk bëjnë përpjekje për të gjetur zgjidhje për problemet, duke mos ndjekur procesin, ato kryesisht raportojnë incidente dhe raste të izoluara.                 | ➡ Të miturit janë paraqitur si vrasës, "ndezës shtëpishë", vjedhës, që dmth si një kërcënim serioz për shoqërinë që në një farë mënyre ne duhet të luftojmë me ta.                                                                                                            |
| ➡ Mediumet kryesisht informojnë në kontekstin e gjerë të cilat ndikojnë në ngjarje të veçanta.                                                                            | ➡ Kur bëhet fjalë për problemet që kanë të bëjnë me të miturit që është në konflikt me ligjin, mediumet e raportojnë lajmin në raporte të shkurtëra apo në kronikën e zezë.                                                                                                   |

Mediumet në përgjithësi nuk flasin në konteks më të gjerë, dhe në përgjithësi nuk i zbatojnë kriteret e përcaktuara nga institucionet përkatëse shtetërore.

## KAPITULLI I TRETË

### KRIMINALITETI I TË MITURVE DHE MASAT PËR PARANDALIMIN E TIJ ME VËSHTRIM TË VEÇANTË NË RRETHIN E GJYKATËS THEMELORE NË GOSTIVAR NË PERIUDHËN 2009 - 2014

#### 1. Situata e kriminalitetit të të miturve në rrethin e Gostivarit

Studimi mbi kriminalitetin tek të miturit në Republikën e Maqedonisë është një temë shumë pakë e trajtuar dhe studjuar dhe kjo temë është një ndër përpjekjet e para, e cila synon të realizojë një analizë të situatës aktuale lidhur me këtë fenomen veçanërisht në rrethin e gjykatës themelore në Gostivarë e cila është edhe temë studimi. Vitet e fundit, përfshirja e fëmijëve dhe të rinjve në aktivitete kriminale është kthyer në një shqetësim për Republikën e Maqedonisë dhe në veçanti për rajonin e Gostivarit e posaçërisht gjatë viteve të fundit, ku të rinjtë gjithnjë e më tepër janë të përfshirë në akte kriminale.

Studimi i statistikave nga institucionet dhe organet qendrore dhe lokale të specializuara dhe përgjegjëse në këtë fushë, tregojnë se në shumë raste shqetësimi i publikut në lidhje me këtë fenomen është i drejtë.

Duke u bazuar nga të dhënat e më poshtme, krahasuar me numrin e krimeve të regjistruar në këto vite, rezulton se veprat penale të kryera nga të miturit kanë ruajtur po ato nivele, domethënë janë rritur në raport me rritjen e veprave penale në përgjithësi. Kjo tendencë e rritjes së veprës penale tek të miturit përkrah rritjes së krimit në përgjithësi është e dukshme edhe në vendet tjera në rajon dhe në përgjithësi në Republikën e Maqedonisë.

Tabela. 2: -

#### Të miturit që kanë kryer vepra penale në rrethin e Gostivarit gjatë viteve 2009-2014

|                                          | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 |
|------------------------------------------|------|------|------|------|------|------|
| Të mitur të paraqitur (Lëndë të pranuar) | 143  | 68   | 101  | 50   | 53   | 64   |
| Të mitur të dënuar (Lëndë të zgjidhura)  | 40   | 97   | 194  | 33   | 86   | 47   |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>46</sup>

Sipas të dhënave të siguruara nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Gjykata Themelore në Gostivarë, gjatë vitit 2012 janë shënuar gjithsej 50 krime nga të miturit nga

<sup>46</sup> Gjygi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

gjithësej 583, në vitin 2013 numërohen 53 nga gjithësej 486 dhe në vitin 2014 gjithësej 64 krime të tilla nga të miturit nga gjithësej 562, kurse gjatë tre viteve së bashku që nga viti 2012 deri në vitin 2014 janë kryer gjithësej 167 vepra penale nga të miturit nga gjithësej 1631 vepra penale.

E shprehur në përqindje situata e kriminalitetit në rrethin e gjykatës themelore në Gostivarë është si vijon:

- Për vitin 2012 veprat penale të të miturve përbëjnë rrethë 8.6 %,
- Për vitin 2013 veprat penale të të miturve përbëjnë afërsisht 10.91 %,
- Për vitin 2014 veprat penale të të miturve përbëjnë afërsisht 11.31%,
- Gjithësej veprat penale të të miturve nga viti 2012 deri në vitin 2014 përbëjnë afërsisht 10.24%.

**Tabela. 3: -**

**Të miturit që kanë kryer vepra penale në rrethin e Gostivarit, të krahasuara me veprat e kryera penale në përgjithësi në Republikën e Maqedonisë gjatë viteve 2012-2014**

|                           |                  | Lëndë të mbetura nga viti paraprak | Lëndë të reja të pranuar | Gjithësej lëndë për tu përpunuar | Lëndë të zgjidhura | Lëndë të mbetura |
|---------------------------|------------------|------------------------------------|--------------------------|----------------------------------|--------------------|------------------|
| <b>2012</b>               | <b>GJITHËSEJ</b> | 471                                | 583                      | 1054                             | 455                | 599              |
|                           | <b>TË MITUR</b>  | 49                                 | 50                       | 99                               | 33                 | 66               |
|                           | <b>%</b>         | <b>10.4%</b>                       | <b>8.6%</b>              | <b>9.4%</b>                      | <b>7.3%</b>        | <b>11.0%</b>     |
| <b>2013</b>               | <b>GJITHËSEJ</b> | 599                                | 486                      | 1085                             | 564                | 521              |
|                           | <b>TË MITUR</b>  | 66                                 | 53                       | 119                              | 86                 | 33               |
|                           | <b>%</b>         | <b>11.02%</b>                      | <b>10.91%</b>            | <b>10.97%</b>                    | <b>15.25%</b>      | <b>6.33%</b>     |
| <b>2014</b>               | <b>GJITHËSEJ</b> | 521                                | 562                      | 1083                             | 556                | 427              |
|                           | <b>TË MITUR</b>  | 33                                 | 64                       | 97                               | 47                 | 50               |
|                           | <b>%</b>         | <b>6.33%</b>                       | <b>11.39%</b>            | <b>8.96%</b>                     | <b>8.45%</b>       | <b>11.71%</b>    |
| <b>GJITHËSEJ</b>          |                  | <b>1591</b>                        | <b>1631</b>              | <b>3222</b>                      | <b>1575</b>        | <b>1547</b>      |
| <b>GJITHËSEJ TË MITUR</b> |                  | <b>148</b>                         | <b>167</b>               | <b>315</b>                       | <b>166</b>         | <b>149</b>       |
| <b>GJITHËSEJ %</b>        |                  | <b>9.30%</b>                       | <b>10.24%</b>            | <b>9.78%</b>                     | <b>10.54%</b>      | <b>9.63%</b>     |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>47</sup>

Siç u tha më lartë, në një vështrim dhe krahasim të shpejtë të shifrave në nivel republikan, na rezulton se veprat penale në moshat e reja përbëjnë 6.14% të rateve për vitin 2012 (nga 9,042 të veprave të kryera në përgjithësi, 556 janë raste të të miturve). Në vitin 2013

<sup>47</sup> Gjygi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2012-2014

---

shifra pëson një ulje prej rreth 2%, saktësisht, veprat penale të të miturve dhe të rinjve shënojnë 4.95% të rasteve në përgjithësi (nga 9,539, 473 janë raste të të miturve). Gjithashtu edhe në vitin 2014 shifra mbetet afërsisht e barabartë me atë të një vitit më parë, me një ulje të lehtë, nga 11,683 raste, 461 janë raste të veprave penale të kryera nga të miturit, pra rreth 3.94%.<sup>48</sup>

Studimi i të dhënave mbi veprat penale në moshat e reja (të mitur dhe të rinjë), na ndihmon të kuptojmë numrin e të miturve dhe të rinjëve në konflikt me ligjin në raport me të inkriminuarit e tjerë në përgjithësi.

Shifrat prezantuese të veprave penale të të miturve dhe të rinjve gjatë katër viteve të fundit tregojnë qëndrueshmëri të tij. Fenomeni ndonëse nuk ka njohur rritje të ndjeshme, ende mbetet shqetësues. Edhe pse rastet e veprave penale në përgjithësi kanë ruajtur po ato nivele, domethënë janë rritur në raport me rritjen e veprave penale në përgjithësi. Fenomeni bëhet më shqetësues po të kemi parasysh se vepra penale në këto mosha paralajmëron ritme shumë më të larta dhe të shumëfishuara në moshat e rritura.

### **1.1. Karakteristikat socio-demografike të të miturve në rrethin e Gostivarit**

Në vazhdim të kësaj pjese, tabelat në vijim përmbledhin të dhënat socio-demografike të të miturve sipas moshës, gjinisë, përbërja etno-kulturore, statusit familjar, nivelit të shkollimit dhe vendbanimit ku ato jetojnë në rrethin e gjykatës themelore në Gostivarë.

Sipas të dhënave nga gjykata themelore në Gostivarë të paraqitura në grafikun 1 dhe tabelën 4, pasqyrojnë të dhënat e të miturve të dënuar dhe të paraqitur sipas moshës dhe gjinisë. Nga këto të dhëna është konstatuar që mosha mesatare e të miturve të paraqitur për kryerje të veprave penale në nivel regional është 15.6 vjeç me devijim  $\pm 1.2$ , dhe e atyre të dënuar 16.2 me devijim  $\pm 1.2$ . Në pjesën e parë të grafikonit të miturti e paraqitur, vërehet një tendencë në ulje por përqindja e të miturve deri në 14 vjeç është rritur nga 6.3% në vitin 2009, në 17.2% në vitin 2014 me një rritje prej 10.9% që është një rritje vërtetë shqetësuese.


E kundërta ndodhë në pjesën e dytë që fillimisht vërehet një rritje e të miturve të dënuar, por kjo si rezultat i lëndëve të pa zgjidhura ndër vite, dhe më pas në vitet në vazhdim ato normalizohen më numrin e përgjithshëm të veprave të kryera penale, por gjithashtu përqindja e të miturve të dënuar deri në 14 vjeç është rritur nga 7.5% në vitin 2009, në 17.0% në vitin 2014 me një rritje prej 9.5% që gjithashtu është një rritje shumë shqetësuese.

---

<sup>48</sup> Nga faqja e internetit të Entit shtetëror të statistikave

**Grafiku. 1: -**

**Të mitur e paraqitur dhe të dënuar sipas moshës në rrethin e Gostivarit në periudhën 2009 -2014**



Burimi: Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë<sup>49</sup>

Sa i takon pjesëmarrjes së të miturave femra në kryerjen e veprave penale, të dhënat nga tabela 4, janë shqetësuese. Kga këto të dhëna mund të konstatojmë se numri i të miturave femra pjesëmarrëse në kryerjen e veprave penale që nga viti 2009 e deri në vitin 2014 është rritur vazhdimisht me shifra alarmante.

**Tabela. 4: -**

**Të miturit e paraqitur dhe të dënuar që kanë kryer vepra penale sipas gjinisë, gjatë viteve 2009-2014**

|             | GJITHËSEJ TË MITUR TË PARAQITURA |       |         | GJITHËSEJ TË MITUR TË DËNUAR |       |         |
|-------------|----------------------------------|-------|---------|------------------------------|-------|---------|
|             | GJITHËSE                         | FEMRA | % FEMRA | GJITHËSE                     | FEMRA | % FEMRA |
| <b>2009</b> | <b>143</b>                       | 4     | 2.80%   | <b>40</b>                    | 2     | 5.00%   |
| <b>2010</b> | <b>68</b>                        | 5     | 7.35%   | <b>97</b>                    | 5     | 5.15%   |
| <b>2011</b> | <b>101</b>                       | 8     | 7.92%   | <b>194</b>                   | 10    | 5.15%   |
| <b>2012</b> | <b>50</b>                        | 10    | 20.00%  | <b>33</b>                    | 8     | 24.24%  |
| <b>2013</b> | <b>53</b>                        | 15    | 28.30%  | <b>86</b>                    | 21    | 24.42%  |
| <b>2014</b> | <b>64</b>                        | 20    | 31.25%  | <b>47</b>                    | 8     | 17.02%  |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>50</sup>

Të miturat e paraqitura femra për kryerje të veprave penale në vitin 2009 kanë qenë vetëm 4 të mitura femra nga gjithëse 143 apo 2.8% dhe e atyre të dënuara 2 te mitura femra

<sup>49</sup> Storiteli na krivicni deli vo 2015, Statisticki pregled: Naselenie i socialni statistiki, Shkup, Korrik 2015

<sup>50</sup> Gjygyji themelore në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2012-2014



nga gjithëse 40 apo 5%. Këto shifra janë shqetësuse në vitin 2014, pjesëmarrja e femrave në kryerjen e veprave penale në këtë vit është rritur bukur shumë edhe ate të miturat e paraqitura janë 20 nga gjithëse 64 apo 31.25% dhe të miturat e dënuara për vepra penale janë 8 nga gjithëse 47 apo 17.02% (në vitn 2013 të mitura 21 nga gjithëse 86 apo 24, 42%).

Tabela e më poshtëme (tabela 5), paraqet të miturit e paraqitur dhe të dënuar që kanë kryer vepra penale sipas përkatësisë etnike duke përfshi periudhen nga viti 2009 e deri në vitin 2014 në rethin e gjykatës themelore në Gostivar.

**Tabela. 5: -**

**Të miturit e paraqitur dhe të dënuar që kanë kryer vepra penale sipas përkatësisë etnike (komunitetit), gjatë viteve 2009-2014**

|              |              | Gjithësej të<br>mitur | Maqedonas | %      | Shqipëtar | %      | Turq | %      | Rom | %      | Të tjerë | %      |
|--------------|--------------|-----------------------|-----------|--------|-----------|--------|------|--------|-----|--------|----------|--------|
| <b>2009</b>  | Të paraqitur | 143                   | 27        | 18.88% | 53        | 37.06% | 12   | 8.39%  | 40  | 27.97% | 11       | 7.69%  |
|              | Të dënuar    | 40                    | 7         | 17.50% | 15        | 37.50% | 3    | 7.50%  | 13  | 32.50% | 2        | 5.00%  |
| <b>2010</b>  | Të paraqitur | 68                    | 12        | 17.65% | 23        | 33.82% | 7    | 10.29% | 20  | 29.41% | 6        | 8.82%  |
|              | Të dënuar    | 97                    | 14        | 14.43% | 39        | 40.21% | 7    | 7.22%  | 31  | 31.96% | 6        | 6.19%  |
| <b>2011</b>  | Të paraqitur | 101                   | 18        | 17.82% | 34        | 33.66% | 9    | 8.91%  | 30  | 29.70% | 10       | 9.90%  |
|              | Të dënuar    | 194                   | 32        | 16.49% | 65        | 33.51% | 18   | 9.28%  | 57  | 29.38% | 22       | 11.34% |
| <b>2012</b>  | Të paraqitur | 50                    | 8         | 16.00% | 16        | 32.00% | 5    | 10.00% | 16  | 32.00% | 5        | 10.00% |
|              | Të dënuar    | 33                    | 6         | 18.18% | 12        | 36.36% | 2    | 6.06%  | 11  | 33.33% | 2        | 6.06%  |
| <b>2013</b>  | Të paraqitur | 53                    | 10        | 18.87% | 14        | 26.42% | 4    | 7.55%  | 19  | 35.85% | 6        | 11.32% |
|              | Të dënuar    | 86                    | 13        | 15.12% | 29        | 33.72% | 9    | 10.47% | 27  | 31.40% | 8        | 9.30%  |
| <b>2014</b>  | Të paraqitur | 64                    | 12        | 18.75% | 17        | 26.56% | 6    | 9.38%  | 23  | 35.94% | 6        | 9.38%  |
|              | Të dënuar    | 47                    | 8         | 17.02% | 14        | 29.79% | 4    | 8.51%  | 15  | 31.91% | 6        | 12.77% |
| Të paraqitur |              | 479                   | 87        | 18.16% | 157       | 32.78% | 43   | 8.98%  | 148 | 30.90% | 44       | 9.19%  |
| Të dënuar    |              | 497                   | 80        | 16.10% | 174       | 35.01% | 43   | 8.65%  | 154 | 30.99% | 46       | 9.26%  |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivar<sup>51</sup>

Në rrethin e Gostivarit etniteti shqiptar përbën shumicën në këtë regjion si etniteti më i madh. Ashtu siç mund të vërehet edhe nga të dhënat në tabelen e më sipërme, si të miturit e paraqitur ashtu edhe të miturit e dënuar, etniteti shqiptar përbëjnë pjesën më të madhe që gjithsej janë 157 të mitur të paraqitur apo 32.78% dhe 174 të mitur të dënuar apo 35.01% nga numri i përgjithshëm, pastaj etniteti i dytë është ai rom 148 të mitur të paraqitur apo 30.9% dhe 154 të mitur të dënuar apo 31%. Pastaj, pason etniteti maqedonas me 18.16% të mitur të paraqitur dhe 16.1% të mitur të dënuar, etniteti turk ±8.5% dhe etnitete të tjera ±9.2%.

**Tabela. 6: –**

**Statusit familjar i të miturit të paraqitur dhe të dënuar për vepra penale, gjatë viteve 2009-2014**

|                                        | 2009       | 2010      | 2011       | 2012      | 2013      | 2014      | Gjithësej | %      |
|----------------------------------------|------------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|-----------|--------|
| <b>Gjithësej të mitur të paraqitur</b> | <b>143</b> | <b>68</b> | <b>101</b> | <b>50</b> | <b>53</b> | <b>64</b> | 479       |        |
| Dy prindërit                           | 109        | 44        | 68         | 35        | 33        | 40        | 329       | 68.68% |
| Vetëm me nënën                         | 20         | 12        | 16         | 8         | 11        | 12        | 79        | 16.49% |
| Vetëm me babain                        | 9          | 9         | 12         | 4         | 5         | 8         | 47        | 9.81%  |
| Me të tjerë                            | 5          | 3         | 5          | 3         | 4         | 4         | 24        | 5.01%  |
| <b>Gjithësej të mitur të dënuar</b>    | <b>40</b>  | <b>97</b> | <b>194</b> | <b>33</b> | <b>86</b> | <b>47</b> | 497       |        |
| Dy prindërit                           | 27         | 66        | 143        | 20        | 63        | 28        | 347       | 69.82% |
| Vetëm me nënën                         | 8          | 15        | 33         | 8         | 12        | 10        | 86        | 17.30% |
| Vetëm me babain                        | 3          | 10        | 11         | 3         | 7         | 6         | 40        | 8.05%  |
| Me të tjerë                            | 2          | 6         | 7          | 2         | 4         | 3         | 24        | 4.83%  |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>52</sup>

Nga tabela e mësipërme, tabela 6, konstatohet që 68.68% e të miturve të paraqitur për kryerje të veprës penale jetojnë me të dy prindërit, 16.49% jetojnë vetëm me nënën, 9.81% jetojnë vetëm me babain dhe 5.01% me alternativa të tjera me të afërm të tjerë. Situata është e ngjajshme edhe me të miturit e dënuar për vepra penale edhe atë 69.82% e të miturve


<sup>51</sup> Gjygi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2012-2014

<sup>52</sup> Gjygi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2012-2014

jetojnë me të dy prindërit, 17.3% jetojnë vetëm me nënën, 8.05% jetojnë vetëm me babanë dhe 4.83% me alternativa të tjera me të afërm të tjerë.

**Grafiku. 2: –**

**Niveli i shkollimit të të miturit e paraqitur dhe të dënuar për vepra penale, gjatë viteve 2009-2014**




Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>53</sup>

Grafiku 2, tregonë nivelin e shkollimit të të mituve të praqitur dhe të dënuar që kanë kryer vepra penale në rrethin e Gostivarit në periudhen prej vitit 2009 deri në vitin 2014. Rreth 503 nga gjithësej 976 apo rreth 52% e të miturve të paraqitur dhe të dënuar që kanë kryer vepra penale janë me arsim fillor 8 apo 9 vjeçare dhe të tjerët 473 nga gjithësej 976 apo rreth 48% e të miturve të paraqitur dhe të dënuar që kanë kryer vepra penale janë me arsim të mesëm.

**Grafiku. 3: –**

**Vendëbanimi ku jetojnë të miturit e paraqitur dhe të dënuar për vepra penale, gjatë viteve 2009-2014**

<sup>53</sup> Gjygi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2012-2014



Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>54</sup>

Nga grafiku i më mësipërm (grafiku 3), vërejmë që 266 të mitur të paraqitur për kryerje të veprës penale nga gjithësej 479 apo 55.53% jetojnë në periferi të qytetit, 145 të mitur apo 30.27% jetojnë në qendër të qytetit, dhe vetëm 68 e të miturve apo 14.20% jetojnë në fshatë në zonë rurale. Ndërkaq, të miturit e dënuar për verpa penale janë 251 të mitur nga gjithësej 497 apo 50.50% jetojnë në periferi të qytetit, 176 të mitur apo 35.41% jetojnë në qendër të qytetit, dhe 70 e të miturve apo 14.08% jetojnë në fshatë në zonë rurale.

## 2. Vëllimi, dinamika dhe struktura e kriminaliteti në rrethin e Gostivarit

Kriminaliteti i të miturve është një temë e rëndësishme në kriminologji e cila e tërheq vëmendjen e shumë hulumtuesve dhe për këtë arsye është paraqitur një numër i madh i studimeve të cilat kanë të bëjnë me aktivitetet kriminale të të miturve.

Kriminaliteti i të miturve në rrethin e Gostivarit, ashtu si edhe në rajonet e tjera dhe në Republikën e Maqedonisë në përgjithësi, paraqet një dukuri sociale të ndërlikuar, të cilës mund ti qasemi nga këndvështrime të ndryshme, si për shembull vëllimi, struktura, tendencat dhe dinamika e tij. Sjellja kriminale tek të miturit si një fenomen individual mirëpo edhe kriminaliteti në përgjithësi si dukuri e përhapur, është objekt studimi i një numri të madh të shkencave shoqërore, natyrore etj, të cilat këtij fenomeni i japin përkufizime të ndryshme shkencore dhe e

<sup>54</sup> Gjygi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2012-2014

---

analizojnë nga aspekti sociologjik, psikologjik, biologjik, antropologjik, juridik, ekonomik dhe shumë aspekte të tjera. Megjithatë sa i përket rrethit të Gostivarit nuk mund të vërejmë ndonjë veçori të paraqitjes së kriminalitetit të të miturve e cila dallohet nga struktura e përgjithshme e kriminalitetit në Republikën e Maqedonisë në përgjithësi.

Sipas të gjitha studimeve, të miturit e përfshirë në sjellje penale kanë shumë mundësi të vazhdojnë përfshirjen e tyre në vepra penale. Fëmijët në konflikt me ligjin janë 2 deri në 3 herë më shumë të rrezikuar për t'u përfshirë në vepra penale serioze, të dhunshme dhe kronike krahasuar me individët që përfshihen në vepra penale në mosha të rritura<sup>55</sup>.

Sa i përket dinamikës, vëllimit, formave dhe llojeve të kriminalitetit, përkatësisht strukturës së tij në rrethin e Gostivarit, zakonisht, si tregues të këtyre karakteristikave shërbejnë statistikak kriminale të Republikës së Maqedonisë. Si burim i të dhënave do të jetë statistika e jurisprudencës, rezultatet e të cilave i publikon Enti shtetëror për statistika i Republikës së Maqedonisë dhe të dhënat nga Gjykata themelore e Gostivarit, domethënë në këtë punim do të paraqitet kriminaliteti i regjistruar i të miturve në institucionet shtetërore. Statistika e jurisprudencës në Republikën e Maqedonisë mban evidenca ndaras në lidhje me kriminalitetin e të miturve dhe personave madhorë, prandaj ne mundemi që të ndjekim gjendjen dhe tendencat e formave të kriminalitetit përkatësisht të veprave penale kryes të të cilave janë të miturit. Do të merren parasysh evidencat për personat e mitur të paraqitur dhe të dënuar për vepra penale në rrethin e Gostivarit.

Në këtë punim do të analizohen sjelljet kriminale të të miturve në rrethin e Gostivarit e që kanë të bëjnë me ato veprime të cilat janë të inkriminuara me të drejtën tonë penale, përkatësisht me Kodin penal të Republikës së Maqedonisë, domethënë do të paraqiten veprat penale të cilat janë të kryera nga persona të mitur mosha e të cilëve më shpesh është ndërmjet 14 vjeç, pasi që deri në këtë moshë personat e mitur nuk përgjigjen penalisht, dhe 18 vjeç, me arritjen e moshës madhore.

**Tabela. 7: –**  
**Të miturit e raportuar (të paraqitur) që kanë kryer vepra penale gjatë viteve 2009-2014**

---

<sup>55</sup> Robert Flores - Administrator, Child delinquency, U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, May 2003,

|             | Gjithësej të mitur të paraqitur (Lëndë të pranuara) | Deri 14 vjeç | %      | mbi 14 vjeç | %      |
|-------------|-----------------------------------------------------|--------------|--------|-------------|--------|
| <b>2009</b> | <b>143</b>                                          | 9            | 6.29%  | <b>134</b>  | 93.71% |
| <b>2010</b> | <b>68</b>                                           | 5            | 7.35%  | <b>63</b>   | 92.65% |
| <b>2011</b> | <b>101</b>                                          | 11           | 10.89% | <b>90</b>   | 89.11% |
| <b>2012</b> | <b>50</b>                                           | 7            | 14.00% | <b>43</b>   | 86.00% |
| <b>2013</b> | <b>53</b>                                           | 8            | 15.09% | <b>45</b>   | 84.91% |
| <b>2014</b> | <b>64</b>                                           | 11           | 17.19% | <b>53</b>   | 82.81% |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>56</sup>

Duke u bazuar nga të dhënat nga tabela e më sipërme (tabela 7) dhe duke e krahasuar me numrin e të miturve të raportuar që kanë kryer veprave penale të regjistruar në këto vite, rezulton se të miturit e raportuar që kanë kryer veprat penale deri në 14 vjeç, i kanë ruajtur po ato nivele, që donë të thotë, ato janë rritur në raport me rritjen numrit të përgjithshëm të të miturve të raportuar (të paraqitur) që kanë kryer vepra penale në përgjithësi.

Tabela 8, tregon të miturit e paraqitur apo të raportuar që kanë kryer vepra penale gjatë viteve 2009 deri në vitin 2014, por edhe që kanë marrë një zgjidhje si psh: dënim me burg, dënim në para, qortim apo sanksione të ndryshme, si nëpër shtëpi korrigjuese e të ngjajëshme.

**Tabela. 8: –  
Të miturit që kanë kryer vepra penale, lëndë të zgjidhura (të dënuar) gjatë viteve 2009-2014**

|             | Gjithësej të mitur të dënuar (Lëndë të zgjidhura) | Deri 14 vjeç | %     | mbi 14 vjeç | %      |
|-------------|---------------------------------------------------|--------------|-------|-------------|--------|
| <b>2009</b> | <b>40</b>                                         | 3            | 7.50% | <b>37</b>   | 92.50% |
| <b>2010</b> | <b>97</b>                                         | 9            | 9.28% | <b>88</b>   | 90.72% |
| <b>2011</b> | <b>194</b>                                        | 19           | 9.79% | <b>175</b>  | 90.21% |

<sup>56</sup> Gjygi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

|             |           |    |        |           |        |
|-------------|-----------|----|--------|-----------|--------|
| <b>2012</b> | <b>33</b> | 6  | 18.18% | <b>27</b> | 81.82% |
| <b>2013</b> | <b>86</b> | 13 | 15.12% | <b>73</b> | 84.88% |
| <b>2014</b> | <b>47</b> | 8  | 17.02% | <b>39</b> | 82.98% |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>57</sup>

Nga këtu vërehet që trendi i të miturit të dënuar në moshën të re deri në 14 vjeç por edhe të miturve mbi këtë moshë deri 18 vjeç (mbi 14 vjeç) është në rritje, duke filluar nga viti 2009 që nga 40 të mitur të dënuar 3 janë deri 14 vjeç apo 7.50%, në vitin 2010 ka një dyfishim të tyre ku prej 97 të dënuarve 9 janë të mitur deri 14 vjeç apo 9.28%, dhe ky trend ka vazhduar edhe në vitin 2011, që janë 194 të mitur të dënuar, 19 janë të tilë deri në 14 vjeç apo 9.79%.

**Tabela. 9: –**

**Të miturit që kanë kryer vepra penale, lëndë të pranuar (të paraqitura) dhe lëndë të zgjidhura (të dënuar) gjatë viteve 2009-2014**

|             |                                                    | <b>GJITHËSEJ</b> | <b>deri 14 vjeç</b> | <b>%</b>      | <b>mbi 14 vjeç</b> | <b>%</b>      |
|-------------|----------------------------------------------------|------------------|---------------------|---------------|--------------------|---------------|
| <b>2009</b> | Gjithësej të mitur të paraqitur (lëndë të pranuar) | <b>143</b>       | <b>9</b>            | <b>6.29%</b>  | <b>134</b>         | <b>93.71%</b> |
|             | Gjithësej të mitur të dënuar (Lëndë të zgjidhura)  | 40               | 3                   | 7.50%         | 37                 | 92.50%        |
| <b>2010</b> | Gjithësej të mitur të paraqitur (lëndë të pranuar) | <b>68</b>        | <b>5</b>            | <b>7.35%</b>  | <b>63</b>          | <b>92.65%</b> |
|             | Gjithësej të mitur të dënuar (Lëndë të zgjidhura)  | 97               | 9                   | 9.28%         | 88                 | 90.72%        |
| <b>2011</b> | Gjithësej të mitur të paraqitur (lëndë të pranuar) | <b>101</b>       | <b>11</b>           | <b>10.89%</b> | <b>90</b>          | <b>89.11%</b> |
|             | Gjithësej të mitur të dënuar (Lëndë të zgjidhura)  | 194              | 19                  | 9.79%         | 175                | 90.21%        |
| <b>2012</b> | Gjithësej të mitur të paraqitur (lëndë të pranuar) | <b>50</b>        | <b>7</b>            | <b>14.00%</b> | <b>43</b>          | <b>86.00%</b> |
|             | Gjithësej të mitur të dënuar (Lëndë të zgjidhura)  | 33               | 6                   | 18.18%        | 27                 | 81.82%        |
| <b>2013</b> | Gjithësej të mitur të paraqitur (lëndë të pranuar) | <b>53</b>        | <b>8</b>            | <b>15.09%</b> | <b>45</b>          | <b>84.91%</b> |
|             | Gjithësej të mitur të dënuar (Lëndë të zgjidhura)  | 86               | 13                  | 15.12%        | 73                 | 84.88%        |
| <b>2014</b> | Gjithësej të mitur të paraqitur (lëndë të pranuar) | <b>64</b>        | <b>11</b>           | <b>17.19%</b> | <b>53</b>          | <b>82.81%</b> |
|             | Gjithësej të mitur të dënuar (Lëndë të zgjidhura)  | 47               | 8                   | 17.02%        | 39                 | 82.98%        |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>58</sup>

<sup>57</sup> Gjygi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

Në vitet në vazhdim nga viti 2012 deri në vitin 2014 numri i të miturve të dënuar deri 14 vjeç ka pësuar një rritje jashtëzakonisht të madhe gati se dyfish më të lartë se në vitet paraprake edhe përkundër zvogëlimit të të dënuarve në përgjithësi për vepra penale. Në vitin 2012 të dënuarit e mitur deri 14 vjeç nga 33 të dënuar, 6 janë deri 14 vjeç apo 18.18%, që është një shifër e lartë krahasuar me vitet paraprake. Ky trend ka vazhduar edhe gjatë vitit në vitin 2013 dhe 2014 që nga 64 të mitur të dënuar respektivisht 47 të tillë, të mitur deri ky trend ka vazhduar edhe gjatë vitit kanë qenë 11 apo 17.19% respektivisht 8 apo 17.02% të mitur të dënuar 14 vjeç.

Duke u bazuar në të dhënat e Entit shtetëror për statistika dhe të Gjykatës themelore në Gostivar mbi vëllimin dhe strukturën e kriminalitetit dhe llojet e veprave penale të paraqitura, personat e mitur në Republikën e Maqedonisë paraqiten si kryes të veprave penale të ndryshme siç janë: veprat penale kundër jetës dhe trupit, të drejtave dhe lirive të njeriut dhe të qytetarit, lirisë gjinore dhe moralit gjinor, financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë, pronës, sigurisë në komunikacionin publik, qarkullimit juridik, rendit publik.

Të dhënat e tabelës së mëposhtëme (tabela 10), do të na ndihmojnë të kuptojmë edhe llojin e veprës penale që kryhet më shpesh nga të miturit. Për studjuesit dhe lexuesit është e lehtë të evidentohet fakti që vepra penale me frekuencë më të lartë midis të miturve është veprat penale kundër pronës dhe pasurisë, pastaj veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik, veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat penale kundër rendit publike kështu më rradhë.

Për vitin 2009 nga gjithëse 143 të miturit të raportuar që kanë kryer veprat penale, 101 janë të mitur që kanë kryer vepra penale kundër pronës dhe pasurisë, pra afërsisht 70% dhe po kaq është edhe numri i të miturve të dënuar, që nga gjithëse 40 raste 23 janë të mitur të dënuar për vepra penale kundër pronës dhe pasurisë ose rreth 57.5% të numrit të përgjithshëm.

**Tabela. 10: –**

**Vëllimin dhe strukturën e kriminalitetit të të miturve sipas llojit të veprave penale gjatë viteve 2009-2014**

|  | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 |
|--|------|------|------|------|------|------|
|--|------|------|------|------|------|------|

<sup>58</sup> Gjygi themelore në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014



|                                                                           | Të pranuar | Të zgjidhura | Të pranuar | Të zgjidhura | Të pranuar | Të zgjidhura | Të pranuar | Të zgjidhura | Të pranuar | Të zgjidhura | Të pranuar | Të zgjidhura |
|---------------------------------------------------------------------------|------------|--------------|------------|--------------|------------|--------------|------------|--------------|------------|--------------|------------|--------------|
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                          | <b>143</b> | <b>40</b>    | <b>68</b>  | <b>97</b>    | <b>101</b> | <b>194</b>   | <b>50</b>  | <b>33</b>    | <b>53</b>  | <b>86</b>    | <b>64</b>  | <b>47</b>    |
| Veprat penale kundër jetës dhe trupit                                     | 10         | 4            | 4          | 6            | 4          | 12           | 8          | 1            | 1          | 9            | 7          | 3            |
| Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit      |            | 1            |            | 1            | 2          |              |            | 1            | 1          | 2            | 2          |              |
| Veprat penale kundër nderit dhe reputacionit                              |            |              |            |              |            |              |            |              |            |              |            |              |
| Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit                           |            |              |            |              |            |              |            |              |            |              | 1          |              |
| Veprat penale kundër shëndetit publik                                     |            |              | 2          |              | 1          | 2            | 1          | 1            | 1          | 1            | 2          | 3            |
| Veprat penale kundër pronës dhe pasurisë                                  | 101        | 23           | 51         | 70           | 74         | 150          | 36         | 24           | 43         | 63           | 40         | 36           |
| Veprat penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë |            |              | 1          |              |            | 2            |            |              | 1          |              |            | 1            |
| <b>Vazhdimi i Tabelës...</b>                                              |            |              |            |              |            |              |            |              |            |              |            |              |
| Veprat penale kundër sigurisë së përgjithëshme të njerëzve dhe pasurisë   | 6          | 1            | 2          | 6            | 1          | 5            | 1          |              |            | 1            | 2          | 1            |
| Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik                          | 11         | 4            | 6          | 9            | 14         | 15           | 4          | 6            | 2          | 6            | 4          |              |
| Veprat penale kundër detyrës zyrtare                                      | 1          | 1            |            |              |            |              |            |              |            |              |            |              |
| Veprat penale kundër gjyqësorit (kundër të drejtës gjyqësore)             |            |              |            |              |            |              |            |              |            |              | 1          |              |
| Veprat penale kundër trafikut ligjorë                                     | 1          | 2            | 1          |              |            | 3            |            |              |            |              |            |              |
| Veprat penale kundër rendit publik                                        | 13         | 4            | 1          | 5            | 5          | 5            |            |              | 4          | 4            | 5          | 3            |
| Veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare              |            |              |            |              |            |              |            |              |            |              |            |              |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>59</sup>

Për vitin 2010 nga 68 të mitur të raportuar apo 97 të mitur të dënuar për vepra penale, të miturit kanë kryer 51 repektivisht 70 vepra penale kundër pronës dhe pasurisë ose afërsisht 75% të raporuar apo 72% të mitur të dënuar, në vitin 2011 nga 101 të mitur të raportuar apo 194 të

<sup>59</sup> Gjyqi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

---

mitur të dënuar për vepra penale, të miturit kanë kryer 74 repektivisht 150 vepra penale kundër pronës dhe pasurisë ose afërsisht 46.53% apo 77.31% të mitur të dënuar.

Ky trend ka vazhduar edhe përgjatë viteve 2012, 2013 dhe 2014 por për dallim nga vitet e mëparëshme të miturit e raportuar dhe të dënuar që kanë kryer vepra penale në përgjithësi kanë një rënie të ndjeshme, ku në vitin 2012 kjo shifër ka rënë në 50 të mitur të raportuar apo 33 të dënuar për të vazhduar në vitin 2013 në 53 të mitur të raportuar apo 86 të dënuar dhe në vitin 2014, 64 të mitur të raportuar apo 47 të mitur të dënuar.

Këto fakte na tregojnë dhe janë të mjaftueshme për të vërtetuar tezën tashmë të konsoliduar se inkriminimi në mosha më të reja mbart rrezikun e përfshirjes në krime më të sofistikuar, më të organizuara dhe më të rënda me forcimin e eksperiencave.

Interesant është gjithashtu fakti se përkundrejt pritshmërive dhe paragjytimeve tona për përfshirjen e të miturve në vepra si plagosje, vrasje, kanosje etj, sipas shifrave dhe të dhënave tjera të siguruara nga gjykata themelore në Gostivarë dhe enti shtetëror i statistikave, ata i gjejmë më të përfshirë në veprën penale kundër pronës dhe pasurisë. Ky fakt mund të shpjegohet me pamundësinë e shumë prej tyre për të patur burimet e tyre financiare. Varfëria e familjes, nevojat dhe dëshirat e tyre për para, veshmbathje dhe argëtim, pamundësia për t'i siguruar ato me punë dhe aktivitete të ndershme në komunitet, bëhen shtytëse që ata të përfshihen shumë shpejt në kryerjen e këyre lloje të veprave penale. Në perceptimin e tyre kjo është rruga më e "shpejtë" dhe më e "lehtë" për të siguruar të ardhurat e nevojshme.

Në përfundim të analizës së situatës së kriminalitetit tek të miturit do të theksojmë se përfshirja e të miturve dhe të rinjve në vepra penale po shënon rritje. Të miturit dhe të rinjtë janë përfshirë në vepra penale të ndryshme, të ngjashme me veprat e të rriturve. Qendrat kryesore të banimit, qendrat me popullsi heterogjene dhe me pak burime jetese janë epiqendra ku lulëzon edhe kriminaliteti i të miturve. Në të kundërt, qendrat e vogla, me popullsi homogjene, me lidhje të forta dhe tradicionale, karakterizohen nga ritme të ulta të krimit tek të miturit dhe të rinjtë. Të miturit dhe të rinjtë shënojnë shifra të larta në veprën penale kundër pronës dhe pasurisë, në të gjitha llojet e saj. Kundravajtjet e tyre janë në rritje dhe duhen konsideruar si shenjat e para për përfshirje në sjellje penale. Po ashtu, përfshirja në veprën penale të shpërndarjes apo përdorimit të narkotikëve është tepër shqetësuese.

Ndryshimet sociale, ekonomike dhe politike, mungesa e stabilitetit dhe vakumet e krijuara nga mosfunksionimi apo keqfunksionimi qoftë edhe i segmenteve të caktuara të institucioneve dhe organizmave të specializuara, reflekton në numrin e veprave penale edhe tek të miturit dhe të rinjtë në rrethin e Gostivarit por edhe më gjërë në Republikën e Maqedonisë.


### 3. Politika penale ndaj të miturve në Gostivar dhe trendet e zhvillimit të saj

Politika penale e një vendi përcaktohet nga një sërë faktorësh objektivë dhe subjektivë, të cilët kërkojnë të ndihmojnë në dënimin e autorëve të veprës penale nga njëra anë dhe parandalimin e sjelljes kriminale nga ana tjetër.

Disa ekspertë të çështjes së politikës penale e shohin politikën kriminale si një tërësi masash të karakterit penal ose jopenal që synojnë të parandalojnë kriminalitetin si një dukuri individuale dhe kolektive në një vend dhe kohë të caktuar<sup>60</sup>.

**Grafiku. 4: -**

**Të dënuar për vepra penale në rrethin e Gjykatës themelore në Gostivarë gjatë viteve 2012-2014**



<sup>60</sup> Politika Kriminale. E. Elezi dhe V. Hysi, Tiranë 2006

---

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>61</sup>

Duke ju refuar tabelës së mësipërme raporti midis të dënuarve të rritur dhe të mitur është si më poshtë:

⇒ **Viti 2012:** Në vitin 2012 janë dënuar 455 persona me vendim të formës së prerë ku nga keta janë dënuar 33 të mitur. Të miturit zënë 7.3% të personave të dënuar. Të miturit e dënuar për krime zënë 8.1% të dënuarve për krime dhe rreth 4% të dënuarve për kundravajtje penale.

⇒ **Viti 2013:** Në vitin 2013 janë dënuar 564 persona me vendim të formës së prerë ku nga këta janë dënuar 86 të mitur. Numri i të miturve është rritur në krahasim me vitin paraprak dhe ata zënë 15.25% të personave të dënuar. Të miturit e dënuar për krime zënë 16.8% të dënuarve dhe 4.3% për kundravajtje penale.

⇒ **Viti 2014:** Në vitin 2014 janë dënuar 556 persona me vendim të formës së prerë ku nga keta janë dënuar 47 të mitur. Të miturit zënë 8.45% të personave të dënuar. Të miturit e dënuar për krime zënë 9.7% e të dënuarve, ndërsa kundravajtjet penale zënë rreth 3.4%.

Gjithësej nga viti 2012 deri në vitin 2014 janë dënuar 1575 persona me vendim të formës së prerë ku nga keta janë dënuar 166 të mitur. Të miturit zënë 10.54% të personave të dënuar. Të miturit e dënuar për krime përbëjnë 11.53% përqind të dënuarve dhe kundravajtjet rreth 3.93%<sup>62</sup>.

Një ndër debatet që zhvillohet sot ndërmjet përfaqësuesve dhe ekspertëve të sistemit të drejtësisë është çështja nëse dhënia e drejtësisë nëpërmjet vendimit të Gjykatave, realizohet nëpërmjet një politike ndëshkuese apo dhënies së një dënimi të drejtë dhe të merituar. Sigurisht që numri i lartë i dënimeve të dhëna në vite si ndaj të rriturve dhe aplikimi në një masë të vogël i masave alternative, na shtyjnë të besojmë se Gjykatat, të cilat ndodhen nën presionin e opinionit publik dhe shtytjes për një performancë më të lartë, e kanë përdorur dhënien e dënimeve më tepër si një mjet ndëshkimi, sesa si një mjet të dhënies së drejtësisë si për viktimën ashtu edhe të autorit të veprës penale.

---


<sup>61</sup> Gjygji themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

<sup>62</sup> Gjygji themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

Kryesisht analiza e politikës penale në nivel kombëtar bazohet, duke patur parasysh studimin dhe vëzhgimin e një sërë të dhënash për kriminalitetin tek të miturit në Republikën e Maqedonisë, së pari, duke i studiuar të dhënat e arrestimeve dhe dënimeve për të miturit në nivel kombëtar dhe më pasë ato në nivelin lokal, e veçanërisht në rrethin e gjykatës themelore në Gostivarë. Në vazhdim do të bëjmë një analizë të detajuar të të dhënave për masat e dënimeve të shqiptuara në nivel kombëtar por edhe ate lokal nga Gjykata Themelore në Gostivarë, për të treguar nëse janë zbatuar ose jo, në çfarë mënyre, si dhe në cilën masë masat alternative dhe lehtësuese për të miturit.

Duke u bazuar në këto të dhëna dhe nga studimi i disa autoreve të kësajë lëmije, politika penale e zbatuar gjatë periudhës 2009-2014 tregon se numri i personave të dënuar për krime është rritur nga viti në vit. Politika e dënimit ndaj të miturve viteve të fundit, konkretisht gjatë viteve 2013-2014 është ashpërsuar në krahasim me vitet paraprake. Gjithashtu, probleme të shumta ekzistojnë me të miturit e ndaluar, të arrestuar dhe të dënuar. Ligji nuk u jep mundësi policisë ose prokurorisë të përdorin alternative të tjera përveç arrestimit në shtëpi, në burg ose lënie të lirë.

**Grafiku. 5: -**  
**Të denuar për vepra penale në rrethin e Gjykatës themelore në Gostivarë (2012-2014)**



Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>63</sup>

**Tabela. 11 –**

**Të dënuarit e miturit që kanë kryer vepra penale në rrethin e Gostivarit (2009-2014)**

|                                                 | 2009       | 2010      | 2011       | 2012      | 2013      | 2014      |
|-------------------------------------------------|------------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|
| <b>Të mitur të paraqitur (Lëndë të pranuar)</b> | <b>143</b> | <b>68</b> | <b>101</b> | <b>50</b> | <b>53</b> | <b>64</b> |
| <b>Të mitur të dënuar (Lëndë të zgjidhura)</b>  | <b>40</b>  | <b>97</b> | <b>194</b> | <b>33</b> | <b>86</b> | <b>47</b> |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>64</sup>

Të dhënat në tabelën 11 dhe grafikun 5, të siguruara nga institucionet kompetente si gjykata themelore në Gostivarë, Ministrisë së Drejtësisë, enti shtetëror i statistikave e kështu me radhë, tregojnë numrin e dënimeve të zbatuara ndaj të miturve autorë të veprës penale gjatë periudhës 2012-2015, kjo tregon se kemi një rritje të përgjithshme të përfshirjes së të miturve në kryerjen e veprave penale gjatë kësaj periudhe.

Sipas të dhënave të vëzhguara dhe analizuara në nivel lokal, por edhe në atë kombëtar, shihet qartë se ka një tendencë nga sistemi i drejtësisë në Republikën e Maqedonisë që ndaj të miturve që kryejn vepra penale apo kundravajtje penale të zbatojë masa alternative, sesa të zbatojë masë për dënim më burgim. Kjo tendencë është e lidhur edhe me faktin se, në Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë parashikon një sërë masash alternative ndaj të miturve, dhe kjo ka ndikuar në një mekanizëm të kontrollit dhe të zbatimit në masë më të madhe të kësaj mase. Megjithatë, Kodi Penal nuk ka parashikuar zbatimin e masave alternative për një sërë veprash të cilat paraqesin rrezikshmëri shoqërore të ulët ose marrjen në konsideratë të interesit më të lartë të fëmijës në të gjitha vendimet penale.


Për të ilustruar këtë, në këtë studim ne kemi marrë në konsideratë të dhënat e vendimeve penale dhe të masave të dënimit në nivel kombëtar si dhe nga Gjykata Themelore në Gostivarë.

**Grafiku. 6: -**

**Të miturit e dënuar për vepra penale në rrethin e Gjykatës themelore në Gostivarë (2012-2014)**

<sup>63</sup> Gjyji themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

<sup>64</sup> Po Aty...



|                            | 2009      | 2010      | 2011       | 2012      | 2013      | 2014      |
|----------------------------|-----------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|
| <b>Të miturit e dënuar</b> | <b>40</b> | <b>97</b> | <b>194</b> | <b>33</b> | <b>86</b> | <b>47</b> |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>65</sup>

Ashtu siç vihet re nga të dhënat e mësipërme dhe nga grafiku 7, shihen dy tendenca kryesore: Së pari vihet re një rritje e numrit të të miturve të dënuarve nga ana e Gjykatës Themelore në Gostivarë në tre vitet e para nga 2009-2011 dhe më pas një zvoglim dyfish më të ulët në tre vitet tjera nga 2012-2014, por në të njëjtën kohë vihet re edhe një rritje e veprave penale me autorë të miturin.

Ndërkohë më poshtë janë paraqitur të dhënat e mbledhura në vite, të cilat ilustronë llojet e masave të dënimit që ka zbatuar Gjykata Themelore e Gostivarit ndaj të miturve (tabela 12).

**Tabela. 12: -**

**Llojet e masave dhe sanksioneve të dhëna nga Gjykata Themelore e Gostivarit (2009-2014)**

| Llojet e sanksioneve penale                            | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 |
|--------------------------------------------------------|------|------|------|------|------|------|
| <b>Procedura e ndërprerë</b>                           | 11   | 25   | 48   | 15   | 22   | 16   |
| <b>Mbikqyrje e përforcuar nga familje kujdestare</b>   | 2    | 1    | 3    | 0    | 1    | 2    |
| <b>Mbikqyrje e përforcuar nga Qendra</b>               | 2    | 7    | 12   | 2    | 6    | 4    |
| <b>Masa edukuese të shqiptuara</b>                     | 3    | 8    | 23   | 0    | 7    | 0    |
| <b>Dëbim i të huajt nga vendi</b>                      | 0    | 2    | 3    | 0    | 1    | 0    |
| <b>Masa të mbikëqyrjes së përforcuar nga prindërit</b> | 18   | 36   | 68   | 13   | 16   | 11   |
| <b>Aktvendim për ndërprerjen e senacës përgatitore</b> | 0    | 2    | 6    | 0    | 11   | 0    |
| <b>Qortim (Vërejtje)</b>                               | 2    | 10   | 18   | 3    | 9    | 6    |
| <b>Udhëzim në institucion edukues</b>                  | 1    | 4    | 8    | 0    | 5    | 0    |
| <b>Udhëzim në shtëpi përmirësuese</b>                  | 1    | 2    | 5    | 0    | 8    | 8    |

<sup>65</sup> Gjygi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014


|                          |           |           |            |           |           |           |
|--------------------------|-----------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|
| <b>GJITHËSEJ VENDIME</b> | <b>40</b> | <b>97</b> | <b>194</b> | <b>33</b> | <b>86</b> | <b>47</b> |
|--------------------------|-----------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|

Burimi: Enti shtetëror statistikor i Republikës së Maqedonisë<sup>66</sup>

Në grafikun e mëposhtëm (Grafiku 7), gatise gjatë gjithë periudhës që nga viti 2009 e deri në vitin 2014, vihet re se: Gjykata Themelore në Gostivarë ka patur një tendencë në rritje të dhënies së masave më të lehta të dënimit të të miturve dhe pothuajse janë anashkaluar tërësisht dënimet e tyre më të rënda si ajo me burgim.

**Grafiku. 7: –**

**Të denuarit dhe sanksionet e shqiptuara për vepra penale në rrethin e Gostivarit (2012-2014)**



Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>67</sup>

Gjykata Themelore e Gostivarit (2009-2014), ndaj të miturve të dënuar ka shqiptuar lloje të ndryshme të masave dhe sanksioneve, që nga masa të mbikëqyrjes së përforcuar nga prindërit, qortim (vërejtje), udhëzim në shtëpi përmirësuese, mbikqyrje e përforcuar nga qendra dhe në institucion edukues e deri tek ndërpreja e procedurës ndaj tyre që janë në një numer jashtëzakonisht të madh.

**Tabela. 13: –**

**Të miturit e dënuar sipas veprave penale, gjinisë, gjykimit dhe sanksioneve të shqiptuara penale në Republikën e Maqedonisë (2014)**

|  | <b>GJITHËS<br/>EJ</b> | <b>Fëmijë prej moshës 14<br/>deri më 18 vjet</b> | <b>Fëmijë prej moshës 14 deri më 18 vjet</b> |
|--|-----------------------|--------------------------------------------------|----------------------------------------------|
|--|-----------------------|--------------------------------------------------|----------------------------------------------|

<sup>66</sup> Storiteli na krivicni deli vo 2015, Statisticki pregled: Naselenie i socialni statistiki, Shkup, Korrik 2015

<sup>67</sup> Gjygi themelore në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014



|                                                                           |     | Burg për fëmijë |              |                     |                    |                    |                    |             | Masat edukative |                                |                    |                                   |                         |                             |                      |                                     |
|---------------------------------------------------------------------------|-----|-----------------|--------------|---------------------|--------------------|--------------------|--------------------|-------------|-----------------|--------------------------------|--------------------|-----------------------------------|-------------------------|-----------------------------|----------------------|-------------------------------------|
|                                                                           |     | TË GJITHA       | Deri 10 vjet | Prej 8 deri 10 vjet | Prej 5 deri 8 vjet | Prej 3 deri 5 vjet | Prej 2 deri 3 vjet | Deri 2 vjet | TË GJITHA       | Masa disiplinore (Korrigjuese) |                    | Masat e mbikëqyrjes së përforcuar |                         |                             | Masa institucionale  |                                     |
|                                                                           |     |                 |              |                     |                    |                    |                    |             |                 | Qortim                         | Qendër disiplinore | Prindër kujdestarët               | Me të afërm të familjes | Institucion për përkujdesje | Institucion edukativ | Institucion edukativ dhe korrigjues |
| GJITHËSEJ                                                                 | 275 | 8               | -            | -                   | -                  | -                  | 1                  | 7           | 267             | 65                             | -                  | 111                               | -                       | 83                          | 1                    | 7                                   |
| Veprat penale kundër jetës dhe trupit                                     | 28  | 2               | -            | -                   | -                  | -                  | -                  | 2           | 26              | 8                              | -                  | 10                                | -                       | 7                           | -                    | 1                                   |
| Veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit      | 2   | -               | -            | -                   | -                  | -                  | -                  | -           | 2               | 2                              | -                  | -                                 | -                       | -                           | -                    | -                                   |
| Veprat penale kundër nderit dhe reputacionit                              | 1   | -               | -            | -                   | -                  | -                  | -                  | -           | 1               | -                              | -                  | 1                                 | -                       | -                           | -                    | -                                   |
| Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit                           | 9   | 1               | -            | -                   | -                  | -                  | 1                  | -           | 8               | -                              | -                  | -                                 | -                       | 7                           | -                    | 1                                   |
| Veprat penale kundër shëndetit publik                                     | 7   | -               | -            | -                   | -                  | -                  | -                  | -           | 6               | 1                              | -                  | 1                                 | -                       | 3                           | -                    | 1                                   |
| Vazhdimi i Tabelës...                                                     |     |                 |              |                     |                    |                    |                    |             |                 |                                |                    |                                   |                         |                             |                      |                                     |
| Veprat penale kundër pronës (pasurisë)                                    | 154 | 5               | -            | -                   | -                  | -                  | -                  | 5           | 149             | 35                             | -                  | 70                                | -                       | 39                          | 1                    | 4                                   |
| Veprat penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë | 4   | -               | -            | -                   | -                  | -                  | -                  | -           | 4               | 1                              | -                  | 3                                 | -                       | -                           | -                    | -                                   |
| Veprat penale kundër sigurisë së përgjithëshme të njerëzve dhe pasurisë   | 2   | -               | -            | -                   | -                  | -                  | -                  | -           | 2               | 1                              | -                  | 1                                 | -                       | -                           | -                    | -                                   |
| Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik                          | 23  | -               | -            | -                   | -                  | -                  | -                  | -           | 24              | 11                             | -                  | 11                                | -                       | 2                           | -                    | -                                   |
| Veprat penale kundër detyrës zyrtare                                      | 1   | -               | -            | -                   | -                  | -                  | -                  | -           | 1               | 1                              | -                  | -                                 | -                       | -                           | -                    | -                                   |

|                                                                      |           |   |   |   |   |   |   |   |           |          |   |           |   |           |   |   |
|----------------------------------------------------------------------|-----------|---|---|---|---|---|---|---|-----------|----------|---|-----------|---|-----------|---|---|
| <b>Veprat penale kundër gjyqësorit (kundër të drejtës gjyqësore)</b> | <b>3</b>  | - | - | - | - | - | - | - | <b>3</b>  | <b>1</b> | - | <b>1</b>  | - | <b>1</b>  | - | - |
| <b>Veprat penale kundër trafikut ligjorë</b>                         | <b>1</b>  | - | - | - | - | - | - | - | <b>1</b>  | <b>1</b> | - | -         | - | -         | - | - |
| <b>Veprat penale kundër rendit publik</b>                            | <b>39</b> | - | - | - | - | - | - | - | <b>39</b> | <b>3</b> | - | <b>13</b> | - | <b>23</b> | - | - |
| <b>Veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare</b>  | <b>1</b>  | - | - | - | - | - | - | - | <b>1</b>  | -        | - | -         | - | <b>1</b>  | - | - |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>68</sup>

Duke u bazuar nga të dhënat e tabelës së mësipërme (tabela 13), vërejmë që, ashtu si në nivel lokal edhe në nivel kombëtar të Republikës së Maqedonisë, shqiptimi i sanksioneve dhe masat alternative janë zbatuar në masën më të madhe duke u dhënë prioritet në krahasim me ndëshkimin e të miturve me dënime me burgim. Të dhënat në tabelë i referohen vitit 2014, nga gjithëse 275 vepra të kryera penale nga të miturit vetëm 8 të mitur janë dënuar me burg deri 2-3 vjetë burg që përbëjnë rreth 2.9%, kurse të tjerët prej 267 të mitur të dënuar u është shqiptuar masa edukuese ku mbizotërojnë masat e mbikëqyrjes së përforcuar si ajo me prinër kujdestar prej 111 të miturve apo 41.85% dhe shqiptimi i masës në institucion për përkujdesje edhe atë 83 të mitur apo 31.08%. Më pasë vijnë masat e shqiptuara disiplinore si qortimi që gjithëse këtë masë disiplinore e kanë fituar 65 të mitur apo 24.34%, pastaj masë institucionale edukative vetëm 1 i mitur dhe masë institucionale edukative dhe korrigjuese 7 të mitur apo rrethë 3% të tyre.

#### **4. Analiza e gjendjes së kriminalitetit të të miturve në rrethin e Gjykatës themelore në Gostivar në periudhën 2009-2014**

Studimi i karakteristikave fenomenologjike të kriminalitetit të të miturve në rrethin e Gjykatës themelore të Gostivarit si dhe vëllimin dhe dinamika e fëmijëve të mitur të paraqitur (raportuar), të akuzuar dhe të dënuar si dhe lloji e veprave të ktyera penale për të cilat janë paraqitur fëmijët e mitur do të prezentohet në tabelat në vijim.

Të dhënat e marra nga evidencat e Gjykatës themelore në Gostivarë, tregojnë se në periudhën prej vitit 2009 e deri në vitin 2014 ekziston një tendecë e zvogëlimit të numrit të

<sup>68</sup> Gjygi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

rasteve të veprave penale të kryera nga fëmijë e që janë të paraqitura në institucionet përkatëse, por krahasuar me numrin e krimeve të regjistruar në këto vite, rezulton se veprat penale të kryera nga të miturit kanë ruajtur po ato nivele, domethënë janë rritur në raport me rritjen e veprave penale në përgjithësi, e që është e dukshme edhe në vendet tjera në rajon dhe në përgjithësi në Republikën e Maqedonisë.

**Tabela. 14: -**

**Lëndë penale për fëmijë në gjykatën themelore Gostivar në periudhën 2012 – 2014**

| VITI             | Lëndë të pranuar | Lëndë të zgjidhura | Të plotëfuqishme |
|------------------|------------------|--------------------|------------------|
| 2009             | 143              | 40                 | 23               |
| 2010             | 68               | 97                 | 70               |
| 2011             | 101              | 194                | 156              |
| 2012             | 50               | 33                 | 31               |
| 2013             | 53               | 86                 | 22               |
| 2014             | 64               | 47                 | 3                |
| <b>GJITHESEJ</b> | <b>479</b>       | <b>497</b>         | <b>305</b>       |


Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>69</sup>

Nga tabela numër 14, mundë të konstatojmë se në periudhën që nga viti 2009 e deri në vitin 2014, në Gjykatën themelore të Gostivarit janë pranuar gjithsejt 479 lëndë penale për fëmijë të mitur, ndërsa janë të zgjidhura gjithsejt 497 lëndë, dhe kjo e tëra si rezultat e lëndëve të grumbulluar dhe të lëna pas dore të pa zgjidhura nga vitet paraprake. Ashtu siç thamë edhe më lartë, nga të dhënat në tabelë mundë të vërehet një rritje e vogël e lëndëve të pranuar nga viti 2009 deri në vitin 2012, pas kësaj periudhe nga viti 2012 e deri në vitin 2014 vërhet një ulje e konsiderueshme e lëndëve të pranuar penale, me autorë të mituri.

**Grafiku. 8: -**

**Vëllimi dhe dinamika e të miturve të paraqitur në rrethin e Gostivarit në periudhën 2009 -2014**

<sup>69</sup> Gjygji themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014



|                              | 2009       | 2010      | 2011       | 2012      | 2013      | 2014      |
|------------------------------|------------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|
| <b>Të mitur të paraqitur</b> | <b>143</b> | <b>68</b> | <b>101</b> | <b>50</b> | <b>53</b> | <b>64</b> |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>70</sup>

Sipas të dhënave nga grafiku 8, vërejmë një ulje, përkatësisht tendenca e zvogëlimit të rasteve të paraqitura vërehet nga viti 2012 deri në vitin 2014. Për dallim, periodha prej vitit 2009 e deri në vitin 2011 që shënon një rritje të konsiderueshme vitë pas viti të veprave penale të paraqitura.


Në vitin 2009 janë paraqitur gjithsejt 143 raste përkundër vitit 2010 ku janë paraqitur gjithsejt 68 raste, ndërsa në vitin 2011 janë paraqitur 101 raste të veprave penale të kryera nga fëmijët e mitur. Për dallim nga kjo periudhë, periodha prej vitit 2012 shënon një rënie të konsiderueshme të veprave penale të paraqitura për dallim nga periodha 2009 - 2011. Në vitin 2012 janë paraqitur gjithsej 50 raste përkundër vitit 2013 dhe vitit 2014 ku vërehet një rritje e vogël deri në 53 raste, përkatësisht 64 raste ku të miturit paraqiten si kryes të veprave penale.

Tabela në vijim (tabela 15), paraqet raportin e gjinise tek të miturit e paraqitur për kryerjen e veprave penale në rethin e gjykatës themelore të Gostivarit në periudhën 2009-2014.

<sup>70</sup> Gjygi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

Nga të dhënat e paraqitura mund të konstatojmë se nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të paraqitur 479, meshkuj janë 417 (ose 87.05%) ndërsa femra janë 62 (ose 12.94%). Konstatimi është se në rrethin e Gostivarit meshkujt paraqiten më shumë si kryes të veprave penale. Nga kjo tabelë mund të vërejmë se numri i femrave të mitura të paraqitura si kryese të veprave penale shënon rritje në vazhdimësi që nga viti 2009, që kanë qenë vetëm 4 femra të mitura të paraqitura apo 2.80%, në vitin 2010 janë 5 femra të mitura apo 7.35%, në vitin 2011 janë 8 femra të mitura apo 7.92%. Ky trend ka vazhduar edhe gjatë viteve në vazhdim, në vitin 2012 janë gjithëse 10 femra të mitura të paraqitura për kryerje të veprave penale apo 20%, në vitin 2013 janë 15 femra të mitura apo 28.3%, për të arriturr më së shumti në vitin 2014 edhe ate 20 femra të mitura apo 31.25%.

**Tabela. 15: -**  
**Të mitur e paraqitur sipas gjinisë në rrethin e Gostivarit në periudhën 2009 -2014**



Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>71</sup>

Tabela në vijim, tabela 16, paraqet strukturën etnike të fëmijëve të paraqitur si kryes të veprave penale në rrethin e Gostivarit në periudhën 2009 - 2014.

**Tabela 16: - Struktura etnike e fëmijëve të paraqitur si kryes të veprave penale në rrethin e Gostivarit 2009 - 2014**

|      | Gjithësej të mitur të paraqitur (lëndë të pranuar) | Maqedonas | Shqipëtarë | Turq | Rom | Të tjerë |
|------|----------------------------------------------------|-----------|------------|------|-----|----------|
| 2009 | 143                                                | 27        | 53         | 12   | 40  | 11       |
| 2010 | 68                                                 | 12        | 23         | 7    | 20  | 6        |
| 2011 | 101                                                | 18        | 34         | 9    | 30  | 10       |

<sup>71</sup> Gjygi themelore në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

|                  |            |           |            |           |            |           |
|------------------|------------|-----------|------------|-----------|------------|-----------|
| <b>2012</b>      | <b>50</b>  | <b>8</b>  | <b>16</b>  | <b>5</b>  | <b>16</b>  | <b>5</b>  |
| <b>2013</b>      | <b>53</b>  | <b>10</b> | <b>14</b>  | <b>4</b>  | <b>19</b>  | <b>6</b>  |
| <b>2014</b>      | <b>64</b>  | <b>12</b> | <b>17</b>  | <b>6</b>  | <b>23</b>  | <b>6</b>  |
| <b>GJITHËSEJ</b> | <b>479</b> | <b>87</b> | <b>157</b> | <b>43</b> | <b>148</b> | <b>44</b> |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>72</sup>

Në rrethin e gjykatës themelore të Gostivarit, shqiptarët e përbëjnë etnitetin më të madh në këtë rreth në krahasim me etnitetet e tjera si maqedonasit, turqit, romët dhe të tjerët. Siç mund të shihet edhe nga tabela e mësipërme, për nga përkatësia etnike fëmijët shqiptarë për nga rastet apo numri i tyre, ato paraqiten më së shumë si kryes të veprave penale edhe atë 157 raste apo 32.77%, duke u pasuar nga romët me 148 raste apo 30.89%, maqedonasit me 87 raste apo 18.16%, me pas turqit me 43 raste apo 8.97% dhe të tjerët me 44 raste apo 9.18% të të miturve që janë paraqitur në institucionet përkatëse për kryerje të veprave penale.

**Tabela.17: - Kategoria e moshës së fëmijëve të paraqitur si kryes të veprave penale në rrethin e Gostivarit në periudhën 2009 - 2014**

|             | <b>Gjithësej të mitur të paraqitur (lëndë të pranuar)</b> | <b>Deri 14 vjeç</b> | <b>%</b>      | <b>mbi 14 vjeç</b> | <b>%</b>      | <b>2010-2009 (2011-2010....)</b> |
|-------------|-----------------------------------------------------------|---------------------|---------------|--------------------|---------------|----------------------------------|
| <b>2009</b> | <b>143</b>                                                | <b>9</b>            | <b>6.29%</b>  | <b>134</b>         | <b>93.71%</b> | <b>-75</b>                       |
| <b>2010</b> | <b>68</b>                                                 | <b>5</b>            | <b>7.35%</b>  | <b>63</b>          | <b>92.65%</b> | <b>33</b>                        |
| <b>2011</b> | <b>101</b>                                                | <b>11</b>           | <b>10.89%</b> | <b>90</b>          | <b>89.11%</b> | <b>-51</b>                       |
| <b>2012</b> | <b>50</b>                                                 | <b>7</b>            | <b>14.00%</b> | <b>43</b>          | <b>86.00%</b> | <b>3</b>                         |
| <b>2013</b> | <b>53</b>                                                 | <b>8</b>            | <b>15.09%</b> | <b>45</b>          | <b>84.91%</b> | <b>11</b>                        |
| <b>2014</b> | <b>64</b>                                                 | <b>11</b>           | <b>17.19%</b> | <b>53</b>          | <b>82.81%</b> |                                  |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>73</sup>

Nga të dhënat e tabelës numër 17 mund të shihet se nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të paraqitur si kryes të veprave penale në periudhën e viteve 2009 e deri në vitin 2014 është si vijon: 51 (ose 10.64%) paraqiten si fëmijët deri në moshën 14 vjeçare, ndërsa 428 (ose 89.35%) paraqiten si fëmijë mbi moshën 14 vjeçare.

**Tabela. 18: -**

**Struktura dhe vëllimi i kriminalitetit të të miturve sipas llojit të veprave të kryera penale gjatë periudhës së viteve 2009-2014**

|  | <b>2009</b> | <b>2010</b> | <b>2011</b> | <b>2012</b> | <b>2013</b> | <b>2014</b> |
|--|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|
|--|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|-------------|

<sup>72</sup> Gjygji themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

<sup>73</sup> Po Aty...

|                                                                                        | TË PRANUARA | TË ZGJIDHURA | TË PRANUARA | TË ZGJIDHURA | TË PRANUARA | TË ZGJIDHURA | TË PRANUARA | TË ZGJIDHURA | TË PRANUARA | TË ZGJIDHURA | TË PRANUARA | TË ZGJIDHURA |
|----------------------------------------------------------------------------------------|-------------|--------------|-------------|--------------|-------------|--------------|-------------|--------------|-------------|--------------|-------------|--------------|
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                       | <b>143</b>  | <b>40</b>    | <b>68</b>   | <b>97</b>    | <b>101</b>  | <b>194</b>   | <b>50</b>   | <b>33</b>    | <b>53</b>   | <b>86</b>    | <b>64</b>   | <b>47</b>    |
| <b>Veprat penale kundër jetës dhe trupit</b>                                           |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                       | <b>10</b>   | <b>4</b>     | <b>4</b>    | <b>6</b>     | <b>4</b>    | <b>12</b>    | <b>8</b>    | <b>1</b>     | <b>1</b>    | <b>9</b>     | <b>7</b>    | <b>3</b>     |
| Vrasje                                                                                 |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| Dëmtime trupore                                                                        | 7           | 2            | 2           | 4            | 1           | 6            | 6           | 1            | 1           | 7            | 4           |              |
| Dëmtime të rënda trupore                                                               | 1           | 2            | 1           |              | 3           | 5            | 1           |              |             | 1            | 3           | 3            |
| Pjesëmarrje në një rrahje                                                              |             |              |             |              |             |              | 1           |              |             | 1            |             |              |
| Kërcënime me instrument të rrezikshëm në rrahje apo grindje                            | 2           |              | 1           | 2            |             | 1            |             |              |             |              |             |              |
| <b>Veprat penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit</b>            |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                       | <b>0</b>    | <b>1</b>     | <b>0</b>    | <b>1</b>     | <b>2</b>    | <b>0</b>     | <b>0</b>    | <b>1</b>     | <b>1</b>    | <b>2</b>     | <b>2</b>    | <b>0</b>     |
| Privim i jashtëligjshëm i lirisë                                                       |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              | 1           |              |
| Rrezikim i sigurisë                                                                    |             | 1            |             | 1            | 2           |              |             | 1            | 1           | 2            | 1           |              |
| <b>Veprat penale kundër nderit dhe reputacionit</b>                                    |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                       |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| Të tjera                                                                               |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>Veprat penale kundër lirisë gjinore dhe moralit</b>                                 |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                       | <b>0</b>    | <b>0</b>     | <b>0</b>    | <b>0</b>     | <b>0</b>    | <b>0</b>     | <b>0</b>    | <b>0</b>     | <b>0</b>    | <b>0</b>     | <b>1</b>    | <b>0</b>     |
| Përdhunim                                                                              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| Sulm seksual i një fëmije nën moshën 14 vjeç                                           |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              | 1           |              |
| Të tjera                                                                               |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>Veprat penale kundër shëndetit publik</b>                                           |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                       | <b>0</b>    | <b>0</b>     | <b>2</b>    | <b>0</b>     | <b>1</b>    | <b>2</b>     | <b>1</b>    | <b>1</b>     | <b>1</b>    | <b>1</b>     | <b>2</b>    | <b>3</b>     |
| Prodhim dhe shitje e paautorizuar e substancave narkotike, substancave psikotrope etj. |             |              | 1           |              | 1           | 1            |             | 1            | 1           | 1            | 2           | 3            |
| Ndihmesa (mundësimi) në përdorimin e drogave narkotike, substancave psikotrope etj.    |             |              | 1           |              |             | 1            | 1           |              |             |              |             |              |
| <b>Veprat penale kundër pronës (pasurisë)</b>                                          |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                       | <b>101</b>  | <b>23</b>    | <b>51</b>   | <b>70</b>    | <b>74</b>   | <b>150</b>   | <b>36</b>   | <b>24</b>    | <b>43</b>   | <b>63</b>    | <b>40</b>   | <b>36</b>    |
| Dëmtim të pronave të huaja                                                             |             |              |             |              |             |              |             |              | 1           | 1            |             |              |
| Vjedhje                                                                                | 32          | 9            | 13          | 26           | 9           | 26           | 7           | 5            | 14          | 17           | 6           | 9            |
| Vjedhe të rënda                                                                        | 53          | 12           | 30          | 33           | 51          | 101          | 22          | 14           | 24          | 37           | 29          | 22           |
| Grabitje                                                                               | 1           | 1            | 4           | 2            |             | 3            | 3           |              |             | 3            | 2           | 1            |
| Zhvatje (Shmangije)                                                                    | 1           |              | 1           | 1            | 1           | 1            |             | 1            |             |              |             |              |
| Fshehje                                                                                |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| Marrje (prishje) të automjeteve                                                        | 14          | 1            | 3           | 8            | 13          | 19           | 4           | 4            | 4           | 5            | 3           | 4            |
| <b>Veprat penale kundër financave publike, qarkullimit pagesor dhe ekonomisë</b>       |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                       | <b>0</b>    | <b>0</b>     | <b>1</b>    | <b>0</b>     | <b>0</b>    | <b>2</b>     | <b>0</b>    | <b>0</b>     | <b>1</b>    | <b>0</b>     | <b>0</b>    | <b>1</b>     |
| Falsifikim të parave                                                                   |             |              | 1           |              |             | 2            |             |              | 1           |              |             | 1            |
| <b>Veprat penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë</b>          |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                       | <b>6</b>    | <b>1</b>     | <b>2</b>    | <b>6</b>     | <b>1</b>    | <b>5</b>     | <b>1</b>    | <b>0</b>     | <b>0</b>    | <b>1</b>     | <b>2</b>    | <b>1</b>     |
| Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm                                                    | 6           | 1            | 2           | 6            | 1           | 5            | 1           |              |             | 1            | 2           | 1            |
| <b>Vazhdimi i Tabelës....</b>                                                          |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>Veprat penale kundër sigurisë së trafikut publik</b>                                |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                       | <b>11</b>   | <b>4</b>     | <b>6</b>    | <b>9</b>     | <b>14</b>   | <b>15</b>    | <b>4</b>    | <b>6</b>     | <b>2</b>    | <b>6</b>     | <b>4</b>    | <b>0</b>     |
| Rrezikim i sigurisë në trafik                                                          | 11          | 4            | 6           | 9            | 14          | 15           | 4           | 6            | 2           | 6            | 4           |              |
| <b>Veprat penale kundër detyrës zyrtare</b>                                            |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |             |              |

|                                                                                                |           |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|----------|
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                               | <b>1</b>  | <b>1</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> |
| Dhënija e mitos (ryshfet)                                                                      | 1         | 1        |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |
| <b>Veprat penale kundër gjyqësorit (kundër të drejtës gjyqësore)</b>                           |           |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                               | <b>0</b>  | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>1</b> | <b>0</b> |
| Raportim i rrejshëm                                                                            |           |          |          |          |          |          |          |          |          |          | 1        |          |
| Posedim të dëshmvive të rrejshme                                                               |           |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |
| Dhënie e dëshmvive të rrejshme                                                                 |           |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |
| <b>Veprat penale kundër trafikut ligjorë</b>                                                   |           |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                               | <b>1</b>  | <b>2</b> | <b>1</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>3</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> |
| Falsifikim të dokumenteve                                                                      | 1         | 2        | 1        |          |          | 3        |          |          |          |          |          |          |
| <b>Veprat penale kundër rendit publik</b>                                                      |           |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                               | <b>13</b> | <b>4</b> | <b>1</b> | <b>5</b> | <b>5</b> | <b>5</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>4</b> | <b>4</b> | <b>5</b> | <b>3</b> |
| Pengim (Parandalim) të personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare                          | 2         |          |          |          |          | 2        |          |          |          |          |          |          |
| Sulm mbi një zyrtar gjatë kryerjes së sigurisë                                                 |           |          |          |          |          |          |          |          |          |          | 1        |          |
| Detyrim me forcë                                                                               | 1         | 1        |          |          |          |          |          |          | 1        |          | 1        | 1        |
| Prodhimin e paautorizuar, posedimi, ndërmjetësimi dhe tregtia me armë ose materiale shpërthyes |           |          |          |          |          |          |          |          |          |          | 2        |          |
| Të tjera                                                                                       | 10        | 3        | 1        | 5        | 5        | 3        |          |          | 3        | 4        | 1        | 2        |
| <b>Veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare</b>                            |           |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |
| <b>GJITHËSEJ</b>                                                                               | <b>0</b>  | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> | <b>0</b> |
| Kontrabandë me emigrant                                                                        |           |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |          |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>74</sup>

Struktura dhe vëllimi i kriminalitetit të të miturve sipas llojit të veprave të kryera penale gjatë periudhë së viteve 2009-2014 në regjionin e Gostivarit (tabela 18), është si vijon: Për vitin 2009 nga gjithëse 143 të miturit të raportuar që kanë kryer veprat penale, 101 janë të mitur që kanë kryer vepra penale kundër pronës dhe pasurisë (vjedhje të rënda, vjedhje marrje apo prishje e automjeteve), pra afërsisht 70% dhe po kaq është edhe numri i të miturve të dënuar, që nga gjithëse 40 raste 23 janë të mitur të dënuar për vepra penale kundër pronës dhe pasurisë kryesisht për vjedhje të rënda ose rreth 57.5% të numrit të përgjithshëm.

Për vitin 2010 nga 68 të mitur të raportuar apo 97 të mitur të dënuar për vepra penale, të miturit kanë kryer 51 repektivisht 70 vepra penale kundër pronës dhe pasurisë kryesisht vjedhje të rënda ose afërsisht 75% të raporuar apo 72% të mitur të dënuar, në vitin 2011 nga 101 të mitur të raportuat apo 194 të mitur të dënuar për vepra penale, të miturit kanë kryer 74 repektivisht 150 vepra penale kundër pronës dhe pasurisë që sërish kryesojnë vjedhjet e rënda ose afërsisht 46.53% apo 77.31% të mitur të dënuar.

Ky trend ka vazhduar edhe përgjatë viteve 2012, 2013 dhe 2014 por për dallim nga vitet e mëparëshme të miturit e raportuar dhe të dënuar që kanë kryer vepra penale në

<sup>74</sup> Gjygji themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014




përgjithësi kanë një rënie të ndjeshme, ku në vitin 2012 kjo shifër ka rënë në 50 të mitur të raportuar apo 33 të dënuar për të vazhduar në vitin 2013 në 53 të mitur të raportuar apo 86 të dënuar dhe në vitin 2014, 64 të mitur të raportuar apo 47 të mitur të dënuar.

Për dallim nga numri i veprave penale të paraqitura, nga të dhënat në garafikun 9, mund të konstatojmë se numri i fëmijëve të dënuar ndaj të cilëve është zhvilluar procedurë gjyqësore për kryerje të veprave penale është më i vogël. Përkatësisht, nga grafiku shumë lehtë mund të vërehet që të miturit që janë dënuar për vepra penale përgjatë periudhës 2009-2011 vërehet tendenca e një rritjeje, në vitin 2009 nga 40 të mitur të dënuar, më pas në vitin 2010 në 97 të mitur të dënuar, për të arritur në vitin 2011 në 194 të mitur të dënuar (kjo shifër është edhe më e lartë nga të miturit e paraqitur për vitin 2011 por këtë vitë janë zgjidhur shumë lëndë të lëna pas dore nga vitet paraprake).

**Grafiku. 9: -**

**Vëllimi dhe dinamika e fëmijëve të dënuar në rrethin e Gostivarit në periudhën 2009 -2014**



|                           | 2009      | 2010      | 2011       | 2012      | 2013      | 2014      |
|---------------------------|-----------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|
| <b>Të mitur të dënuar</b> | <b>40</b> | <b>97</b> | <b>194</b> | <b>33</b> | <b>86</b> | <b>47</b> |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>75</sup>

Për dallim nga kjo, periudha prej vitit 2012 e deri në vitin 2014, shënon një zvogëlim të konsiderueshëm vitë pas viti të të miturve të dënuar për kryerje të veprave penale. Në vitin 2012 janë dënuar gjithësej vetëm 33 të mitur për vepra penale, në vitin 2013 numri i të miturve

<sup>75</sup> Gjygi themelore në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014


të dënuar shënon një rritje të lehtë në 86 të dënuar për të shënuar ulje sërish në vitin 2014 që të dënuarit e mitur për kryerjen e veprave penale arrijnë shifren 47 të tillë.

Tabela në vijim (tabela 19), paraqet raportin e gjinise tek të miturit e dënuar në rethin e gjykatës themelore të Gostivarit në periudhën 2009-2014.

Nga të dhënat e paraqitura, mund të konstatojmë se nga numri i përgjithshëm prej 497 i fëmijëve të dënuar, meshkuj janë 443 (ose 89.13%) ndërsa femra janë 54 (ose 10.86%). Konstatimi është se në rethin e Gostivarit meshkujt dënohen më shumë si kryes të veprave penale. Të dhënat e kësajë table na tregojnë se si numri i femrave të mitura të paraqitura për kryerje të veprave penale, ashtu edhe numri i femrave të mitura të dënuara si kryese të veprave penale shënon rritje në vazhdimësi që nga viti 2009 (vetëm 5%) e deri në vitin 2014 (17.02%), siç mund të shohim, femrat e mitura si kryese të veprave penale janë të dënuara më së shumti në vitin 2012 gjithse 8 femra të mitura, por në krahasim me dënimet në përgjithësi arrijnë shifrën 24.24% dhe në vitin 2013 që gjithëse janë dënuar 21 femra të mitura apo 24.42%.

**Tabela. 19: -**

**Të mitur të dënuar sipas gjinisë në rethin e Gostivarit në periudhën 2009 -2014**



Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivar<sup>76</sup>

Nga të dhënat e paraqitura mund të konstatojmë se nga numri i përgjithshëm prej 497 i fëmijëve të dënuar, meshkuj janë 443 (ose 89.13%) ndërsa femra janë 54 (ose 10.86%). Konstatimi është se në rethin e Gostivarit meshkujt dënohen më shumë si kryes të veprave penale.

Nga të dhënat e kësajë table mund të vërejmë që, si numri i meshkujve të mitura të paraqitura për kryerje të veprave penale, ashtu edhe numri i femrave të mitura të dënuara si

<sup>76</sup> Gjygi themelore në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

kryese të veprave penale shënon rritje në vazhdimësi që nga viti 2009 (vetëm 5%) e deri në vitin 2014 (17.02%), siç mund të shohim, femrat e mitura si kryese të veprave penale janë të dënuara më së shumti në vitin 2012 gjithsej 8 femra të mitura, por në krahasim me dënimet në përgjithësi arrijnë shifrën 24.24% dhe në vitin 2013 që gjithëse janë dënuar 21 femra të mitura apo 24.42%.

Tabela në vijim, tabela 20, paraqet strukturën etnike të fëmijëve të mitur të dënuar si kryes të veprave penale në rrethin e Gostivarit në periudhën 2009 - 2014.

**Tabela. 20: -**  
**Struktura etnike të fëmijëve të dënuar si kryes të veprave penale në rrethin e**  
**Gostivarit në periudhën 2009 - 2014**

|                  | <b>Gjithësej të mitur të dënuar (lëndë të zgjidhura)</b> | <b>Maqedonas</b> | <b>Shqipëtarë</b> | <b>Turq</b> | <b>Rom</b> | <b>Të tjerë</b> |
|------------------|----------------------------------------------------------|------------------|-------------------|-------------|------------|-----------------|
| <b>2009</b>      | <b>40</b>                                                | <b>7</b>         | <b>15</b>         | <b>3</b>    | <b>13</b>  | <b>2</b>        |
| <b>2010</b>      | <b>97</b>                                                | <b>14</b>        | <b>39</b>         | <b>7</b>    | <b>31</b>  | <b>6</b>        |
| <b>2011</b>      | <b>194</b>                                               | <b>32</b>        | <b>65</b>         | <b>18</b>   | <b>57</b>  | <b>22</b>       |
| <b>2012</b>      | <b>33</b>                                                | <b>6</b>         | <b>12</b>         | <b>2</b>    | <b>11</b>  | <b>2</b>        |
| <b>2013</b>      | <b>86</b>                                                | <b>13</b>        | <b>29</b>         | <b>9</b>    | <b>27</b>  | <b>8</b>        |
| <b>2014</b>      | <b>47</b>                                                | <b>8</b>         | <b>14</b>         | <b>4</b>    | <b>15</b>  | <b>6</b>        |
| <b>GJITHËSEJ</b> | <b>497</b>                                               | <b>80</b>        | <b>174</b>        | <b>43</b>   | <b>154</b> | <b>46</b>       |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivar<sup>77</sup>

Ashtu si edhe numri i fëmijëve të paraqitur si kryes të veprave penale në rrethin e Gostivarit, ku etniteti shqiptarët e përbëjnë etnitetin më të madh në këtë rreth në krahasim me etnitetet e tjera si ato maqedonas, turq, romë dhe të tjerët, nga tabela e mësipërme shihet se për nga përkatësia etnike nga gjithëse 497 të mitur të dënuar për kryerje të veprave penale, fëmijët shqiptarë janë më shumë të dënuar si kryes të veprave penale edhe atë 174 të mitur të dënuar apo 35%, duke u pasuar nga romët me 154 të mitur të dënuar apo 31.58%, maqedonasit me 80 të mitur të dënuar apo 16.09%, me pas turqit me 43 raste apo 8.65% dhe të tjerët me 46 raste apo 9.25% të të miturve që janë dënuar për kryerje të veprave penale nga gjykata themelore në Gostivar.

<sup>77</sup> Gjyqi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

**Tabela. 21: -**  
**Kategoria e moshës së fëmijëve të dënuar si kryes të veprave penale në rrethin e**  
**Gostivarit në periudhën 2009 - 2014**

|             | <b>Gjithësej të mitur të dënuar (lëndë të zgjidhura)</b> | <b>Deri 14 vjeç</b> | <b>%</b>      | <b>mbi 14 vjeç</b> | <b>%</b>      | <b>2010-2009 (2011-2010....)</b> |
|-------------|----------------------------------------------------------|---------------------|---------------|--------------------|---------------|----------------------------------|
| <b>2009</b> | <b>40</b>                                                | <b>3</b>            | <b>7.50%</b>  | <b>37</b>          | <b>92.50%</b> | <b>57</b>                        |
| <b>2010</b> | <b>97</b>                                                | <b>9</b>            | <b>9.28%</b>  | <b>88</b>          | <b>90.72%</b> | <b>97</b>                        |
| <b>2011</b> | <b>194</b>                                               | <b>19</b>           | <b>9.79%</b>  | <b>175</b>         | <b>90.21%</b> | <b>-161</b>                      |
| <b>2012</b> | <b>33</b>                                                | <b>6</b>            | <b>18.18%</b> | <b>27</b>          | <b>81.82%</b> | <b>53</b>                        |
| <b>2013</b> | <b>86</b>                                                | <b>13</b>           | <b>15.12%</b> | <b>73</b>          | <b>84.88%</b> | <b>-39</b>                       |
| <b>2014</b> | <b>47</b>                                                | <b>8</b>            | <b>17.02%</b> | <b>39</b>          | <b>82.98%</b> |                                  |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>78</sup>

Nga të dhënat e tabelës numër 21, mund të shihet që nga numri i përgjithshëm i fëmijëve të dënuar për kryerje të veprave penale në periudhën e viteve 2009 e deri në vitin 2014 është si vijon: 58 (ose 11.67%) paraqiten si të mitur (fëmijë) të dënuar deri në moshën 14 vjeçare, ndërsa 439 (ose 88.33%) paraqiten si të mitur (fëmijë) të dënuar për kryerje të veprave penale mbi moshën 14 vjeçare.

Nga tabela vërejmë se në periudhën e hulumtimit, të miturit e dënuar deri në moshën 14 vjeçare shënon lëvizje të konsiderueshme me numrin e përgjithshëm të dënimeve duke filluar që nga vitit 2009 që janë vetëm 3 të mitur të dënuar apo 7.50% nga numri i përgjithshëm, e duke vazhduar vit pas viti që në vitit 2013 janë 13 të mitur të dënuar apo 15.2% dhe në vitin 2014 janë 8 të mitur të dënuar apo 17.02% nga numri i përgjithshëm.

Përkundër kësajë, sa i përket numrit të të miturve të dënuar për kryerje të veprave penale mbi moshën 14 vjeçare, mund të vërrehet një rrënie e konsiderueshme e dënimit të kësaj grupmoshe, duke filluar që nga viti 2009 që janë 37 të mitur të dënuar apo 92.50% e duke vazhduar deri në vitin 2014 që shënonë një ulje prej rreth 10% krahasuar me vitin 2009, me çrast numri i të dënuarve për kryerje të veprave penale mbi moshën 14 vjeçare është 39 të mitur apo 82.92% nga numri i përgjithshëm.

Në tabelën në vijim, tabelën 22, do të paraqitet numri dhe llojet e sanksioneve të shqiptuara ndaj fëmijëve të mitur nga Gjykata themelore e Gostivarit në periudhën prej viti 2009 e deri në vitin 2014.

<sup>78</sup> Gjyji themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

**Tabela. 22: -**  
**Llojet e sanksioneve penale të shqiptuara ndaj fëmijëve në Gjykatën themelore**  
**Gostivar në peroidhën 2012 - 2014.**

|                                                    | 2009      | 2010      | 2011       | 2012      | 2013      | 2014      | Gjithësej  |
|----------------------------------------------------|-----------|-----------|------------|-----------|-----------|-----------|------------|
| Procedura e ndërprerë                              | 11        | 25        | 48         | 15        | 22        | 16        | <b>137</b> |
| Mbikqyrje e përforcuar nga familje kujdestare      | 2         | 1         | 3          | 0         | 1         | 2         | <b>9</b>   |
| Mbikqyrje e përforcuar nga Qendra                  | 2         | 7         | 12         | 2         | 6         | 4         | <b>33</b>  |
| Masa edukuese të shqiptuara                        | 3         | 8         | 23         | 0         | 7         | 0         | <b>41</b>  |
| Dëbim i të huajt nga vendi                         | 0         | 2         | 3          | 0         | 1         | 0         | <b>6</b>   |
| Masa të mbikëqyrjes së përforcuar nga prindërit    | 18        | 36        | 68         | 13        | 16        | 11        | <b>162</b> |
| Aktvendim për ndërprerjen e senacës përgatitore    | 0         | 2         | 6          | 0         | 11        | 0         | <b>19</b>  |
| Qortim (Vërejtje)                                  | 2         | 10        | 18         | 3         | 9         | 6         | <b>48</b>  |
| Udhëzim në institucion edukues                     | 1         | 4         | 8          | 0         | 5         | 0         | <b>18</b>  |
| Udhëzim në shtëpi përmirësuese                     | 1         | 2         | 5          | 0         | 8         | 8         | <b>24</b>  |
| <b>GJITHËSEJ SANKSIONE (VENDIME) TË SHQIPTUARA</b> | <b>40</b> | <b>97</b> | <b>194</b> | <b>33</b> | <b>86</b> | <b>47</b> | <b>497</b> |

Burimi: Të dhëna nga raportet vjetore të Gjykatës themelore në Gostivarë<sup>79</sup>

Nga prezantimi i këtyre të dhënave mund të konstatojmë se shumica e këtyre sanksioneve janë masa përkatësisht të mbikëqyrjes së përforcuar nga prindërit (162), pastaj qortim (vërejtje) 48 masa të shqiptuara, masa e mbikqyrjes së përforcuar nga qendra për punë sociale (33), ndërsa masat e tjera siç janë udhëzim në shtëpi përmirësuese, udhëzim në institucion edukues janë të shqiptuara më pak. Nga kjo tabelë gjithashtu mund të konstatojmë se ndaj fëmijëve të mitur në masë të konsideueshëm ndërpritet procedura ndaj tyre dhe nuk u shqiptohet asnjë masë edukuese, të tilla raste janë gjithëse 137.

Përgjithësisht sa i përket periudhës 2009-2014 nuk ekzistojnë dallime të mëdha në sanksionet e shqiptuara ndaj fëmijëve. Struktura e sanksioneve është gati e pandryshuar me çrast mund të vërejmë edhe atë që ndaj të miturve Gjykata themelore në Gostivar në vazhdimësi i shqiptojnë masat më të lehta siç janë masat edukuese dhe shqiptohen shumë pak ose aspak dënime me burgim.

<sup>79</sup> Gjyqi themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore të viteve 2009-2014

---

## **5. Strategjia Kombëtare për parandalimin e kriminalitetit të të miturve në Republikën e Maqedonisë**

Me Ligjin për të drejtat e të të miturve, i cili u miratua më 27 korrik 2007 dhe hyri në fuqi më 30 qershor 2009, në Republikën e Maqedonisë u krijua një sistem i drejtësisë për të mitur mbi parimet e drejtësisë reformuese në përputhje me standardet relevante ndërkombëtare dhe evropiane, duke u bazuar në praktikatat më të mira. Ky ligj paraqiti reformat në sistemin e drejtësisë penale, që ka të bëjë me fëmijët, në përputhje me Konventën ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës dhe instrumentet e tjera ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut. Në këtë ligj, paraqitet qasja e mosndëshkimit dhe e drejtësisë reformuese, e cila synon të arrijë atë që është në interes më të mirë për fëmijën.

Në këtë ligj janë futur disa ndryshime të rëndësishme, si:

- ⇒ U themelua Këshilli i Shtetit për Parandalimin e Delikuencës për të Mitur,
- ⇒ Ridrejtimi (masat e devijimit), me anë të të cilave rastet më të lehta zgjidhen në një procedurë jo gjyqësore,
- ⇒ Shërbimi i komunitetit si një masë alternative,
- ⇒ Ndërmjetësimi ndërmjet viktimës dhe kryerësit,
- ⇒ Prania e një avokati gjatë një bisede me të miturin e dyshuar,
- ⇒ Lirim me kusht nga dhënia e dënimit,
- ⇒ Kufizimi i kohëzgjatjes së procedurave hetimore dhe gjyqësore,
- ⇒ Trajnimi i gjyqtarëve të specializuar, prokurorëve, inspektorëve të policisë, avokatëve dhe ndërmjetësve,
- ⇒ Krijimi i departamenteve ose ekipeve të specializuara në qendrat për punë sociale.

Këto janë reforma të rëndësishme në sistemin e drejtësisë për të mitur, që është një proces për të cilin zbatimi praktik kërkon kohë. Disa zgjidhje të ofruara nga Ligji për Drejtësinë e të Miturve, siç janë, për shembull, ndërmjetësimi dhe puna në komunitet, ende nuk kanë gjetur zbatim në praktikë.

Në seancën e mbajtur më 16 nëntor 2009, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miratoi një vendim për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Shtetit për parandalimin e delikuencës për të mitur. Këshilli mbajti sesionin konstituiv më 27 nëntor 2009.

---

Këshilli i Shtetit është i përbërë nga 15 anëtarë, nga të cilët shtatë anëtarë janë me propozim nga Ministria e Drejtësisë, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, përfaqësues nga Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, përfaqësues të Arsimit dhe Shkencës, Ministrinë së Brendshme, si dhe nga Prokuroria Publike, Gjykata Supreme dhe Shoqata e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë. Tetë anëtarët e mbetur të Këshillit të Shtetit zgjidhen me anë të një njoftimi publik nga punonjës të shquar shkencorë dhe profesionalë që punojnë në mbrojtjen e interesave të të miturve, nga të cilët një përfaqësues është nga organizatat joqeveritare për mbrojtjen e fëmijëve.

Duke zbatuar juridiksionin e saj nga Ligji për Drejtësinë e të Miturve, Këshilli i Shtetit miratoi Programin e tij Pesëvjeçar (2010-2014), dhe miratoi plane veprimi vjetore për operacionet e saj.

Më 7 dhjetor 2010, Këshilli i Shtetit miratoi Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve. Strategjia i referohet periudhës 2011-2020 dhe është strategjia e parë në Republikën e Maqedonisë, e cila synon të përcaktojë udhëzimet strategjike dhe prioritetet për parandalimin e delikuencës së të miturve. Në krijimin e kësaj strategjie, vëmendje e veçantë iu kushtua katër parimeve themelore që rrjedhin nga Konventa ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijës:

- ⇒ për të garantuar parimin e mosdiskriminimit dhe për të promovuar barazinë,
- ⇒ për të mbajtur parasysh parimin e asaj që është me rëndësi primare dhe cili është interesi më i mirë i fëmijës
- ⇒ parimi i bazuar në të drejtën për jetë, mbijetesë dhe zhvillim të fëmijës
- ⇒ parimi i respektimit të së drejtës për të shprehur lirisht mendimin e fëmijës mbi të gjitha çështjet që prekin atë.

Strategjia parashikon politika dhe masa parandaluese në të cilat duhet të përfshijë zhvillimi dhe zbatimi si në: familje, shkolla, tek komuniteti, mediat, legjislacioni dhe të gjithë ata që punojnë me fëmijët në rrezik. Masat që duhen marrë duhet të fokusohen në reduktimin e faktorëve të rrezikut dhe forcimin e faktorëve mbrojtës. Kjo ka të bëjmë me përgatitjen e programeve parandaluese, është e nevojshme të identifikohen faktorët e rrezikut specifik dhe të zhvillohen programe të përshtatshme për zvogëlimin e tyre dhe në anën tjetër të identifikohen faktorët mbrojtës dhe të zhvillohen programe për forcimin e tyre.

---

Strategjia e shtjellon parandalimin primar, sekondar dhe terciar<sup>80</sup>:

- **Parandalimi primar** përpiket të adresojë shkaqet dhe faktorët rrënjësor edhe para se fëmijët / të miturit të bëhen pjesë e sistemit të delikuencës për të miturit dhe qëllimi i tij është krijimi i një mjedisi mbrojtës për të gjithë fëmijët.
- **Parandalimi dytësor (sekondar)** ka për qëllim fëmijët dhe të miturit në rrezik, fëmijë që kanë kryer një krim, por nuk janë përgjegjës penalisht. Ajo kërkon të diagnostikojë, por gjithashtu të trajtojë “sjellje të papranueshme” para se të përshkallëzohet, ose të zhvillohet në forma të rënda ose serioze të veprës penale.
- **Parandalimi terciar** i referohet programeve parandaluese që do t'i mundësojnë të miturit të marrë përgjegjësinë për veprën penale dhe pasojat e veprës, por gjithashtu ta ndihmojë atë që të mos kryejë një krim përsëri. Kjo arrihet më së miri nëpërmjet programeve që do të ofrojnë trajtim të përshtatshëm gjatë qëndrimit të tyre në institucione dhe para se të largohen nga institucionet, tu ofrohet mbështetje afatgjate pas kryerjes së krimit, me qëllim të riintegrit në shoqëri. Instrumentet e parandalimit terciar janë kthimi i masave alternative, në veçanti mbikëqyrja mbrojtëse, puna në komunitet dhe ndërmjetësimi.

Në vitin 2011 u krijua një sistem i plotë monitorimi për drejtësinë për të mitur. Ministritë përkatëse e pranuan këtë dhe Këshilli i Shtetit miratoi një listë të treguesve standardë për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Drejtësinë e të Miturve dhe miratoi një metodologji të përshtatshme për mbledhjen e të dhënave për secilin nga treguesit. Këto janë 21 tregues, të krahasueshëm ndër kombëtarisht ose të përzgjedhur nga listat ekzistuese të përdorura në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, mbështeten në treguesit e Kombeve të Bashkuara, por marrin parasysh prioritetet dhe specifikat kombëtare.

Raporti Vjetor i Këshillit Shtetëror për Parandalimin e delikuencës dhe situatës në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuencës së të miturve në vitin 2011 është përgatitur në bazë të këtij rrjeti të treguesve, dhe Këshilli do të vazhdojë të monitorojë situatën e fëmijëve në sistemin e drejtësisë për të miturit duke përdorur këto tregues. Pasi miratimit të raportit vjetor, Parlamenti i Republikës së Maqedonisë rekomandoi që këto tregues standard të përdoren në raportet e rregullta të Entit Shtetëror të Statistikës.

---

<sup>80</sup> Strategjia e përgatitur nga Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delinkvencës për të Mitur 2010-2020



---

Gjykatat themelore dhe zyrat e prokurorëve publikë, në kuadër të projekti “Drejtësi për Fëmijët” të BE-së dhe UNICEF-it, janë të pajisura me kompjuter dhe softëer që u mundësojnë atyre të raportojnë jo vetëm për gjendjen e fëmijëve në konflikt me ligjin, por edhe për fëmijët viktimë dhe dëshmitarët. Të dhënat e marra në bazë të këtij sistemi tregues, mundësojnë përcaktimin e vërtetë dhe monitorimin e politikave, aktiviteteve dhe masave për të përmirësuar gjendjen e fëmijëve në konflikt dhe fëmijët në kontakt me ligjin.

Gjatë vitit 2012, Këshilli i Shtetit ka punuar në projektin hulumtimtues “Ndërtimi i një politike parandaluese mbi delikuencën e të miturve”. Në mënyrë aktive duke vepruar brenda kompetencave të tij, Këshilli i Shtetit duke u bazuar nga fakti që çdo shoqëri duke të investojë në parandalimin nga të gjitha aspektet, veçanërisht në parandalimin e delikuencës së të miturve, sepse në këtë mënyrë gjithashtu e parandalon krimin në përgjithësi. Në situatën kur rritet numri i të rinjve që janë në rrezik, udhëzimet strategjike dhe prioritetet për parandalimin e delikuencës së të miturve, të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Delinkvencës së të Miturve, përfaqësojnë një bazë të mirë për ndërtimin e politikave parandaluese në nivel kombëtar. Subjekti i hulumtimit është mënyra në të cilën realizohet politika parandaluese kundër delikuencës së të miturve.

Objektivat e këtij projekti janë <sup>81</sup>:

- ✓ Për të parë nëse ka parakushte për ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara parandaluese,
- ✓ Të shohin mangësitë themelore në nivel lokal në parandalimin e delikuencës së të miturve,
- ✓ Të identifikojë kushtet e rrezikut,
- ✓ Analiza e procesit të politikës së decentralizimit që do të thotë se niveli lokal duhet të sigurojnë kushte për mbrojtje sociale, të miratojnë programe për nevojat e qytetarëve, si dhe akteve të përgjithshme në fushën e mbrojtjes sociale,
- ✓ Për të parë zbatimin e suksesshëm të konceptit: “Policia në komunitet”, në drejtim të krijimit të komuniteteve të sigurtë, përmirësimin e komunikimit në mes të policisë dhe qytetarëve, duke rritur nivelin e bashkëpunimit me qytetarët, duke rritur nivelin e besimit të publikut në polici. Për këtë qëllim janë krijuar departamente për parandalimin e krimit në kuadër të ministristrisë së brendshme dhe janë trajnuar një numër i madh inspektorësh për parandalimin.

---

<sup>81</sup> Strategjia e përgatitur nga Këshilli i Shtetit për Parandalimin e Delinkvencës për të Mitur 2010-2020

---

Kur flasim për parandalimin, ne flasim për qasjen multi-sektoriale ndërdisiplinore në ndërtimin e strategjive për parandalimin e delikuencës së të miturve, i cili synon të identifikojë faktorët e rrezikut që ndikojnë në paraqitjen e saj, por dhe faktorët që janë të nevojshme për të forcuar komponentin e mbrojtjes në mënyrë që të dominojnë dhe për të parandaluar veprën. Këshilli i Shtetit ka një karakter multidisiplinar dhe sipas përbërjes së tij, është një qendër ku takohen përfaqësuesit e numrit më të madh të subjekteve në sistemin e drejtësisë për të mitur.

## **6. Masat e përgjithshme dhe të veçanta**

Shumë nga programet e drejtësisë për të mitur, ato të shërbimeve për fëmijë si dhe të shkollave fokusohen kryesisht tek fëmijët me probleme afatgjata të sjelljes, tek adoleshentët me rekorde kriminale, ose në edukimin dhe trajtimin e të rinjve. Shumë pak vëmendje i kushtohet fëmijëve parashkollorë dhe atyre të shkollës fillore për të parandaluar sjelljet problematike. Ndërhyrjet zakonisht synojnë të ndreqin sjelljet problematike, delikuencën e shfaqur apo aktet e dhunshme dhe serioze pasi ato janë shfaqur.

Nga studimi i situatës tek fëmijët e mitur në Republikën e Maqedonisë me një vështrim të veçantë në rrethin e gjykatës themelore në Gostivarë rezulton se parandalimi është një qasje më pozitive dhe efektive ndaj problemit. Nga të gjitha ndërhyrjet e njohura për të ulur delikuencën rinore, ndërhyrjet parandaluese që fokusohen tek delikuenca fëminore janë të tilla që shpëtojnë pjesën më të madhe të këtij problemi. Së pari, përpjekjet parandaluese duhen fokusuar para së gjithash tek parandalimi i sjelljeve problematike të vazhdueshme tek fëmijët, së dyti tek parandalimi i delikuencës fëminore, në mënyrë të veçantë tek fëmijët me çrregullime të sjelljes, dhe së treti tek parandalimi i akteve serioze dhe të dhunshme të adoleshentëve, veçanërisht midis fëmijëve delikuentë. “Sa më herët aq më mirë” është një nga parimet që duhet të drejtojë ndërhyrjet për të parandaluar delikuencën fëminore, pavarësisht nëse këto ndërhyrje përqëndrohen në fëmijën, familjen, shkollën apo komunitetin ku ata jetojnë.

Mbështetja për parandalim dhe ndërhyrjet e hershme janë tashmë të deklaruara nga praktikantët dhe profesionistët e kësaj fushe.

Studjuesit e kësaj fushe kanë rekomanduar dhe vazhdojnë të rekomandojnë se ndërhyrjet parandaluese dhe ato riintegruuese duhet të përqëndrohen në faktorët e njohur të riskut si dhe në njohuritë mbi zhvillimin e sjelljes së individit në fëmijëri dhe adoleshencë.

---

Megjithatë, studjuesit e kësaj fushe tërheqin vëmendjen në faktin se nuk ka një dhe vetëm një mënyrë për të parandaluar dhe korrigjuar sjelljen delikuede. Studimet për ndërhyrjet në delikuencën fëminore tregojnë qartë se faktorët e shumëfishtë të rezikut, ndërthurjet e tyre me njëri tjetrin, si dhe kompleksiteti i tyre përbëjnë një sfidë më vete për të realizuar ndërhyrjen.

Në këtë sfidë gjenden të përfshira edhe përpjekjet për të ulur ose shmangur përsëritjen e sjelljeve problematike tek të miturit. Brenda grupit të të miturve dhe të rinjve të rrezikuar nga përfshirja në sjellje problematike ekziston një nëngrup i veçantë i të miturve që kanë patur histori të përfshirjes në sjellje problematike. Parandalimi i përsëritjes së këtyre eksperiencave është jo pak sfidues.

Ndërhyrjet duhet të synojnë ndryshimin si të kushteve ashtu edhe të institucioneve që e nxisin dhe e ushqejnë krimin në komunitet. Për më tepër, sistemi i drejtësisë për të mitur, sistemi i mbrojtjes sociale, dhe shërbime të tjera për të mitur duhet të marrin në konsideratë problemet e shumëfishta që burojnë nga familjet disfunktionale.

Është shumë e rëndësishme **ndërhyrja e herëshme** e a.q. premtuese në parandalimin e delikuencës tek të miturit që në moshën e fëmijërisë tëk fëmijët parashkollorë. Shumë nga programet shkollore dhe komunitare për parandalimin e kriminalitetit fëminor fokusohen në disa fusha të rezikut (riskut) njëherësh. Studjuesit rekomandojnë koordinimin e tipeve të mëposhtme të programve parandaluese shkollore dhe komunitare<sup>82</sup>:

- ➔ Programe të menaxhimit të sjelljes në klasë
- ➔ Program shumëplanësh të bazuara në punën në klasë
- ➔ Kurrikula shkollore që promovojnë kompetencat sociale tek fëmijët dhe të rinjtë
- ➔ Kurrikula që mbështesin zgjidhjen e konflikteve dhe parandalimin e dhunës
- ➔ Ndjekja e programeve të detyrueshme për parandalimin e sjelljeve kriminale
- ➔ Programe aktiviteteve pas shkolle
- ➔ Programe drejtuese
- ➔ Programe të organizimit të shkollave
- ➔ Programe komplekse për parandalime në komunitet.

---

<sup>82</sup> Herrenkohl, T.L., Hawkins, J.D., Chung, I., Hill, K.G., and Battin-Pearson, S. "School and community risk factors and interventions. In Child Delinquents: Development, Intervention, and Service Needs, 2001.

---

Shumë programe unike me fëmijët të moshave të reja janë provuar të jenë efektive në uljen e kriminalitetit në moshat e mëvonshme. Projektet e ndërhyrjes që në moshat fare të vogla, që në foshnjëri, janë aprovuar të sukseshme. Kështu, p.sh. ngritja e programeve mbështetëse për nënat me situatë ekonomike të vështirë, për nënat e pamartuara ose ato të divorcuara kanë qënë pozitive. Nënat në situata të vështira janë vizituar rregullisht nga punonjëset sociale dhe mamitë e qendrave shëndetsore që gjatë shtatzanisë deri në fund të vitit të dytë të jetës së fëmijës. Kur fëmijët janë bërë 15 vjeç, efekti pozitiv i vizitave është reflektuar në nivelin e ulët të sjelljeve problematike dhe kriminale të regjistruar prej këtyre fëmijëve<sup>83</sup>.

Webster – Stratton në vitin 1998 zhvilloi një paketë të kompletuar dhe të suksesshme trajnimi për prindërit me synim ofrimin e shprehive sociale dhe sjelljeve prosociale. Studimi i programeve të ndryshme të ndërhyrjes dhe të parandalimit të krimit tek të miturit tregon se mbështetja e familjeve, edukimi i prindërve, ofrimi i mbështetjeve ndaj familjeve janë hapat e para për të eliminuar sjelljet kriminale tek të miturit. Identifikimi i hershëm i problemeve emocionale dhe të sjelljes duhet të jetë një objektivi për shumë organizma dhe institucione që veprojnë në fushën e fëmijëve. Për nëngrupin e fëmijëve me histori kriminale, përveç sa më sipër, puna me prindërit merr rëndësi të veçantë. Angazhimi dhe konsiderimi i prindërve si partnerë të rëndësishëm në parandalimin e historive kriminale të fëmijëve të tyre e bën të pashmangshme punën intensive me prindërit për përvetësimin e metodave sa më efikase të prindërimit.

Duke u bazuar nga fakti se fëmijët janë të përpunueshëm, janë ende në proces zhvillimi, se ata mund të ndryshojnë kërkon që edhe trajtimi i tyre të bëhet ndryshe nga ai i të rriturve, saktësisht ndërtimin (ngritjen) e një **sitem të posaçëm të drejtësisë** për të mitur.

Për më tepër, moshat e reja vlerësohen si ende të “papjekura për të mbajtur përgjegjësi në mënyrë të barabartë me të rriturit”<sup>84</sup>. Për një kohë të gjatë tashmë, sistemet e drejtësië për të miturit janë ngritur për të mbrojtur të miturit nga dënimet dhe për t’ju dhënë atyre më shumë mundësi dhe hapësirë për dënime alternative dhe shërbime mbështetëse. Sistemi në fjalë përgjithësisht nuk dënon fëmijët me moshë të vogël. Profesionistët e drejtësisë janë të

---

<sup>83</sup> Henderson Olds, et al., Improving the delivery of prenatal care and outcomes of pregnancy: a randomized trial nurse home visitation, 1998

<sup>84</sup> Craig F. Ferris & Thomas Grisso, (eds.) Understanding aggressive behavior in children. New York, 1996.

---

detyruar të ndërhyjnë kur institucione të tjera si shkolla, familja, shërbimet e specializuara për fëmijët dështojnë në përpjekjet e tyre për të mbrojtur fëmijën.

Edhe në vendet ku sistemi i drejtësisë për të mitur ekziston dhe funksionon për një kohë të gjatë, ai shpesh ka shërbyer si një institucion që trajton shumë probleme të sjelljes së të miturve, që institucione të tjera nuk kanë mundur apo nuk i kanë trajtuar në përgjithësi. Ekzistenca e sistemit të drejtësisë për të mitur duhet të funksionojë në lidhje të ngushtë me sisteme dhe institucione të tjera të shërbimit për fëmijë. Fragmentarizimi i aktivitetit të tyre nuk i shërben qëllimit afatgjatë të shoqërisë për uljen e kriminalitetit tek të miturit dhe mbrojtjen e tyre nga përfshirja në sjellje kriminale.

Tashmë në sitemet bashkëkohore të trajtimit të të miturve, sistemi i drejtësisë bashkëpunon me shumë shërbime të tjera si policia, prokuroria, gjykatat, shkollat, shërbimet e shëndetit mendor, shërbimet e mbështetjes sociale, programe të komunitetit për familjet e varfëra, fëmijët pa mbështetje, fëmijët me probleme etj.

Shembuj të tillë pozitivë janë me sa vijon:

- Programi i Shtetit të Miçiganit, SHBA për të miturit e hershëm në konflikt me ligjin, program që konsiston në shërbime në shtëpi për fëmijët nën 13 vjeç që kanë kryer vepra penale.
- Programi i Minesotës për fëmijët me prirje kriminale nën 10 vjeç, program që synon referimin e rastit në të gjitha shërbimet e nevojshme dhe sigurimin e ndërhyrjeve të hershme për të parandaluar thellimin e sjelljes kriminale.
- Projekti i Torontos për të miturit nën 12 vjeç, është njëkohësisht shprehës i politikës së Shtetit Kanadez për trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin dhe synon kombinimin e ndërhyrjeve të fëmijëve, prindërve, shkollave dhe komuniteteve<sup>85</sup>

Të gjitha programet shumësystemike që hartohen për të trajtuar kriminalitetin tek fëmijët dhe të rinjtë ndërtohen mbi parime të ndryshme. Të gjithë këto programe kanë provuar se ndërhyrja duhet të jetë shumëplanëshe dhe ajo është e suksesshme kur është e hershme dhe nga të gjitha drejtimet.

Për sa i përket programeve që bazohen në punën me grupet e fëmijëve të inkriminuar, kujdes duhet të tregohet në ndërtimin dhe funksionimin e grupit, pasi mund të ndodhë që grupi të funksionojë në të kundërt të qëllimit për të cilin ai është ngritur. Grupi mund të ketë efekt

---

<sup>85</sup> Craig F. Ferris & Thomas Grisso, (eds.) Understanding aggressive behavior in children. New York, 1996.

---

kontaminues për pjesëmarrësit në të. Është kjo arsyeja që puna në grup kërkohet të kombinohet me programe të tjera. Me këtë grup rëndësi duhet t'i kushtohet dënimit me kusht si dhe angazhimit në aktivitete dhe kurse që synojnë përmirësimin e shprehive dhe sjelljeve sociale.

Fëmijët me prirje kriminale kanë shumë probleme, duke përfshirë ato të sjelljeve anti-sociale, vështirësi në procesin e të mësuarit, probleme të lidhura me temperamentin, ekspozimin ndaj dhunës dhe neglizhimit etj. Duke u bazuar në të, normalisht lindë nevoja e instalimit të një **mekanizmi të ndërhyrjes së agjentëve**, disa agjensive të cilat aktivitetin kryesorë do ta kenë ofrimin e shërbimeve për nevojat e të miturve me prirje kriminale. Edhe në rastin më të mirë kur këto agjensi ekzistojnë, shërbime të tyre nuk janë të koordinuara.

Studjuesit e kësaj fushe janë të mendimit se për të arritur ngritjen, funksionimin dhe koordinimin e këtyre shërbimeve me qëllim të efikasitetit të tyre, është e nevojshme:

- ⇒ Ngritja e një organizmi koordinues midis agjensive me përfaqësues nga institucione të drejtësisë, të shërbimeve, të edukimit etj që ka autoritetin për të bindur agjensitë për të hartuar dhe realizuar një strategji për trajtimin e fëmijëve me sjellje kriminale.
- ⇒ Ngritjen e një mekanizmi që të bëjë vlerësimin e shërbimit të fëmijës së referuar si p.sh. Qendra Komunitare për Vlerësimin.
- ⇒ Ngritja e një mekanizmi që siguron lidhjen ndër-agjensi pas marrjes së dënimit. Ky mekanizëm do të sigurojë mbështetje për familjen dhe fëmijën në varësi të nevojave dhe mundësive që kanë familje të ndryshme.

Përveç problemeve që kanë të bëjnë me politikat dhe shërbimet direkte ndaj këtyre fëmijëve, mbetet ende shumë për të bërë në drejtim të **çështjeve ligjore** që kanë të bëjnë me kriminalitetin tek të miturit dhe të rinjtë. Disa prej tyre po i paraqesim më poshtë:

- ⇒ Ngritja dhe funksionimi i një sistemi drejtësie për të mitur, i cili përveç dënimeve duhet të parashikojë edhe dënimet alternative, periodat e provës dhe çështje që kanë të bëjnë me edukimin dhe trajnimin për punësim për shumë prej tyre,
- ⇒ Trajnimi dhe përgatitja e profesionistëve që do të merren me këtë sektor të drejtësisë,
- ⇒ Përcaktimi i shkallës së ndërgjegjësimit të të miturve për të kuptuar dëmin e shkaktuar si dhe rëndësinë e dënimit të marrë,

- 
- ⇒ Mbrojtja e të miturve si një e drejtë e tyre veçanërisht në një shkallë ku kompetencat e tyre individuale në mbrojtje të vetvetes nuk janë formuar,
  - ⇒ Përgjegjësia prindërore si një faktor që mundëson dhe rrit kujdesin e prindërve ndaj fëmijëve dhe siguron vazhdimësi në trajtimin e tyre sipas nevojave të fëmijës,
  - ⇒ Alternativat e dënimit për të miturit, të cilat paraqesin një komponent të rëndësishëm për t'i larguar ata nga aktiviteti kriminal në moshë të rritur.

## **7. Praktikrat më të mira të ndërhyrjes socio-kognitive (socio-njohëse) për parandalimin e kriminalitetit të të miturve**

Vlerësimet e bëra lidhur me praktikrat socio-kognitive<sup>86</sup> (socio-njohëse) të ndërhyrjeve për të parandaluar sjelljet kriminale kanë provuar se ato janë të efektshme veçanërisht për periudha afatshkurtëra. Më poshtë do të përpiqemi të prezantojmë hapat që duhen ndërmarrë për të implementuar këto lloj ndërhyrjeje.

**Identifikimi i grupeve me të cilat synojmë të punojmë:** Kjo metodë është veçanërisht e suksesshme për fëmijët. Sa më të rinjë të jenë pjesmarrësit aq më të mëdha janë shanset për të qenë të sukseshmën në parandalimin e sjelljeve dhe qëndrimeve agresive. E mira është që këto modele të përfshijnë të gjithë fëmijët dhe jo vetëm ato që kanë probleme me sjelljet e tyre. Nëse kjo është e pamundur, atëherë duhet të vlerësohen nevojat, mundësitë, burimet njerëzore dhe financiare në dispozicion etj.

**Konsiderimi i mjedisit kulturor dhe demografik të pjesmarrësve të mundshëm:** Ndërhyrjet socio-kognitive (socio-njohëse) duhet të marrin parasysh mjedisin ku jetojnë dhe situatat me të cilat përballen fëmijët. Fëmijët që vijnë nga mjedise të karakterizuara nga faktorë risku si droga, alkooli, varfëria, divorci etj duhet të mësohen të trajtojnë dhe ballafaqohen me këto probleme.

**Zgjidhja e mjedisit të përshtatshëm për të realizuar programin:** Shumë nga ndërhyrjet socio-kognitive realizohen në shkollë për arsye praktike. Mësuesit janë atje dhe fëmijët janë të grumbulluar për disa orë gjatë ditës. Megjithatë, këto ndërhyrje mund të realizohen edhe në mjedise të tjera ku mund të mblidhen fëmijët. Kështu, nëse ka fëmijë që janë larguar nga shkollë, ata mund të mblidhen edhe në mjedise të tjera siç mund të jenë qendrat komunitare, hapsirat e institucioneve fetare apo edhe mjediset e organizatave të ndryshme.

---

<sup>86</sup> Ky term përdoret për shprehjen që i referohet integritetit të vetive njohëse dhe sociale të sistemeve, proceseve, funksioneve, modeleve, siç janë hulumtimet socio-njohëse, ndërveprimet socio-njohëse e kështu me rradhë.

---

**Përfshirja e komunitetit:** Ndërhyrjet socio-kognitive nuk mund të realizohen në vakum. Komuniteti duhet të përfshihet për të parandaluar sjelljet problematike. Prindërit dhe kujdestarët duhet të bëhen pjesë në përforsimin e njohurive të marra në këto programe. Efektiviteti i ndërhyrjes socio-kognitive varet shumë nga qëndrimi i shkollës në tërësi, duke filluar nga administratorët, mësuesit dhe fëmijët që duhet të kenë rolet e tyre në këtë praktikë. Pavarësisht se sa mirë punohet në këto grupe, efektiviteti i tyre nuk mund të jetë kurrë maksimal po nuk marrin mbështetjen e prindërve, mësuesve dhe komunitetit në tërësi.

**Vendosja e qëllimeve dhe objektivave të qarta për rezultatet e ndërhyrjes:** Ndërhyrjet socio-kognitive promovojnë shprehje sociale duke ndërtuar aftësi komunikimi dhe duke lehtësuar marrëdhëniet mes bashkë-moshatarëve. Qëllimi i tyre është përmirësimi i aftësive për të shmangur konfliktin dhe për ta trajtuar atë në mënyra jo të dhunshme kur ai shfaqet.

**Zgjedhja me kujdes në ndërhyrjen e përshtatshme dhe mbi këtë bazë zgjidhim materialet e duhura:** Zgjedhja e teknikës bëhet mbi bazë të moshës së pjemarrësve. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve modelet përfshijnë:

- shprehje për negociim, të menduarit kritik dhe vendimarrjen,
- shprehje për të identifikuar, manaxhuar dhe përballur me ndjenja të ndryshme duke përfshirë inatin, zemërimin etj,
- përgatitjen për të parashikuar pasojat e një sjellje verbale ose joverbale,
- gjetjen e alternativave jo të dhunshme ndaj konfliktit,
- arsyetimin moral.

Në përgatitjen e materialeve për trajnim, specialistët sugjerojnë përfshirjen e mësuesve në këto programe, përdorimin e zhargonit të fëmijëve kur zemërohen, përfshirjen në grupe të kulturave të ndryshme për t'i mësuar fëmijët të zhvillojnë tolerancën ndaj ndryshimeve, të mësuarit e fëmijëve për faktorët që mund të nxisin sjelljet të dhunshme dhe konfliktuale.

Programet e ndërhyrjes për nxënësit duhet të kategorizohen për nxënësit në përgjithësi dhe për nxënësit me sjellje dhe reagime të dhunshme në veçanti. Për grupin e parë ato duhet të organizohen sipas moshave. Kështu, *për fëmijët e shkollës fillore* duhet të mbahet parasysh se tendencat dhe sjelljet e tyre kriminale zhvillohen shumë shpejt. *Me nxënësit e ciklit të dytë* punohet kryesisht duke ofruar shprehje të komunikimit që synojnë zgjidhjen jo konfliktuale të situatave. *Me nxënësit e shkollave të mesme* synohet nxitja e tyre për të interpretuar role dhe dramatizuar situata ku synohet zgjidhja e butë e konflikteve.



---

Metodat e përdorura për fëmijët që janë përfshirë në sjellje kriminale janë disi më të ndryshme. Fëmijët përfshihen në aktivitete që ulin agresivitetin dhe i bëjnë ata të ndjehen sa më mirë dhe të rrisin aftësitë e vetkontrollit. Në ciklin e dytë fëmijëve u ofrohen mënyra për të shprehur zemërimin, frustacionin, zhgënimin pa dëmtuar të tjerët si dhe mënyra për të analizuar pasojat e sjelljeve të tyre të dhunshme.

Krahas aktiviteteve dhe hapave të sipërpërmendura, në realizimin e këtij programi parandalues këshillohet edhe:

- ☆ përfshirja e aktiviteteve dhe materialeve sa më të larmishme për të mbajtur të interesuar fëmijët dhe të rinjtë gjatë gjithë kohës,
- ☆ adresimi i dhunës në media dhe diskutime rreth saj,
- ☆ përfshirja e mësuesve në të gjithë procesin e trajnimit, koordinimi i programit me aktivitetin dhe punën e agjensive të tjera,
- ☆ zgjedhja e stafit të përshtatshëm për ndërhyrje, lidhja e kësaj ndërhyrje me ndërhyrje apo strategji të tjera,
- ☆ trajnimi i stafit të mësuesve për të qënë të angazhuar dhe të përfshirë në të gjithë programin,
- ☆ inkurajimi dhe angazhimi i vazhdueshëm i pjesëmarrësve, dhe
- ☆ vlerësimi i vazhdueshëm i programit.

## **8. Bashkëpunimi ndër-institucional në Republikën e Maqedonisë në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit të të miturve**

Në bazë të kompetencave të saj dhe të planit operativ për parandalimin e delikuencës së fëmijëve të bazuar në Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e delikuencës (2010-2020), Këshilli Shtetëror monitoron respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe zbatimin e të gjitha aktiviteteve parandaluese të ndërmarrura nga: ministritë kompetente, institucionet, këshillat komunale për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, Ombudsmanit dhe OJQ-ve, të cilët në vitin 2015 kanë bashkëpunuar me Këshillin shtetëror.

### **8.1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH)**

Nëpërmjet institucioneve të saj, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) vazhdimisht ndërmerr aktivitete që lidhen në mënyrë të veçantë me parandalimin parësor të veprave penale të fëmijëve. Në vitin 2015 dallohen aktivitetet e mëposhtme:

---

Në kuadër të projektit “Shkolla e sigurt” në shkollat e mesme është zbatuar metoda e re e a.q. “Ndërmjetësim i kolegëve”, përmes së cilës nxënësit fitojnë shkathtësi për ndërmjetësim - tejkalimin e problemeve me anë të dialogut. Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Departamenti për Komuniteteve dhe Qendra Kombëtare e Romëve hartuan një Dokument Strategjik “Politika për futjen e ndërmjetësve të arsimit rom në arsimin fillor”, një plan veprimi për futjen e sistemit të ndërmjetësimit për të mbështetur nxënësit romë në arsimin fillor, të miratuar nga MASH, me çka thirrja për 20 ndërmjetësues u përfundua në 16 komuna<sup>87</sup>.

Në arsimin e mesëm, sistemi për përzgjedhjen e mentorëve që përgatit nxënësit e shkollave të mesme romë për vazhdimin e arsimit të lartë. Në vitin akademik 2014/2015 janë zgjedhur 127 mentorë të cilët monitorojnë praninë e tyre në mësimdhënie dhe progresin në miratimin e materialit mësimor.

Për të inkurajuar studentët që të ndjekin arsimin, vazhdimisht jepen disa lloje të bursave për kategori të ndryshme të nxënësve si ato social, fëmijë pa prindër, student të dalluar të nacionalitetit rom, për student të talentuar e kështu me rradhë.

Më pas vazhdoi themelimin e klubeve sportive në shkolla dhe vazhdimisht organizojnë gara sportive në disa disiplina sportive, si futboll, basketboll dhe hendboll, ku në frymën konkurruese dhe sportive të fëmijëve ushqehen dhe kanë për qëllim parandalimin e shfaqjes dhe zhvillimin e delikuencës së fëmijëve.

Gjithashtu në maj, tetor dhe nëntor të vitit 2015, në kuadër të projektit “LIDER”, janë mbajtur gara shtetërore për profesione të caktuara për përzgjedhjen e studentëve më të mirë në arsimin profesional nga vitet e fundit në arsimin profesional në Republikën e Maqedonisë, duke inkurajuar kështu krijimtarinë e nxënësit. Janë hapur 52 qendra karriere ku nxënësit mund të flasin për të ardhmen e tyre duke mbështetur kështu arsimin.

Sa i përket zbatimit të projektit “Këshilla për prindërit” gjatë vitit shkollor 2014/2015, u realizuan një total prej 18,539 konsultimeve, duke përfshirë lloje të ndryshme të thirjes për këshillim në shkolla (shih tabelën poshtë, tabela 22):

---

<sup>87</sup> Materiale dhe broshura nga Ministria e Arsimit: <http://www.mon.org.mk/>

**Tabela. 22: -**  
**Numri i prindërve që bëjnë thirrje për këshillim në shkolla**

| Lloji i thirrjes                               | Shkolla Filllore | Shkolla të mesme |
|------------------------------------------------|------------------|------------------|
| Për shkak të uljes së suksesit në të mësuarit  | 4.766            | 6.691            |
| Pjesëmarrja jo e rregullt në procesin mësimorë | 2.128            | 3.723            |
| Për shkak të sjelljes së pahijshme në shkollë  | 723              | 363              |
| Të udhëzuar për në Qendrën për Punë Sociale    | 146              | 53               |
| <b>Gjithësej:</b>                              | <b>7.763</b>     | <b>10.83</b>     |

Burimi: Raporti vjetor i Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës së të miturve në vitin 2015<sup>88</sup>.

Duke i krahasuar të dhënat nga tabelat sipas viteve shkollore, kemi konstatuar se në vitin shkollor 2014/2015 numri i thirrjeve për këshillim të prindërve dhe nxënësve në raport me vitin shkollor 2013/2014 ka rënë. Duhet të theksohet se periodha prej 01.02.2015 deri më 10.06.2015 u mbush me një numër të madh mungesash të pajustificuara për shkak të ngjarjeve që kishin të bënin me protestat e nxënësve të shkollave të mesme, gjë që ndikoi në rritjen e numrit të mungesave nga klasa. Kjo sigurisht ndikoi në suksesin e vetë nxënësve.

## **8.2. Ministria për punë të brendëshme (MPB-ja)**

Gjatë vitit 2015 aktivitetet parandaluese të Ministrisë së Punëve të Brendshme kishin për qëllim zbatimin e programeve dhe planeve për parandalimin dhe çrrënjosjen e delikuencës së të miturve, përmes vizitave të rregullta të oficerëve të policisë në shkolla, për të forcuar bashkëpunimin me shërbime profesionale që synojnë zbulimin e hershëm të fëmijëve mashtrues, si dhe përmes formave dhe aktiviteteve të tjera të ndryshme.

Në kuadër të programeve të parapara, planeve të veprimit dhe projekteve të tjera që kanë për qëllim parandalimin e delikuencës së fëmijëve të mitur, Ministria e Punëve të Brendshme, në vitin 2015, ka organizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Projekti "Bashkëpunimi me të rinjtë në rrezik". Aktivitetet e këtij projekti rrjedhin nga Plani i Veprimit për periudhën 2014-2015 dhe objektivi i tij kryesor është krijimi i një Programi Parandalues në të cilin policia ndihmon në identifikimin e të rinjve në rrezik që rrjedhin nga

<sup>88</sup> Godisen Izvestaj za rabota na Drzaven Sovet za prevencija na detsko prestapnistvo i za sostojbite vo oblata na pravata na deteto i detskoto prestapnistvo vo 2015 godina, Shkup 2016

---

sjellja e tyre asociale deri në pjesëmarrjen e tyre në programet e riintegritit dhe rehabilitimit.

- ⇒ Projekti “Festimet e sigurta të diplomimit (maturës)”, të destinuara për nxënësit e diplomuar, e realizuar tetë vite radhazi. Ky projekt ka për qëllim të parandalojë sjelljen anti-shoqërore dhe të devijuar të të rinjve gjatë festimeve të maturës, duke përfshirë aktivitete parandaluese në dhe jashtë shkollave, që kanë për qëllim sigurinë e trafikut, abuzimit të tyre me drogë dhe alkool, dhunës dhe sjelljes së pahijshme në vende publike etj.
- ⇒ Projekti “Shkolla të sigurta”, aktivitetet e projektit janë me qëllim përmirësimin e sigurisë së përgjithshme personale nëpër institucionet arsimore për të reduktuar të gjitha format e dhunës në mesin e nxënësve, ndërtimin e besimit dhe komunikimit ndëretnik<sup>89</sup>.

Në kuadër të aktiviteteve parandaluese që janë zbatuar në vitin 2015 nga Ministria e Brendshme, të cilat kanë të bëjnë me reduktimin dhe zhdukjen e delikuentës së fëmijëve, për të shënuar aktivitetet për projektet: “Sport PO, Drogat JO”, të cilat theksojnë vlerat pozitive dhe përfitimet e sportit, “piroteknikët nuk është një lodër” me qëllim për të mbrojtur nga keqpërdorimi i fishekzjarreve dhe efekteve të dëmshme të tyre. Projekti “Patrullat e përziera”, e cila përfshin veprimin e përbashkët në mes të oficerëve të policisë dhe prindërve, bashkëpunimi ndërtimin dhe besimit, ndërgjegjësimin e prindërve për rreziqet e mundshme për fëmijët dhe për të inkurajuar diskutim të hapur mes policisë dhe prindërve për parandalimin e delikuentës së fëmijëve. Projekti “Socializimi ligjor i të rinjve”, esenca e të cilit përfshin aktivitete dhe tema nga fusha të ndryshme që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe delikuentës së fëmijëve.

Gjatë vitit 2015, u zhvilluan edhe aktivitetet në fushën e trafikut në mënyrë që të njoh fëmijët me rregullat dhe rregulloret e trafikut, siguria e fëmijëve si pjesëmarrës në trafik, si dhe forcimi i kulturës së trafikut në mesin e të rinjve, aftësitë e ngasjes së biçikletës dhe motorit dhe aktivitete të tjera pjesë e projektit “semafori i fëmijëve”, “kultura teknike e të rinjve në trafik”, “siguria në ditën e parë të shkollës” dhe të ngjajshme.

Për të monitoruar situatën në lidhje me të drejtat e fëmijëve dhe fëmijëve të cilët për skaqe të ndryshme ishin në konflikt me ligjin, në vitin 2015 MPB-ja vazhdoi bashkëpunimin me Zyrën e UNICEF-it në Shkup dhe në bazë të memorandumit të nënshkruar për bashkëpunim,

---

<sup>89</sup> Materiale dhe broshura nga Ministria e punëve të Brendshme: <http://www.mvr.gov.mk/>

---

zhvillimit dhe ndërtimit të kapaciteteve, realizuan aktivitete që synonin ofrimin e mbështetjes dhe mbrojtjes së fëmijëve. Gjithashtu, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, Ministria e Brendshme merr pjesë në punën e Trupit Koordinues Kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe mospërfillja (neglizhimi), si dhe në përgatitjen e protokollit të përbashkët për veprim në rastet e abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve.

Në vitin 2015, përfaqësuesit e Ministrisë së Punëve të Brendshme ishin pjesë e konferencave, seminareve dhe trajnimeve të ndryshme, ndër të cilat<sup>90</sup> :

- ☆ Pjesëmarrja në Konferencën Kombëtare mbi "Procedurat për trajtimin e fëmijëve viktime",
- ☆ Pjesëmarrës në punën mbi "Fëmijët dhe të rinjtë me probleme arsimore dhe sociale dhe sjellje të keqe, të vendosur në institucione",
- ☆ Pjesëmarrja në tryezën e rrumbullakët me temën "Situata dhe sfidat me fëmijët në rrugë",
- ☆ Pjesëmarrja në Konferencën për "Mekanizmat ligjorë për mbrojtjen dhe punën me fëmijët e ekspozuar ndaj dhunës".

### **8.3. Ministria për punë dhe politikë sociale**

Në vitin 2015, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ka ndërmarrë një sërë aktivitete parandaluese në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve kundër abuzimit dhe neglizhimit, si dhe në fushën e kujdesit dhe edukimit të fëmijëve parashkollor.

Në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve nga abuzimi dhe neglizhimi, janë kryer këto aktivitete<sup>91</sup>:

- Është themeluar një Trup Koordinues Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Neglizhimi, duke përfshirë përfaqësuesit e të gjitha ministrive përkatëse dhe organizatave joqeveritare,
- Përpilimi i Planit Kombëtar i Veprimit për parandalimin dhe trajtimin e abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve 2013-2015, planin operativ për zbatimin e planit të veprimit për parandalimin dhe trajtimin e abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve në vitin 2013 dhe 2014 dhe një protokoll të përbashkët për të vepruar rastet e zbulimit dhe trajtimit të rasteve të abuzimit dhe neglizhimit të fëmijëve,

---

<sup>90</sup> Materiale dhe broshura nga Ministria e punëve të Brendshme: <http://www.mvr.gov.mk/>

<sup>91</sup> Materiale dhe broshura nga Ministria për punë dhe Politikë Sociale: <http://www.mtsp.gov.mk/>

- 
- ⇒ Janë realizuar aktivitetet parandaluese për edukimin dhe mbrojtjen e fëmijëve kundër abuzimit seksual, duke përfshirë gjithsej 156 shkolla (125 shkolla fillore dhe 31 shkolla të mesme), përveç kësaj, u organizuan gjithsej 187 qendra informative, duke mbuluar gjithsej 4941 persona, me staf profesional nga shkollat, nxënësit dhe prindërit,
  - ⇒ Është miratuar një Plan Kombëtar i Veprimit për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve kundër Abuzimit Seksual dhe Pedofilisë,
  - ⇒ Janë zhvilluar programe për funksionimin e familjeve të specializuara kujdestare për strehim, kujdes dhe mbrojtje për fëmijët viktimë,
  - ⇒ Me mbështetjen e UNICEF-it, u mbajtën trajnime për të ndërtuar kapacitetet e profesionistëve për të punuar në ekipet multidisciplinare në rastet e abuzimit të fëmijëve,
  - ⇒ U hapën 30 qendra këshillimore integruese në të gjitha Qendrat për Punë Social (QPS-të) në Republikën e Maqedonisë.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në kuadër të fushës dhe aktiviteteve parandaluese të përkujdesjes dhe edukimit të fëmijëve, i zbatoi ato në 63 institucione publike për fëmijë - kopshte, në 52 komuna në 199 objekte, 29 grupe për kujdesin e fëmijëve në kushte të tjera hapësinore dhe 16 qendra të zhvillimit të fëmijërisë së hershme (13 qendra në institucionet publike dhe 3 qendra komunale), 5 qendra private për zhvillimin e hershëm të fëmijëve, 24 kopshte private, 4 njësi organizative në një institucion të arsimit të lartë dhe në një shkollë private, 2 kopshte organizohen si njësi organizative brenda personave juridikë për nevojat e punonjësve të tyre dhe 2 agjenci për ofrimin e shërbimeve të ruajtjes dhe kujdesit të moshës parashkollore.

Në vitin 2015, numri i fëmijëve të moshës parashkollore të regjistruar është 37,121 fëmijë nga mosha 0-6 vjeç (në institucionet publike për fëmijë, në kopshte private dhe në qendrat private të zhvillimit të fëmijërisë së hershme), duke përfaqësuar 26.3% të numrit të përgjithshëm nga 141,052 fëmijë nga 0-6 vjeç në Republikën e Maqedonisë.

Ndërsa mbulimi i përgjithshëm i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në vitin 2015 ishte 27,929 fëmijë<sup>92</sup>, që përfaqëson 39.5% të numrit të përgjithshëm të 70,750 fëmijëve të moshës 3-6 vjeç në Republikën e Maqedonisë. Krahasuar me 2015 (37,121 fëmijë) në krahasim me 2014 (30.329 fëmijë), numri i fëmijëve u rrit me 22.4% dhe krahasuar me 2008 (22.343 fëmijë), numri i

---

<sup>92</sup> Materiale dhe raporte nga Ministrishtria për punë dhe Politikë Sociale: <http://www.mtsp.gov.mk/>

---

fëmijëve u rrit me 66%. Në vitin 2015, numri i fëmijëve të moshës parashkollore ishte 37,121 fëmijë, duke përfshirë 33,264 fëmijë në institucionet publike për fëmijë, 1,647 fëmijë në institucionet private për fëmijë dhe 2,210 fëmijë në qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve të formuara me ndihmën e UNICEF-it dhe komunave.

#### **8.4. Avokati i Popullit**

Departamenti për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara në institucionin e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2015 vazhdoi të monitorojë situatën me sigurimin e të drejtave dhe lirive të barabarta për të gjithë fëmijët, duke siguruar një jetë me dinjitet dhe respekt për fëmijën si një mbajtës i këtyre të drejtave. Duke vepruar kështu, ai konkludoi se në praktikë realizimi i të drejtave të fëmijëve dhe respektimi i tyre ende nuk është i kënaqshëm.

Në vitin 2015 Avokati i Popullit ka marrë numrin më të madh të ankesave që nga themelimi i këtij institucioni (4403 ankesa), dhe ka rritur ndjeshëm numrin e ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve (158 ose 3.59%), ndërkohë që 9 ankesa janë të lidhura me cënimin e të drejtave të personave me nevoja të veçanta ose 0.2%. Nga gjithsej 158 ankesa, 42 ose 26,58% janë në lidhje me të drejtat e fëmijëve në familje, ose për të arritur marrëdhënie personale dhe kontakt të drejtpërdrejtë me prindin që nuk jetojnë, 34 ankesa ose 21.52% i referohen shkeljes së të drejtës së arsimit fillor dhe të mesëm, 18 ose 11.39% për kompensim financiar për një fëmijë, 17 ose 10.76% për kujdesin shëndetësor, 15 ose 9.49% i referohen dhunës ndaj fëmijëve në familje, çerdhe, shkollë, institucion kujdesi dhe institucioni tjetër, 6 ose 3.80% kanë të bëjnë me të drejtat kur vendosen në institucionet për kujdes dhe korrigjim, 5 ose 3.16% për shkelje të të drejtave për shkak të abuzimit të fëmijëve, vonesa të procedurave para një autoriteti kompetent dhe të drejta të tjera të fëmijëve, dhe në 11 ankesa ose 6.96%, Avokati i Popullit dha këshilla juridike për realizimin e të drejtave të fëmijëve<sup>93</sup>.

Parashtresat për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në familje dhe dhuna tjetër, duke përfshirë edhe abuzimin seksual të fëmijëve janë të paraqitura zakonisht nga prindërit e fëmijëve me përfundimin e martesës, apo kur fëmijët janë të besuar për mbajtjen dhe edukatë me një prind. Në shumicën e rasteve, dhunën në familje e raportojnë vetë viktimat apo nënat e fëmijëve, të cilat tregojnë se autorët e dhunës janë partnerët e tyre martesore/jashtëmartesore që jetojnë ose nuk jetojnë me të së bashku.

---

<sup>93</sup> Materiale dhe raporte nga Zyra e Advokatit të popullit të R. së Maqedonisë: <http://www.ombudsman.mk/>

---

Avokati i Popullit u është drejtuar autoriteteve kompetente si qendrës për shërbime sociale dhe policisë, apo institucioneve të tjera shëndetësore, për të hetuar akuzat e dhunës me rekomandimin për marrjen e masave për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, si dhe masat kundër autorëve të dhunës duke pasur parasysh interesin më të mirë të fëmijës dhe të drejtën e fëmijës për rritjen dhe zhvillimin e duhur. Me gjithë masat e marra për të mbrojtur viktimat, në asnjë rast nuk është kërkuar apo imponuar një masë e përkohshme - largimin e dhunuesit nga shtëpia dhe përmbajturi në shtëpi.

Departamenti për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara vizituan qendren ditore për fëmijët e rrugës, dhe arriti në përfundimin se nuk kishte staf të mjaftueshëm për të punuar me këta fëmijë në qendrat e kujdesit ditor dhe fëmijët përsëri dilnin në rrugë për të lypur ose të kryer vepra të tjera. Në të njëjtën kohë, ai ka konfirmuar se problemi kyç është regjistrimi i lindjes së fëmijës (certifikata e lindjes), pamundësia për t'u përfshirë në arsimin fillor, dhe nuk janë ndërmarrë aktivitete të mjaftueshme nga organet kompetente për punën me prindërit e fëmijëve të rrugës, duke ngritur dhe fuqizuar potencialin dhe mundësitë e tyre prindërore dhe përmirësimin e gjendjes materiale të familjes, me qëllim parandalimin dhe mos lejimin që lypja të jetë si një mënyrë apo mjet për jetesë - ekzistencë familjare.

Avokati i Popullit informoi Ministrinë e Arsimit rreth gjendjes së hulumtimit dhe i paraqiti ekspertëve dhe publikut të gjerë të dhënat e fituara, me rekomandime konkrete për tejkalimin e pengesave me të cilat përballen këta fëmijë në ushtrimin e të drejtës së tyre për arsim.

### **8.5. Bashkëpunimi me organizatat jo qeveritare (OJQ-të)**

Në vitin 2014/2015, si në vitet e kaluara, Këshilli i Shtetit vazhdimisht zgjeron dhe intensifikon bashkëpunimin me sektorin civil. Përfaqësuesit e OJQ-ve marrin pjesë në seancat, takimet e punës dhe tryezat e rrumbullakëta të Këshillit të Shtetit, janë të përfshirë në aktivitete të caktuara të Këshillit të Shtetit dhe anasjelltas, përfaqësues të Këshillit të Shtetit marrë pjesë në ngjarjet dhe aktivitetet që kanë një karakter parandalues, dhe që janë të organizuara nga Organizatat e Shoqërisë Civile.

Për nevojat e këtij raporti janë paraqitur 16 kërkesa me shkrim për organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës. Në bazë të



---

përgjigjes ne do të numrojmë një pjesë të raporteve të marra nga organizatat e shoqërisë civile qe kanë bashkëpunuar me Këshillin e Shtetit me qëllim parandalimin e delikuencës së të miturve, edhe ate: Fshati i fëmijëve SOS në Maqedoni, Shoqata e OJQ-ve për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Shoqata HOPS - Mundësi shëndetësore në Shkup, Shoqata ROMA S.O.S. Prilep, Shoqata HERA, dhe Bashkimi për Kujdesin dhe Edukimin e Fëmijve të Maqedonisë.

## **8.6. Këshillat Komunal**

Në sesionet e Këshillit të Shtetit u shqyrtuan raportet mbi punën e Këshillave Komunal për Parandalimin e Delikuencës së të miturve, të cilat përmbushën dispozitat ligjore për realizimin e Programeve dhe raportimin e Këshillit Shtetëror për aktivitetet e tyre. Këto janë një pjesë e aktiviteteve të Këshillave Komunal që janë më të shquara në punën e tyre dhe përkushtimin ndaj këtyre çështjeve: Këshilli Komunal për Parandalimin e Delikuencës së të miturve të Velesit, Manastirit, Kavadarcit dhe Këshilli Komunal për Parandalimin e Delikuencës së të miturve në Gazi Babë.

---

## **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

### **PËRFUNDIM**

Studimi mbi kriminalitetin tek të miturit dhe të rinjtë ka synuar që krahas evidentimit dhe identifikimit të faktorëve të rrezikut dhe karakteristikave individuale të të miturve në konflikt me ligjin, të formulonte edhe disa konkluzione të përgjithshme mbi bazë të të cilave mund të hartoheshin rekomandime për të gjithë aktorët e kësaj fushe, por veçanërisht për hartuesit e politikave të të gjitha niveleve, të cilat nga ana e tyre mund të influencojnë mbi aktivitetin e përditshëm dhe afatgjatë të institucioneve, agjensive, organizatave që ofrojnë shërbime në këtë fushë.

Mbështetur në qasjen e hulumtimit të lartpërmendur, konsideroj se, përfshirja e të miturve në aktivitete kriminale është kthyer në një shqetësim për shoqërinë në përgjithësi dhe për organet e drejtësisë në veçanti, përfshirja e të miturve në aktivitete kriminale është e lidhur me faktorë individual dhe të jashtëm që krijojnë hapësirën për sjellje asociale përkatësisht kriminale.

Duke u bazuar në këtë, konstatoj që, ky hulumtim ka për qëllim që të krahasojmë dhe të shohë ndikimin apo impaktin e zbatimit të masave edukative të vendosura ndaj të miturve, nëpërmjet prizmit (perspektivës) të supozimeve teorike dhe praktike për zbatimin e trajtimit të edukimit, ndihmës dhe mbrojtjes së të miturit, përmes përfshirjes sistematike të të gjitha palëve të interesuara në mjedisin shoqëror të kryerësit të vepres penale, me qëllim aplikimin e punës profesionale që ajo të jetë sa më real dhe më efektive në praktikë.

Sipas rezultateve të fituara nga ky hulumtim, mund të konkludojmë se, paragjykimet tona lidhur me arsyet që çojnë në delikuencën dhe sjelljet antisociale të të miturve, u konfirmua që:

➤ Shumica e të miturve nuk përfillen (neglizhohen) nga ana e prindërve në procesin edukativ.

Kjo ndodh për shkak të nivelit dhe strukturës edukative dhe arsimore të vetë prindërve, mënyrës së jetesës, funksionimit të familjeve ku fëmijët dëbohen në rrugë, si dhe të vetë grupit të bashkëmoshatarëve të tyre me të cilët ata shoqërohen (socializohen). Të miturit të cilët janë viktimë të dhunës në familje janë karakterizuar nga një model negativ, të rolit nga prindërit e tyre apo qëndrimet e papërshtatshme (kundërthënëse) prindërore, ku sjelljet

---

devijante janë pasojë e mënyrës së ashpër të edukimit, e cila shpesh rezulton në marrëdhëniet konfliktuale mes të miturve dhe prindërve të tyre.

- ✦ Të miturit vijnë nga familjet ku gjendja ekonomike nuk i plotëson kushtet themelore. Ata jetojnë në kushte jashtëzakonisht të vështira, ku prindërit janë të papunë, ata e kuptojnë ekzistencën e tyre duke mbledhur hekur të vjetër, shishe plastike, letra të vjetra ose janë përfitues të asistencës minimale sociale.
- ✦ Pjesa më e madhe e delikuentëve të mitur në lidhje me strukturën e tyre arsimore janë me një arsim fillor jo të plotë të papërfunduar, shumë pak ose një numër shumë i vogël i të miturve kanë përfunduar arsimin fillor apo atë të mesëm.
- ✦ Shumica e të miturve që kanë ndërprerë marrëdhëniet familjare tregojnë një performancë të dobët në shkollë dhe një qëndrim konfliktual ndaj shokëve të tyre të klasës. Sjellja agresive e të miturve është shpesh rezultat i mosëpërfilljes (neglizhencës) prindërore, ku zakonisht një anëtar i familjes është përdorues i alkoolit apo drogës, dhe i mituri është një objektiv apo cak i shpeshtë i keqtrajtimit dhe neglizhencës.
- ✦ Shumica e të miturve kohën e lirë e përdorin për tu endur (bredhur) duke lypur, kohën e lirë ku kryesisht të miturit e përdorin atë për të kryer veprime (vepra) delikuede. Të miturit shumë pak e përdorin kohën e tyre të lirë për të shikuar TV, sport dhe aktivitete të ndryshme sportive e të ngjajëshme.
- ✦ Rreth 80% e të miturve, shumicen e veprave penale e kryhen së bashku duke vepruar në grup me grupin e bashkëmoshatarëve të tyre.
- ✦ Shumica e llojeve të veprave penale që kryejnë të miturit nga mosha 10 deri në moshën 18 vjeçare, janë vjedhjet, ndërsa në një përqindjet më të ulët, të mitur kryejnë vepra të tjera penale si: shkelje të rendit dhe qetësisë publike, krime seksuale, veprat penale kundër jetës dhe trupit, veprat e trafikut etj.
- ✦ Pjesën më të madhe të veprave të tyre penale të miturit i kryejnë në kohën e tyre të lirë, ndërsa më pak nga të miturit i kryejnë vepra penale nën ndikimin e TV, internetit, filmit e kështu me rradhë.
- ✦ Shumica e të miturve që kryejnë vepra penale, kanë tendencë të konsumojnë substanca psikotrope, narkotikë të ndryshmëm, nën ndikimin e të cilëve në mënyrë naive kryejnë edhe vepra të ndryshme penale.
- ✦ Veprat penale që i kryejnë të miturit, shumë shpeshë mund të ndodhë që të njejtat vepra penale ato ti përsërisin.

---

Krahas kësaj, nga ky hulumtim u kuptua që, sa më herët që të identifikohen faktorët, shkaqet dhe rrjedha e tyre që shtyjnë një të mitur të kryehj një vepër penale dhe të jetë shkelës i ligjit, aq më lehtë dhe më efikas do të jetë ndërhyrja e institucioneve të policisë, qendrave të specializuara sociale për të mitur, organeve të drejtësisë dhe të familjeve të të miturve delikuent, duke zbatuar masat edukative që kanë për qëllim parandalim e këtyre sjelljeve antisociale të të miturve dhe kthimin e tyre në një normalitet.

Nga sa u tha më lartë, zbatimi i suksesshëm i masave ligjore për të ndihmuar dhe mbrojtur fëmijët në rrezik dhe fëmijët kryerës të veprave penale, është e nevojshme për të intensifikuar dhe të ngrejë nivelin e bashkëpunimit të institucioneve qendrore përkatëse me komunitetin lokal, kryesisht me institucionet arsimore dhe institucionet e tjera relevante në mënyrë që të zhvillojnë resurset dhe buroret e ndryshme me qëllim zbatimin dhe implementimin e tyre.

## **REKOMANDIME**

Implementimi i të drejtave të të miturve kërkon efikasitet dhe drejtësi në kohën dhe momentin e duhur në të kundërtën situatat e fundit na dëshmojnë se keqpërdorimi i të miturve dhe të rinjve për qëllime të caktuara të çfarëdo natyre qofshin në të ardhmen mund të rezultojnë me tensione jo vetëm nga ana e prindërve por, edhe e qytetarëve dhe institucioneve shtetërore ku shpeshherë paraqiten indikacione me ose pa qëllim për përkeqësimin e këtyre të drejtave individuale, të lirisë së lëvizjes dhe të drejtave të fëmijëve në përgjithësi në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë.

Duke u mbështetur nga rezultat e këtij hulumtimi dhe nga konkluzionet e sipërpërmendura, gjykojmë se është e rëndësishme që palët dhe aktorë të ndryshëm të kësaj fushe, të bashkëveprojnë ndërmjetë tyre me qëllim për të realizuar rekomandimet që vijnë:

### *Rekomandim 1:*

Të gjithë palët (aktorët) duhet të angazhohen më tepër për të informuar publikun më mirë se deri më tani lidhur me prevalencën e kriminalitetit tek të miturit, sjelljet e tyre problematike, mbi numrin e këtyre fëmijëve që marrin ose nuk marrin shërbime për problemet e tyre, llojet e faktorëve të rrezikut dhe punën që bëhet për t'i eliminuar apo zbutur këta faktorë si dhe për shpërndarjen dhe shtrirjen e ndërhyrjeve parandaluese.

---

*Rekomandim 2:*

Është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë që të përgatisë apo të përmisojë sistemin egzistues, në një sistem të unifikuar për mbledhjen e të dhënave si në nivel lokal ashtu edhe në nivel kombëtar, i cili në vete do të ndihmonte jashtëzakonisht në analizën e mirëfilltë të kriminalitetit tek të miturit dhe të rinjtë në Republikën e Maqedonisë, por edhe në rrethin tonë në regjionin e Gostivarit.

*Rekomandim 3:*

Ngritja apo përmisimi i sistemit egzistues të drejtësisë për të miturit është emergjent. Ligjvënësi dhe ekzekutivi duhet të tregohen më seriozë se deri më tani me këtë komponent të sistemit gjyqësor, me qëllim minimizimin e pasojave për një rini të shëndoshë.

*Rekomandim 4:*

Ngritja apo përmisimi i sistemit egzistues gjyqësor për të mitur duhet të shoqërohet me angazhimin më të madh të profesionistëve si punonjës socialë për të krijuar hapsira më fleksibël në trajtimin e të miturve në konflikt me ligjin. Përfshirja e punonjësve socialë në strukturat e kësaj gjykate për të mitur, do të krijojë mundësi për aplikimin e dënimeve alternative, ndjekjen dhe vlerësimin e ecurisë së sjelljes, praktikimin e këshillimit mbështetur në modele të njohura për modelimin e sjelljes, ruajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve me familjen, punën me familjen, aplikimin e metodave të sensibilizimit të publikut të mbështetur në realitetin që egziston në përgjithsi në Republikën e Maqedonisë.

*Rekomandim 5:*

Duke u ndeshur me një realitet ku mungojnë të dhëna të plota ose të pjesshme lidhur me kriminalitetin tek të miturit dhe të rinjtë, del në pah nevoja e realizimit të një studimi në rang kombëtar të politikës penale ndaj të miturve. Ky studim do të ndihmonte jo vetëm sistemin gjyqësor në Republikën e Maqedonisë, për ta bërë atë miqësor ndaj fëmijëve, por ai do të kishte një ndikim të jashtëzakonshëm në politikat publike për fëmijët dhe të miturit në Republikën e Maqedonisë. Studimi i mëtejshëm i politikës penale do t'i hapte rrugë analizës së mirëfilltë dhe dhënies së rekomandimeve përta i përket diskutimit të moshës së përgjegjësisë penale, reformimit të sistemit të drejtësisë për të miturit, si dhe krijimit të një sistemi të zbatimit të masave alternative në Republikën e Maqedonisë me këtë edhe në Gjykatën themelore në Gostivarë.

---

*Rekomandim 6:*

Studimi i sjelljes së fëmijëve në shkolla nga palë (aktorë) të interesuar dhe profesionistë do të mundësonte hartimin e programe efektive të parandalimit të sjelljeve kriminale tek moshat e reja. Studime të tilla do të ofronin të dhëna për llojin e sjelljeve problematike të vërejtura në grupmosha të caktuara, faktorët që i nxisin ato si dhe identifikimin e teknikave ndërhyrëse për t'i eliminuar. Edhe në këtë rast përfshirja e punonjësit social në shkollë si një profesionist i përgatitur në këtë fushë do të lehtësonte të gjithë procesin e identifikimit, parandalimit, trajtimit dhe eliminimit të rrezikut që vjen nga sjellje problematike në mosha të hershme.

*Rekomandim 7:*

Lidhur me sa më sipër, politikëbërësit duhet të tregojnë vëmendje për shpërndarjen e fondeve dhe planifikimin e tyre edhe për shërbimet për fëmijë në konflikt me ligjin. Planifikimi i fondeve duhet të jetë i balancuar. Ato duhet të orientohen si nga rrënjët ku shfaqet problemi (moshat e hershme) ashtu edhe nga ndërhyrjet për t'i eliminuar sjelljet problematike hap pas hapi. Fatkeqësisht, shumë politikëbërës janë të painformuar për efikasitetin e ndërhyrjeve të hershme lidhur me sjelljet kriminale dhe për këtë arsye shpesh zgjedhin të mos financojnë programe trajtimi të hershme nga të cilat mund të përfitojnë si të rinjtë ashtu edhe taksapaguesit.

*Rekomandim 8:*

Situata aktuale e fëmijëve dhe të rinjve në konflikt me ligjin nxjerr në pah nevojën për ngritjen apo përmisimin e sistemit egzistues në një sistemi funksional të mbrojtjes së fëmijëve. Megjithëse komponentë të veçantë të këtij sistemi mund të kenë funksionuar deri më tani, ato nuk kanë qënë gjithëpërfshirës si nga pikpamja territoriale ashtu edhe nga përfshirja në të e shërbimeve të domosdoshme për të miturit. Ngritja apo përmisimi i sistemit egzistues në një sistemi funksional dhe të kompletuar për mbrojtjen e fëmijëve do të siguronte mbështetjen e nevojëshme për një zhvillim normal dhe sigurimin e plotësimit të nevojave bazë për kujdes shëndetsor, arsimim, mbrotje nga dhuna dhe abuzimi që shpesh herë kthehen në faktorë nxitës të sjelljeve kriminale tek të miturit.

---

*Rekomandim 9:*

Ministria e Arsimit dhe Drejtoritë Arsimore duhet të angazhohen për krijimin e hapsirave të nevojshme në programet shkollore për module që kanë të bëjnë me sjelljen dhe ndërveprimet sociale. Brenda ose jashtë kornizave programore duhet të parashikohen kurse informimi dhe trajnimi për përvetësimin e modeleve miqësore dhe demokratike të komunikimit qytetar. Kjo do të kërkojë edhe trajnimin e mësimmëdhënësve për të transmetuar qëndrime dhe vlera të reja në marrëdhëniet e tyre me nxënësit.

*Rekomandim 10:*

Qeveria qendrore dhe ajo vendore (lokale) duhet të bashkëpunojnë me aktorë të tjerë të interesuar për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve për të planifikuar dhe organizuar më mirë se deri më tani, shërbimet që ofrohen në mbështetje të fëmijëve por edhe të familjeve në nevojë. Ky bashkëpunim duhet të sigurojë mbulimin e të gjithë territorit me shërbime si dhe mbështetjen e sa më shumë individëve të mitur si dhe familjeve të tyre.

---

## LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- A. Todorovic, "Uzorci maloletnickog prestupnistva - Institut za kriminalisticka istrazivanja", 1995
- A. Todorović "Madhësia e hapësirave urban dhe kriminaliteti i miturve", Nr 3/1975
- Ademaj Xhemajl, "Metodika e hetimit të krimit", Prishtinë 2006;
- Ani Beqo, Blerta Doçi, "Të miturit në konflikt me ligjin" - Analizë e faktorëve të riskut që ndikojnë në kriminalitetin e të miturve, Tiranë, Nëntor 2015
- Boskovic M., "Kriminologjia" Univerzitet u Novom Sadu – Pravnofakultet, Novi Sad, 2006
- Craig F. Ferris & Thomas Grisso, (eds.) "Understanding aggressive behavior in children", New York, 1996.
- Donald J. Newman and Patrick R. Anderson, "Introduction to Criminal Justice", New York, 1990
- Dr. Dragan Kisic, "Psihološkirenik, Savremena administracija", Beograd, 1991
- Dr. M. Milutinović, "Kriminologjia", ETMMK, Prishtinë, 1982,
- Dr. R. Halili, "Kriminologjia", Prishtinë 2011;
- Dr. R. Halili, "Penologjia", Botimi i dytë, Prishtinë 2005,
- Dr. R. Halili, "Penologjia", Prishtinë, 2000
- Dr. R. Halili, "Viktimologjia", Prishtinë 2007
- Dragoti Edmond, "Psikologjia ligjore e krimit", Tiranë, 2007
- E. Elezi dhe V. Hysi, "Politika Kriminale", Tiranë, 2006
- Ejup Sahiti, "E drejta e procedurës penale", Prishtinë 2005;
- Elmedin Muratbegović, "Parandalimi i Kriminalitetit" Sarajevë / Prishtinë, prill 2007
- Grup autorësh, "Politika e Luftimit të Kriminalitetit", Prishtinë 2012
- Henderson Olds, et al., "Improving the deliveru of prenatal care and outcomes of pregnancy: a randomized trial nurse home visitation", 1998
- Herrenkohl, T.L., Hawkins, J.D., Chung, I., Hill, K.G., and Battin-Pearson, S. "School and community risk factors and interventions. In Child Delinquents: Development, Intervention, and Service Needs, 2001.
- I. Salihu, "E drejta penale", Prishtinë, 2003 dhe 2008
- I. Zejneli; Kambovski, V; Janiçević, N; Latifi, V; Sulejmanov, Z; Netkova, B; Milovanović, Z; Kikerekova, T; "Kriminaliteti i organizuar" - Aspekte juridike, Tetovë, 2009
- Ismail Zejneli, "E Drejta Penale" (pjesë e Posaçme), Tetovë 2007,
- J. Robert Flores - Administrator, "Child delinquency", U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, Office of Juvenile Justice and Delinquency Prevention, May 2003,



- 
- Jakov Lazarovski “Altuizmi dhe sjellja agresive”, Skopje, Melbourne 1997
  - Jeton Shazivari, “E drejta kushtetuese-Constitutional Law”, Libri I , Botimi i parë, Shkup 2015,
  - Knezevic, S. “ Maloletnicko krivicno pravo-materialno, procesno i izvrsheno”, Nish 2010
  - Latifi Vesel, “Kriminalistika”, Prishtinë 2011;
  - Latifi Vesel, “Politika kriminale”, Prishtinë 2008;
  - M. M Glatt "Alkoolizmi, krimi dhe delikuenca e të miturve", Zagreb, nr 4/1961
  - Makedon Sllavkoski, “Bazat e tw drejtw s Publike”, Shkup 2012
  - Marie Wernham, “An Outside Change, Street Children and Juvenile Justice-an International Perspective” - Consortium For Street Children, 2004
  - N. Srzentic, dr. A. Stajic, dr. L. Lazarevic, “Krivicno prave Jugoslavije”, 1998
  - Najçevska, M. “Najdobriot interes na deteto vo sistemot na maloletnicka prava”, Akademia e Policisë, Shkup 2008
  - Peter. J, “Criminology - A complete intrudocion”, UK 2012
  - Prof. Asoc. Dr. Edlira Haxhiymeri, “ Kriminaliteti i të miturve në Shqipëri” - Analizë e shkaqeve dhe faktorëve të kriminalitetit tek të miturit në Shqipëri, Tiranë, Qershor 2007
  - Stefan Aleksoski, “Kriminologjia”, Shtip, 2009
  - Vlado Kambovski “Organiziran kriminalitet”, Shtip, Gusht 2005
  - Vllado Kambovski, “E Drejta Penale”, Shkup, 2007
  - Zh. Jashovikj, “Kriminologjia e delikuencës së të miturve”, Beograd, 1991
  - J.Chazal, “La cinema et la delinquance juvenile, Revue de science criminale et de droit penal Compare”, Paris, 1949
  - Камбовски. В, “Коментар на Кривичниот Закон на Република Македонија,Интегрален текст”, Скопје 2011
  - Љ. Арнаудовски, “Малолетнички криминалитет во СРМакедонија”, Скопје, 1983
  - Татјана Велкова, “Малолетнички криминалитет као масовна појава у Републици Македонији-Правни живот”, Копаоник 2008
  - Татјана Велкова, “Феноменологијата на малолетничкиот криминалитет во Република Македонија во периодот 1981-2000 година”, Штип 2006
  - Татјана Велкова, “Феноменолошки карактеристики на малолетничкиот криминалитет “ - Полициска академија, Скопје 2007
  - Чачева В. ( 2007), “Карактеристики на малолетничкиот криминалитет во Република Македонија”, Скопје

---

## LIGJET

- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.37/1996; nr. 80/1999; nr.4/2002; nr.43/2003; nr.19/2004; nr.81/2005; nr.60/2006; nr.73/2006; nr.87/2007; nr.103/2007; nr.161/2007; dhe nr.145/2010).
- Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta zyrtare nr.52/91
- Ligji për egzekutimin e sanksioneve penale (Gazeta zyrtare nr. 2/06, 84/08, 57/10).
- Ligji për gjykatat (Gazeta zyrtare e RM nr.58/06)
- Ligji për policinë, (Gazeta zyrtare nr. 114/2006)
- Ligji për procedurë penale (Gazeta zyrtare e RM nr.150/10)
- Ligji për Prokurorinë publike, (Gazeta zyrtare nr. 150/07)
- Ligji për punë të brendshme, (Gazeta Zyrtare nr.92/2009, 42/2014)
- Ligji për të drejtat e të miturve i Republikës së Maqedonisë, Shkup, Shtator 2008
- Projektligj për të drejtat e fëmijëve, Ministria e Drejtësisë, Shkup 2012
- Projektligji për ndryshim dhe plotësim i ligjit për të drejtat e të miturve, Shkup, Shtator 2010

## DOKUMENTE DHE RAPORTE TË TJERA

- Abuzimi i Fëmijëve në Familje-Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve -CRCA, Tiranë 2006
- Buletini zyrtar i Komunës së Gostivarit - Botohet sipas nevojës, Nr. 7, Gostivar, Nëntor 2014
- Hulumtim Analitiko-Empirik i faktorëve të përgjithshëm që shkaktojnë delikuencën te të përmes studimit të veprimtarisë dhe punëve të shërmimit sprovues të Kosovës, Buletini Nr.5, Autore: Metije Ademi - Drejtore e Shërbimit Sprovues të Kosovës
- Konventa mbi të drejtat e fëmijës e Miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989
- Raport alternativ i organizatave joqeveritare ndaj raporteve shtetërore për gjendjen e të drejtave të fëmijut në R. e Maqedonisë, Botues: Ambasada e parë e fëmijëve në botë Megjashi - Republika e Maqedonisë, Autorë: Koalicioni nacional për të drejtat e fëmijut R.e Maqedonisë, Shkup, 2009
- Raport vjetor për regjistrimin e veprave penale në njësinë e Qendrës për punë Sociale në Gostivarë për periudhë 2009-2014
- Raport vjetor për regjistrimin e veprave penale në njësinë e Stacionit policor në Gostivarë për periudhë 2009-2014
- Raportet vjetor nga punën e Gjyqjit themelorë në Gostivarë (Основен Суд Гостивар) – raportet vjetore për periudhë 2009-2014
- Raporti vjetor i Avokatit të popullit të Republikës së Maqedonisë për periudhë 2009-2014

- 
- Raporti Vjetor i Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës së të miturve dhe gjendja në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe delikuencës së të miturve në vitin 2011-2014
  - Raporti vjetor i Këshillit Shtetëror për parandalimin e delikuencës së të miturve për periudhën 2009-2015 - Godisen Izvestaj za rabota na Drzaven Sovet za prevencija na detsko prestapnistvo i za sostojbite vo oblata na pravata na deteto i detskoto prestapnistvo za period 2009-2015, Shkup
  - Storiteli na krivicni deli vo period od 2009-2015, Statisticki pregled: Naselenie i socialni statistiki, Shkup, Korrik 2015
  - UN Guidelines for the Prevention of Juvenile Delinquency (Riyadh Guidelines)
  - United Nation Rules for the Protection of Juveniles Deprived of their Liberty (Havana Rules)
  - United Nation Standard Minimum Rules for the juvenile justice (The Beging Rules)
  - Извештај – Ризик-Факторите за повторништво кај децата заради подобра превенција на детско престапништво, Проф. д-р Гордана Лажетиќ-Бужаровска, Проф. д-р Сунчица Димитријоска, Скопје Декември, 2015
  - Националната стратегија за превенција на малолетнико престапништво во Република Македонија 2010-2020, - Strategjia e përgatitur nga Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delinkvencës për të Mitur, Shkup 2009

## **LINQET E SHFRYTËZUARA**

- Dokumente dhe libra nga biblioteka virtuale e Republikës së Maqedonisë: <http://www.vbm.mk/>
- Dokumente dhe libra nga faqja e internetit: <https://www.akademika.com.mk/>
- Dokumente dhe libra nga faqja e internetit: <http://books.google.mk/books>
- Mateirale, raporte dhe broshura nga Këshilli Shtetëror për parandalimin e delikuencës së të miturve në Republikën e Maqedonisë pranë Ministrisë së Drejtësisë: <http://www.pravo.org.mk/>
- Materiale dhe broshura nga Gjykata e Apelit në Gostivarit: <http://www.vsrn.mk/wps/portal/asgostivar/sud/>
- Materiale dhe broshura nga Gjykata themelore e Gostivarit: <http://www.vsrn.mk/wps/portal/osgostivar/sud/>
- Materiale dhe raporte nga Zyra e Advokatit të popullit të R. së Maqedonisë: <http://www.ombudsman.mk/>
- Materiale, raporte dhe broshura nga Ministria e Drejtësisë: <http://www.pravo.org.mk/>
- Materiale, raporte dhe broshura nga Ministria e Arsimit: <http://www.mon.org.mk/>
- Materiale, raporte dhe broshura nga Ministria e punëve të Brendëshme, njësia në Stacionin Policor në Gostivar: <http://www.mvr.gov.mk/>
- Materiale, raporte dhe broshura nga Ministristria për punë dhe Politikë Sociale, njësia rajonale në Gostivar: <http://www.mtsp.gov.mk/>
- Materiale, raporte dhe broshura nga Qendra sociale për të mitur – Ambasada e fëmijëve Megjashi në Shkup: <http://www.childrensembassy.org.mk/>
- Të dhëna statistikore materiale, raporte dhe broshuranga Enti shtetëror i statistikave në Republikën e Maqedonisë: <http://www.stat.gov.mk/>